




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA/VLADA/GOVERNMENT

Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave



Prishtinë
Maj 2010

Akronimet:

EMI	Ekipi i Menaxhimit të Incidentit
IKRK	Infrastruktura Kritike dhe Resurset Kryesore
IME	Instituti për Menaxhimin Emergjent
KB	Komanda e Bashkuar
KI	Komanda e Incidentit
KNI	Koordinimi Ndër-Institucional
OJQ	Organizatat Jo-Qeveritare
PKI	Post Komanda e Incidentit
PRK	Plani i Reagimit Kombëtar
PSO	Procedurat Standarde të Veprimit
PVI	Plani i Veprimit të Incidentit
QIP	Qendra e Informimit të Përbashkët
QKSPEZh	Qendra Kosovare për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim
QOD	Qendra Operative e Dikastereve
QOE	Qendra Operative Emergjente
SIME	Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave
SIP	Sistemi i Informimit të Përbashkët
SKI	Sistemi i Komandës së Incidentit
SKNI	Sistemi i Koordinimit Ndër-Institucional
TEM	Teknik Emergjent Mjekësor
ZIP	Zyra e Informimit Publik

Sot, më tepër se asnjëherë është nevoja që të krijojmë një sistem të koordinuar institucional me të gjitha resurset dhe kapacitetet që kemi në dispozicion për të qenë të përgatitur që të reagojmë në mënyrë të koordinuara dhe planifikuara me rastin e fatkeqësive natyrore dhe incidenteve tjera. Me këtë dokument mundësohet që mekanizmat tonë të kenë çasje proaktive dhe sistematike në fushën e parandalimit, mbrojtjes, reagimit dhe rimëkëmbjes me qëllim të zbutjes dhe zvoglimit të humbjeve të jetëve dhe atyre ekonomiko sociale.

Është koha që të kemi një çasje të koordinuar dhe gjithë përfshirëse në menaxhimin/reagimin ndaj situatave emergjente përfshirë këtu fatkeqësitë natyrore, incidenteve të rrezikshme, terrorizmit apo edhe fatkeqësive tjera të shkaktuara nga faktori njeri. Arritja e qëllimeve të përbashkëta mund të realizohet vetëm përmes fleksibilitetit në një partneritet ndërinstucional, organizatave jo qeveritare, shoqërisë civile dhe sektorit privat. Duke ofruar përkrahje teknike administrative dhe edukative të gjitha institucioneve dhe përdorur të gjitha resurset, assetet dhe mekanizmat ekzistues si bazë për zhvillime të mëtutjeshëm në politik-bërje dhe reagim operacional, për adresim të çështjeve emergjente.

Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave siguron një orientim strategjik, në ngritjen e përgjegjësisë, përkushtimit dhe koordinimit të shërbimeve mes akterëve si para dhe pas incidenteve. Një çasje sistematike, pro-aktive për udhëzimin e drejtorive dhe agjencive të të gjitha niveleve të qeverisjes, organizatave joqeveritare dhe sektorit privat për të punuar bashkërisht dhe me vëmendje të përqendruar në fushën e parandalimit, mbrojtjes, reagimit, rimëkëmbjes dhe zbutjes së efekteve të incidenteve, pa marrë parasysh shkakun, madhësinë, vendndodhjen apo kompleksitetin e tyre.

Fatkeqësitë dhe incidentet nuk njohin kufijë. Zbatimi i këtij sistemi ofron një zgjidhje të koordinuar të komunikimit, mundëson zhvillimin e ushtrimeve fushore efektive në nivel shtetëror. Njëkohësisht, faktorizon zhvillimin e partneritetit dhe thellimin e bashkëpunimit jo vetëm mes institucioneve nacionale, por edhe zgjerimin e bashkëpunimit regional dhe ndërkombëtare. Republika e Kosovës duhet të jetë pjesë e këtyre iniciativave regionale dhe ndërkombëtare.

Institucionet e Republikës së Kosovës dhe juridiksionet tjera në nivel qendrorë dhe lokal do të jenë kryesisht përgjegjëse për implementimin e Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave për përgjigjen ndaj krizave.

Kryeministri i Kosovës

Prishtinë, Maj 2010

PËRMBAJTJA:

PARATHËNIA	1
HYRJA DHE PËRSHKRIMI	3
A. HYRJE.....	4
B. KORNIZA LIGJORE DHE INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE.....	4
C. MEKANIZMAT INSTITUCIONAL.....	4
B. KONCEPTET DHE PARIMET	5
1. FLEKSIBILITETI.....	5
2. STANDARDIZIMI.....	6
C. PËRSHKRIMI I KOMPONENTËVE TË SIME-SË	6
1. KOMPONENTËT E SISTEMIT	6
a. Gatishmëria	6
b. Komunikimi dhe menaxhimi i informimit	6
c. Menaxhimi i resurseve	7
d. Komanda dhe menaxhmenti	7
e. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme	7
(1) <i>Instituti i Menaxhimit Emergjent</i>	7
(2) <i>Teknologjitë mbështetëse</i>	8
KOMPONENTI I: GATISHMËRIA	9
A. PARIMET DHE KONCEPTET	9
1. QASJE E UNIFIKUAR	10
2. NIVELET E KAPCITETIT	10
B. ARRITJA E GATISHMËRISË	10
1. SIME DHE MARRËDHËNIA E TIJ ME PLANIN E REAGIMIT KOMBËTAR	11
2. ROLET E GATISHMËRISË	12
a. Organizmat e gatishmërisë	12
b. Zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar.....	13
(1) <i>Zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar gjatë një incidenti</i>	14
c. Organizatat Joqeveritare	15
d. Sektori Privat.....	15
3. ELEMENTET E GATISHMËRISË	16
a. Planifikimi i gatishmërisë	16
(1) <i>Koncepti i vijimësisë</i>	17
(2) <i>Marrëveshjet për ndihmë reciproke dhe marrëveshjet për asistencë</i>	18
b. Procedurat dhe protokollet	18
c. Trajnimet dhe ushtrimet	19
d. Kualifikimi dhe certifikimi i personelit	20
e. Certifikimi i pajisjeve	21
5. PARANDALIMI/ ZBUTJA E EFEKTIT TË RREZIQEVE	21
KOMPONENTI II: KOMUNIKIMI DHE MENAXHIMI I INFORMIMIT	23
A. KONCEPTET DHE PARIMET	23
1. PASQYRA E PËRBASHKËT OPERATIVE	24
2. NDËRVEPRUESHMËRIA	24
3. BESUESHMËRIA, SHKALLZUESHMËRIA DHE MOBILITETI.....	24
4. RIPËRTRITSHMËRIA DHE ZËVENDËSUESHMËRIA	25
B. KARAKTERISTIKAT E MENAXHIMIT.....	25

1. LLOJET E STANDARDIZUARA TË KOMUNIKIMIT	25
2. POLITIKA DHE PLANIFIKIMI	26
3. MARRËVESHJET	27
4. STANDARDET E PAJISJEVE DHE TRAJNIMI	27
C. ORGANIZIMI DHE OPERACIONET	27
1. INFORMACIONET E INCIDENTIT	27
a. Shpallja e incidentit, raportet e situatës dhe raportet e gjendjes	28
b. Të dhënat analitike.....	28
c. Të dhëna gjeohapësinore.....	28
2. STANDARDET DHE FORMATET E KOMUNIKIMIT	29
a. Procedurat për përdorimin e radiove	29
b. Terminologji e përbashkët, gjuhë e qartë, pajtueshmëri.....	30
c. Shifrimi apo gjuha teknike	30
d. Sistemi i informimit të përbashkët	30
e. Procedurat e internetit	31
f. Siguria e informacionit	31
KOMPONENTI III: MENAXHIMI I RESURSEVE	33
A. KONCEPTET DHE PARIMET	34
1. KONCEPTET.....	34
2. PARIMET.....	34
a. Planifikimi.....	34
b. Përdorimi i marrëveshjeve.....	34
c. Kategorizimi i resurseve.....	35
d. Identifikimi dhe porositja e resurseve	35
e. Menaxhimi efektiv i resurseve	35
(1) Procedurat e sigurimit/përvetësimit.....	35
(2) Sistemet informative të menaxhmentit	36
(3) Sistemet rezervë të informimit	36
(4) Protokollet e porositjes, mobilizimit dhe demobilizimit	36
B. MENAXHIMI I RESURSEVE.....	37
1. IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE	37
2. POROSITJA DHE SIGURIMI.....	38
3. MOBILIZIMI.....	39
4. PËRCJELLJA DHE RAPORTIMI	39
5. RIMËKËMBJA DHE DEMOBILIZIMI.....	40
a. Resurset jo të hraxhueshme.....	40
b. Resurset e hraxhueshme.....	41
6. KOMPENSIMI	41
7. INVENTARIZIMI.....	41
a. Akreditimi/ nostrifikimi.....	42
b. Identifikimi dhe klasifikimi i resurseve.....	43
(1) Kategoria	43
(2) Natyra e resursit	43
(a) Komponentët	44
(b) Masat.....	44
(3) Lloji.....	44
KOMPONENTI IV: KOMANDA DHE MENAXHMENTI	45
A. SISTEMI I KOMANDËS SË INCIDENTIT	45

1. KARAKTERISTIKAT E MENAXHMENTIT.....	47
a. Terminologjia unike	47
(1) Funksionet organizative	47
(2) Përshkrimet e resurseve	47
(3) Hapësirat përcjellëse të incidentit	47
b. Organizimi i përshtatshëm.....	47
c. Menaxhimi sipas objektivave.....	47
d. Planifikimi i veprimeve në incident	48
e. Hark kontrolli i menaxhueshëm	48
f. Objektet përcjellëse të incidentit	48
g. Menaxhimi gjithëpërfshirës i resurseve.....	49
h. Komunikimi i integruar	49
i. Ngritja dhe transferi i komandës	49
j. Zingjiri i komandës dhe uniteti i komandës	49
k. Komanda e bashkuar.....	49
l. Përgjegjshmëria.....	50
m. Dërgimi/dislokimi	50
n. Menaxhimi i informacioneve të zakonshme dhe inteligjente.....	50
2. KOMANDA E INCIDENTIT DHE PERSONELI I KOMANDËS	50
a. Komanda e incidentit	50
(1) Komandant më vete i incidentit	50
(2) Komanda e bashkuar.....	51
b. Personeli i komandës.....	52
(1) Zyrtari për Informim Publik	52
(2) Zyrtari për Siguri	53
(3) Zyrtari për Ndërlidhje.....	53
(4) Personeli plotësues i komandës.....	54
c. Struktura e komandës së incidentit.....	55
3. PERSONELI I PËRGJITHSHËM	55
a. Sektori operativ.....	56
(1)Shefi i Sektorit Operativ	56
(2) Degët.....	56
(3) Divizionet apo grupet	56
(4) Resurset.....	56
b. Sektori i Planifikimit	57
c. Sektori i Logjistikës.....	59
d. Sektori i Financave/ Administratës	60
e. Funkzioni Inteligent/Hetues	61
4. EKIPET E MENAXHIMIT TË INCIDENTIT.....	63
5. KOMANDA REGJIONALE	63
a. Përshkrimi	63
b. Përgjegjësitë	64
B. SISTEMET E KOORDINIMIT NDËRINSTITUCIONAL	65
1. DEFINKIIONI.....	66
2. ELEMENTET E SISTEMIT.....	66
a. Objektet/hapësirat e punës.....	66
b. Pajisjet.....	66
c. Personeli.....	66

d. Procedurat.....	66
3. SHEMBUJ TË ELEMENTEVE TË SISTEMIT	67
a. Qendra Operative Emergjente.....	67
b. Grupi KNI.....	68
4. FUNKSIONET PARËSORE TË SKNI	68
a. Vlerësimi i situatës	69
b. Sigurimi dhe ndarja e resurseve kritike.....	69
c. Përcaktimi i prioriteteve të incidentit.....	69
d. Mbështetja për politikat përkatëse të menaxhmentit të incidentit dhe aktivitetet ndërinstitucionale	69
e. Koordinimi me elementet tjera të SKNI-së	69
f. Koordinimi me zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar	70
g. Koordinimi i përmbledhjeve informative.....	70
C. INFORMIMI PUBLIK	70
1. HYRJE.....	70
2. PËRSHKRIMI I SISTEMIT DHE KOMPONENTËT E TIJ	70
a. Zyrtari për Informim Publik	70
b. Sistemi i Informimit të Përbashkët.....	71
c. Qendra e Informimit të Përbashkët	71
d. Pavarësia organizative	72
e. Dhënia e informacioneve tek publiku dhe palët e interesit	73
(1) Grumbullimi i informacioneve	73
(2) Verifikimi i informacioneve.....	73
(3) Koordinimi i informacioneve	74
(4) Shpërndarja e informacioneve.....	74
3. PLANIFIKIMI I KOMUNIKIMIT TË INFORMIMIT PUBLIK	74
D. MARRËDHËNIET MIDIS ELEMENTEVE TË KOMANDËS DHE MENAXHMENTIT... 75	
KOMPONENTI V: MENAXHIMI DHE MIRËMBAJTJA NË VIJIM	76
A. INSTITUTI I MENAXHIMIT EMERGJENT	76
1. KONCEPTET DHE PARIMET	76
2. PROCESI I RISHIKIMIT TË SIME	77
3. PËRGJEGJËSITË E INSTITUTIT TË MENAXHIMIT EMERGJENT.....	77
a. Administrimi dhe pëlqimi	77
b. Standardet dhe akreditimi.....	77
c. Mbështetja e trajnimeve dhe ushtrimeve.....	78
d. Menaxhimi i publikimeve.....	79
B. TEKNOLOGJITË MBËSHTETËSE	79
1. KONCEPTET DHE PARIMET	80
a. Ndërveprueshmëria dhe kapaciteti.....	80
b. Mbështetja teknologjike	80
c. Standardet e teknologjisë	80
d. Nevojat e gjëra	80

PARATHËNIE

Me 22 prill 2010 Kryeministri i Republikës së Kosovës ka lëshuar vendimin me nr. ref. 685/10 , i cili ka urdhëruar zëvendës ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të themeloj *Sistemin e Integruar për Menaxhimin e Emergjencave*. Ky sistem afron kornizë të qëndrueshme gjithëkombëtare për të mundësuar që qeveritë e të dyja niveleve, organizatat joqeveritare (OJQ-të) dhe sektori privat, të punojnë së bashku për parandalimin, mbrojtjen, reagimin, rimëkëmbjen dhe zvogëlimin e efekteve të incidenteve pa marrë parasysh shkakun, madhësinë, vendndodhjen apo kompleksitetin e tyre. Kjo qëndrueshmëri ofron bazament për përdorimin e sistemit për të gjitha incidentet duke filluar nga ndodhitë e përditshme deri tek incidentet që kërkojnë reagim të koordinuar qeveritar.

SIME përfaqëson thelbin e doktrinave, koncepteve, parimeve, terminologjive dhe proceseve organizative të cilat mundësojnë menaxhim efektiv, efikas dhe bashkëpunues të incidenteve.

Vendimi nr. 685/10 gjithashtu ka urdhëruar zëvendës ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të hartoj edhe *Planin e Reagimit Kombëtar*. PRK është udhërrëfyes i kursit të zhvillimit të reagimit të shtetit ndaj të gjitha rreziqeve. PRK përcakton parimet kryesore, rolet, përgjegjësitë dhe strukturat që e organizojnë reagimin kombëtar. Për më tepër ai përshkruan rrethanat e veçanta kur qeveria ushtron rol më të madh, përfshirë incidentet ku përfshihen interesat e shtetit dhe incidentet katastrofike, ku niveli regjional dhe lokal do të ketë nevojë për mbështetje të konsiderueshme.

Vendimi nr. 685/10 obligon të gjitha institucionet qendrore që ta adaptojnë SIME-në dhe ta përdorin në programet dhe aktivitetet e tyre individuale të menaxhimit të incidenteve, si edhe në të gjitha veprimet e ndërmarra për mbështetjen e nivelit lokal të qeverisjes. Udhëzimi kërkon nga institucionet qendrore që strukturat e nivelit regjional dhe lokal, ta adaptojnë SIME-në dhe t'i caktojnë kushtet për asistencën qendrore në fushën e gatishmërisë. SIME njeh rolin të cilin e luajnë OJQ-të dhe sektorin privat në fushën e gatishmërisë dhe në aktivitetet për parandalim, mbrojtje, reagim, rimëkëmbje dhe zvogëlim të efekteve të incidenteve/emergjencave.

Duke u ndërtuar mbi themelet e siguruara nga sistemet ekzistuese të menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve të përdorur nga juridiksionet, organizatat dhe disiplinat funksionale në të gjitha nivelet, SIME integron praktikat më të mira në një kornizë gjithëpërfshirëse për përdorim gjithëkombëtar nga personeli i menaxhimit/reagimit emergjent, në kontekstin e të gjitha rreziqeve. Këto praktika më të mira, krijojnë bazamentin për komponentët e SIME-së dhe sigurojnë mekanizmat për zhvillimin dhe përmirësimin e standardeve, udhëzimeve, protokolleve, sistemeve dhe teknologjive mbështetëse kombëtare. SIME përvetëson zhvillimin e teknologjive speciale të cilat përkrahin aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve, si dhe mundëson angazhimin e qasjeve të reja të cilat do të mundësojnë përmirësimin e vazhdueshëm të vetë sistemit.

Ministri i Punëve të Brendshme nëpërmjet Institutit të Menaxhimit Emergjent (për tu ngritur në QKSPEZH), për integrimin e sistemeve ekzistuese të menaxhimit të incidenteve, do t'i publikoj standardet, udhëzimet dhe protokollat e pajtueshmërisë për përcaktimin nëse apo jo institucionet qendrore dhe lokale kanë implementuar SIME-në.

Për më tepër, Ministri, nëpërmjet QKSPEZH, do të menaxhoj publikimin dhe së bashku me institucionet tjera, do t'i vendos standardet, udhëzimet, procedurat e pajtueshmërisë dhe protokollat për të gjitha aspektet e lidhura me SIME-në.

Ky dokument është punuar nëpërmjet partneritetit bashkëpunues ndërqeveritar me kontributin e konsiderueshëm të disiplinave funksionale të menaxhimit emergjent, OJQ-ve, sektorit privat dhe faktorit ndërkombëtar.

HYRJE

Vërshimet e vitit 2005, zjarret e vitit 2007, si dhe incidenti me vajin disulfurik i vitit 2008, kanë potencuar nevojën e përqendrimit në përmirësimin e menaxhimit emergjent, kapaciteteve të reagimit ndaj incidenteve dhe proceseve koordinuese në tërë vendin. Qasja gjithëpërfshirëse kombëtare e aplikueshme në të gjitha nivelet juridiksionale dhe në të gjitha disiplinat funksionale, përmirëson efektivitetin e personelit të menaxhimit/reagimit emergjent, në tërë spektrin e incidenteve të mundshme dhe skenareve të rrezikshme, përfshirë fatkeqësitë natyrore, aktivitetet terroriste dhe fatkeqësitë tjera të shkaktuara nga faktori njeri. Qasja e tillë përmirëson koordinimin dhe bashkëpunimin midis agjencive/organizatave publike dhe private në aktivitetet e ndryshme të menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve. Korniza e *Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave* e avancoon qasjen gjithëpërfshirëse kombëtare (shih tabelën nr. 1).

Edhe pse incidentet zakonisht fillojnë dhe përfundojnë në rrafshin lokal dhe menaxhohen mbi baza ditore në nivelin më të ulët të mundshëm gjeografik, organizativ dhe juridiksional, prap se prap, ekzistojnë rrethana në të cilat operacionet e suksesshme të menaxhimit të incidentit varen nga përfshirja e shumë juridiksioneve, niveleve të qeverisjes, agjencive funksionale dhe disiplinave të shumta të reagimit emergjent. Këto rrethana kërkojnë koordinim efektiv dhe efikas midis këtij spektri të gjerë të strukturave dhe aktiviteteve.

SIME përdor qasje sistematike për integrimin e procesve dhe metodave më të mira ekzistuese, në kornizën e unifikuar kombëtare për menaxhimin e incidenteve. Menaxhimi i incidenteve i referohet mënyrës se si menaxhohen incidentet përgjatë të gjitha aktiviteteve të sigurisë kombëtare, përfshirë parandalimin, mbrojtjen, reagimin dhe rimëkëmbjen.

Kjo kornizë krijon bazat për ndërveprim dhe përputhje të cilat në kthim mundësojnë që organizatat e ndryshme publike dhe private të kryejnë operacione të integruara mirë dhe efektive të menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve. Menaxhimi emergjent është integrimi dhe koordinimi i të gjitha aktiviteteve të nevojshme për ngritjen, mbajtjen dhe përmirësimin e kapaciteteve për tu përgatitur, mbrojtur, për të reaguar apo rimëkëmbur nga fatkeqësitë natyrore të mundshme apo

aktuale, aktet e terrorizmit apo fatkeqësitë tjera të shkaktuara nga faktori njeri. Këtë e bënë përmes koncepteve, parimeve, procedurave, proceseve organizative, terminologjisë dhe kërkesave standarde të aplikueshme për komunitetin e gjerë të shfrytëzuesve të sistemit.

KORNIZA LIGJORE DHE INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE

Republika e Kosovës ka një numër të konsiderueshëm të legjislacionit në fuqi që rregullon fushën e Menaxhimit të Emergjencave Shih. ANEXI I

MEKANIZMAT INSTITUCIONAL

Të gjithë Institucionet e Republikës së Kosovës në nivel qendrorë dhe lokal do të jenë përgjegjëse për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave. Grupi drejtues për SIME është krijuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Forca e Sigurisë së Kosovës, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit, Qendrës së Situatave, Sekretariatit të Sigurisë Kombëtare dhe organizatave ndërkombëtare.

Çka është Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave?

Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave (këtu e tutje SIME), siguron çasje sistematike, pro-aktive për udhëzimin e dikastereve dhe agjencive të të gjitha niveleve të qeverisjes, organizatave joqeveritare dhe sektorit privat për të punuar bashkërisht dhe me vëmendje të përqendruar në fushën e parandalimit, mbrojtjes, reagimit, rimëkëmbjes dhe zbutjes së efekteve të incidenteve, pa marrë parasysh shkakun, madhësinë, vendndodhjen apo kompleksitetin e tyre, me qëllim të zvogëlimit të humbjeve në jetë dhe të mira materiale, si dhe efekteve të dëmshme në mjedis. SIME funksionon dorë më dorë me *Planin e Reagimit Kombëtar* (këtu e tutje PRK). SIME ofron kornizën për menaxhimin e incidenteve, ndërsa PRK ofron strukturën dhe mekanizmin për politikën e nivelit kombëtar të menaxhimit të incidenteve/emergjencave.

Tabela 1. Përshkrimi i SIME

Çka është SIME:	Çka NUK është SIME:
<ul style="list-style-type: none"> • Qasje gjithëpërfshirëse, sistematike gjithëkombëtare në menaxhimin e incidenteve, përfshirë Sistemin e Komandës së Incidentit, Sistemet e Koordinimit Ndërinstitucional dhe Informimin Publik; • Kornizë e koncepteve dhe parimeve të gatishmërisë për të gjitha rreziqet; • Parim esencial për pasqyrën e 	<ul style="list-style-type: none"> • Plan reagimi; • I përdorshëm vetëm gjatë incidenteve me përmasa të mëdha; • Plan komunikimi; • I aplikueshëm vetëm për personelin e caktuar të menaxhimit/reagimit emergjent; • Vetëm Sistem i Komandës së

<p>përbashkët operative dhe të ndërveprimit të komunikimit dhe informimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Menaxhim i standardizuar i resurseve të clat mundësojnë koordinim midis juridiksioneve dhe organizatave të ndryshme; • I shkallëzueshëm, në mënyrë që të përdoret për të gjitha incidentet (nga të përditshme tek ato të shkallës së gjerë); • Sistem dinamik i cili përkrah menaxhimin e vazhdueshëm dhe mirëmbajtjen e sistemit; 	<p>Incidentit apo skemë organizative;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sistem statik;
---	--

KONCEPTET DHE PARIMET

SIME është i bazuar në parakushtet që përdorimi i kornizës së përbashkët për menaxhimin e incidenteve do t'i jap personelit të menaxhimit/reagimit emergjent sistem fleksibil, por të standardizuar për aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident. SIME është fleksibil për faktin se komponentët e tij mund të përdoren për të zhvilluar plane, procese, procedura, marrëveshje dhe role për të gjitha llojet e incidenteve, është i aplikueshëm në çdo incident pa marrë parasysh shkallën, madhësinë, vendndodhjen apo kompleksitetin e tij. Për më tepër, SIME siguron një seri të strukturave standarde organizative, gjë që është kritike në lejin e organizatave dhe agjencive të ndryshme të punojnë së bashku në formën e koordinimit të paraparë.

FLEKSIBILIETI

Komponentët e SIME-së janë të përshtatshme për secilën situatë, nga incidentet e zakonshme lokale deri tek ato që kërkojnë aktivizimin e ndihmës reciproke ndërkomunale/regjionale, e deri tek ato që kërkojnë reagim të koordinuar qeveritar, qoftë të planifkuara, të paralajmëruara, apo të pa paralajmëruara.

Fleksibiliteti është esencial për SIME-në, me qëllim që të jetë i aplikueshëm përgjatë tërë spektrit të incidenteve të mundshme, përfshirë ato që kërkojnë koordinim nga shumë agjenci, shumë juridiksione (siç janë incidentet që ndodhin përgjatë kufijve ndërkommbëtar) apo koordinim shumë disiplinor. Fleksibiliteti në kornizën e SIME-së e lehtëson shkallëzimin e aktiviteteve të menaxhimit emergjent dhe të reagimit në incident.

STANDARDIZIMI

Fleksibiliteti për t'i menaxhuar incidentet e çdo madhësie kërkon koordinim dhe standardizim midis personelit të menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatave të tyre përkatëse. SIME afron serinë e strukturave standarde organizative të cilat përmirësojnë integrimin dhe ndërlidhjen midis juridiksioneve dhe disiplinave, duke filluar me financimin e përbashkët të gatishmërisë dhe planifikimit të koordinuar. Personeli dhe organizatat që adaptojnë kornizën e përbashkët të SIME-së janë në gjendje të punojnë së bashku dhe si rezultat të përfitojnë reciprocitet midis organizatave të ndryshme, të përfshira në të gjitha aspektet e një incidenti. SIME, gjithashtu përkrah dhe siguron terminologji të zakonshme dhe të përbashkët, e cila kujdeset për komunikim më efektiv midis agjencive dhe organizatave që reagojnë së bashku në një incident.

PËRSHKRIMI I KOMPONENTËVE TË SIME-së

SIME integron praktikat më të mira ekzistuese në një qasje të qëndrueshme, gjithëkombëtare, sistematike në menaxhimin e incidenteve, e cila është e aplikueshme në të gjitha nivelet e qeverisjes, organizatat joqeveritare (OJQ-të) dhe sektorin privat, si dhe në të gjitha disiplinat funksionale në kontekstin e të gjitha rreziqeve. Këtë qasje e përbëjnë pesë komponente kryesore: gatishmëria, komunikimi dhe menaxhimi i informimit, menaxhimi i resurseve, komanda dhe menaxhmenti, si dhe menaxhimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme.

KOMPONENTËT E SIME-së

Komponentët e SIME-së nuk janë menduar të qëndrojnë më vete, por për të punuar së bashku në mënyrë fleksibile dhe sistematike për të siguruar një kornizë kombëtare për menaxhimin e incidenteve. Shtjellimi më i hollësishëm i secilës komponentë përshkruhet në nën seksionet vijuese të këtij dokumenti.

I. Gatishmëria

Aktivitetet efektive të menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident, fillojnë me një mori aktiviteteve përgatitore, të kryera në vijimësi shumë heret para çdo incidenti të mundshëm. Gatishmëria përfshinë një kombinim të integruar të vlerësimit, planifikimit, procedurave dhe protokolleve, trajnimeve dhe ushtrimeve, kualifikimit, licencimit dhe certifikimit të personelit, certifikimit, vlerësimit dhe inspektimit të pajisjeve.

II. Komunikimi dhe menaxhimi i informimit

Aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve, varen në sistemet e komunikimit dhe informimit të cilat sigurojnë pasqyrën e përbashkët operative në të gjitha mjediset e komandimit dhe koordinimit. SIME përcakton kërkesat e domosdoshme për një kornizë standarde të komunikimit dhe potencon nevojën për

një pasqyrë të përbashkët operative. Ky komponent është i bazuar në konceptet e ndërveprimit, sigurisë, shkallëzimit dhe mobilitetit si dhe në aftësitë ripërtëritëse dhe zëvendësuese të sistemeve të komunikimit dhe informimit.

III. Menaxhimi i resurseve

Për mbështetjen e objektivave kritike të çdo incidenti janë të nevojshme resurset (personeli, pajisjet apo furnizimet). Rrjedha e resurseve duhet të jetë e lehtë dhe e përshtatshme për kërkesat e incidentit. SIME përcakton mekanizmat standarde dhe vendos procesin e menaxhimit të resurseve për tu përdorur për përcaktimin e nevojave për resurse, porositjen dhe sigurimin e resurseve, mobilizimin e resurseve, përcjelljen dhe raportimin e resurseve, dhe rimëkëmbjen/riparimin, demobilizimin, kompensimin dhe inventarizimin e resurseve.

IV. Komanda dhe menaxhimi

Komponenta e komandës dhe menaxhimit e SIME-së, është e dizajnuar për të mundur menaxhim dhe koordinim efikas dhe të efektshëm të incidenteve, duke ofruar strukturë të standardizuar dhe fleksibile, për menaxhimin e incidenteve. Struktura është e bazuar në tri forma organizative: Sistemin e Komandës së Incidentit, Sistemet e Koordinimit Ndër-Institucional dhe Informimin Publik.

V. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme

Brenda kushteve të favorshme, të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme ekzistojnë dy komponente: Instituti i Menaxhimit Emergjent dhe teknologjitë mbështetëse.

(1) Instituti i Menaxhimit Emergjent

Për të siguruar mekanizmin për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të SIME-së, Ministra e Punëve të Brendshme do të themelojë Institutin e Menaxhimit Emergjent (këtu e tutje IME) në shtyllën e emergjencave të Qendrës së Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (këtu e tutje QKSPEZH). IME do të sigurojë drejtim strategjik, mbikëqyrje dhe koordinim të sistemit dhe do të mbështet mirëmbajtjen e rregullt dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe komponentëve të tij. IME do ta mbikëqyrë programin dhe do të koordinojë me partnerët qendror, regjional dhe lokal në vendosjen e kriterëve të pajtueshmërisë dhe aktivitetet e implementimit të sistemit. IME do të sigurojë udhëzime dhe mbështetje për juridiksionet dhe personelin e menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatat tjera që e adaptojnë sistemin. IME, gjithashtu do të mbikëqyrë dhe koordinojë publikimin e SIME-së dhe produktet e lidhura për të.

Kjo mbikëqyrje përfshinë shqyrtimin dhe certifikimin e kurseve të trajnimit dhe informacioneve që kanë të bëjnë me ushtrimet.

(2) Teknologjitë mbështetëse

Ashtu siç do të evoltoj SIME dhe sistemet e tij të menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve edhe personeli i menaxhimit/reagimit emergjent do të varet jashtëzakonisht shumë në sisteme dhe teknologji të ndryshme, për implementimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit. IME, në partneritet me Sektorin e Shkencave dhe Teknologjisë, do të mbikëqyrë dhe koordinoj zhvillimin e vazhdueshëm të teknologjisë së lidhur me menaxhimin e incidenteve, përfshirë hulumtimet dhe zhvillimet strategjike në këtë fushëveprim.

KOMPONENTI I:

GATISHMËRIA

SIME pajisë personelin e menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatat e tyre përkatëse me mekanizma për të punuar kolektivisht duke ofruar mjetet për fuqizimin e gatishmërisë. Gatishmëria arrihet dhe mbahet nëpërmjet ciklit të vazhdueshëm të planifikimit, organizimit, trajnimeve, pajimit, ushtrimeve, vlerësimit dhe ndërmarrjes së veprimeve korigjuese. Përpjekjet e vazhdueshme në lëmin e gatishmërisë të të gjithë atyre që përfshihen në aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve, sigurojnë koordinim efektiv gjatë kohës së krizave. Për më tepër, gatishmëria i lehtëson aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve.

Kjo komponentë përshkruan masat specifike dhe kapacitetet të cilat personeli i menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatat e tyre përkatëse duhet t'i ndërtojnë dhe t'i inkorporojnë në programet e tyre të gatishmërisë së përgjithshme, për ta shtuar gatishmërinë operative të domosdoshme për kryerjen e aktiviteteve të menaxhimit emergjent të të gjitha rreziqeve dhe aktiviteteve të reagimit në incident. Në zhvillimin, përpunimin dhe zgjerimin e programeve dhe aktiviteteve të gatishmërisë brenda juridiksioneve dhe organizatave të tyre, personeli i menaxhimit/reagimit emergjent duhet të eksploroj përpjekjet ekzistuese të gatishmërisë dhe marrëdhëniet bashkëpunuese deri në masën më të madhe të mundshme. Gatishmëria personale si element shumë i rëndësishëm i sigurisë kombëtare, është vendimtare për gatishmërinë operative të kapaciteteve të menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve në vendit tonë, dhe është përtej fushëveprimit të SIME-së.

A. PARIMET DHE KONCEPTET

Gatishmëria në kuadër të fushëveprimit të SIME-së, përqendrohet në elementet në vijim: planifikim, procedura dhe protokolle, trajnime dhe ushtrime, kualifikim, licencim dhe certifikim të personelit dhe certifikim të pajisjeve. Adaptimi efektiv,

implementimi dhe trajnimi adekuat i komponentëve të SIME-së, para një incidenti apo ngjarjeje të planifikuar do të mundësoj aktivitete bashkëpunuese të menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident. Gatishmëria është hap themelor në menaxhimin emergjent dhe reagimin ndaj incidenteve prandaj, parimet dhe konceptet që i krijojnë bazat për gatishmëri janë një integrim i parimeve dhe koncepteve të të gjitha komponentëve të SIME-së.

1. QASJE E UNIFIKUAR

Gatishmëria kërkon qasje të unifikuar të aktiviteteve të menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve. Për ta arrit këtë, komponentët e SIME-së duhet të jenë të integruar, në kuadër të strukturës së menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve, të juridiksionit apo organizatës përkatëse. Në mënyrë të veçantë, gatishmëria duhet të jetë e integruar në menaxhimin e komunikimit dhe informimit, menaxhimin e resurseve, si dhe në komandë dhe menaxhim për të formuar një sistem efektiv. Për më tepër, koncepti i qasjes së unifikuar është në bërthamën e komponentës së komandës dhe menaxhimit, përderisa është e bazuar në zinxhir komandues, unitet të komandës, unitet të përpjekjes dhe kur implementohet në unifikim të komandës. Këto karakteristika i mundësojnë organizatave me mandate, përgjegjësi dhe resurse të ndryshme juridiksionale, gjeografike apo funksionale të koordinojnë, planifikojnë dhe ndërveprojnë efektivisht në mbështetje të objektivave të përcaktuara bashkarisht.

2. NIVELET E KAPACITETIT

Gatishmëria përfshinë veprimet për ngritjen dhe mbajtjen e kapaciteteve të nevojshme për zbatimin e gamës së gjerë të aktiviteteve të menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve. Në mënyrë që SIME të funksionoj me efektivitet të plotë, juridiksionet dhe organizatat duhet t'i përcaktojnë pritjet lidhur me kapacitetet dhe resurset që do të afrohen para, gjatë dhe pas një incidenti. Inventarizimi dhe kategorizimi i kapaciteteve dhe resurseve të disponueshme për një incident apo ngjarje të planifikuar është element kritik i gatishmërisë.

B. ARRITJA E GATISHMËRISË

Secili juridiksion duhet të përgatitet herët para incidenteve, në koordinim dhe mbështetje të partnerëve të institucioneve qendrore, OJQ-ve dhe sektorit privat. Në mënyrë që të ndodh një menaxhim emergjent dhe reagim i suksesshëm në incident, personeli i menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatat e tyre përkatëse duhet të kenë kuptim të qartë të roleve dhe përgjegjësisë të tyre. Kjo qartësi është esenciale jo vetëm për personelin e menaxhimit/reagimit emergjent por edhe për ata që veprojnë në rolin e politik-bërjes, koordinimit dhe mbështetjes.

- *Roli politik-bërës:* Krijimi, shqyrtimi, nënshkrimi apo zyrtarizimi i politikave, procedurave, marrëveshjeve të ndihmës reciproke dhe marrëveshjeve të

asistencës dhe planeve të lidhura me programet dhe aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve.

- **Roli koordinues:** Menaxhimi i resurseve apo çdo përpjekje tjetër koordinuese e nevojshme për programet dhe aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve.
- **Roli mbështetës:** Sigurimi i asistencës për programet dhe aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve.

1. SIME DHE MARRËDHËNIA E TIJ ME PLANIN E REAGIMIT KOMBËTAR

SIME afron kornizën për menaxhimin e incidenteve, pa marrë parasysh shkakun, madhësinë, vendndodhjen apo kompleksitetin e tyre. Kjo kornizë vendos strukturën, konceptet, parimet, proceset dhe terminologjinë për angazhimin efektiv kombëtar të kapaciteteve, çoftë nëse këto kapacitete gjenden brenda juridiksionit qendror, regional apo lokal, sektorit privat apo brenda QJQ-ve.

PRK është një kornizë për të gjitha rreziqet e cila ndërtohet mbi SIME-në dhe përshkruan rolet, përgjegjësitë dhe strukturat specifike qeveritare për incidentet në të cilat janë të përfshira resurset qeveritare.

PRK afron strukturë dhe mekanizma për politikatat e nivelit kombëtar dhe drejtim operativ për menaxhimin e incidenteve, për të siguruar mbështetje efektive dhe me kohë, të ndihmës qendrore për aktivitetet homologe të nivelit regional dhe lokal. PRK është i aplikueshëm për të gjitha institucionet qendrore që marrin pjesë në operacione të cilat kërkojnë reagim të koordinuar qendror.

SIME dhe PRK janë të destinuar për përmirësimin e kapaciteteve kombëtare të menaxhimit të incidenteve dhe efikasitetin e përgjithshëm kombëtar. Gjatë incidenteve që kërkojnë mbështetje të koordinuar qendrore, PRK afron udhëzime dhe procedura për integrimin e kapaciteteve dhe resurseve në kornizën kombëtare kohezive, të koordinuar dhe të lehtë për menaxhimin e incidenteve.

Parakusht themelor i SIME-së dhe PRK-së, është ajo që incidentet fillimisht të menaxhohen në nivelin lokal. Në shumicën e incidenteve, resurset lokale, marrëveshjet e ndihmës reciproke dhe marrëveshjet për asistencë, do të afrojnë vijën e parë të menaxhimit emergjent dhe reagimit në incidente. Nëse janë të nevojshme resurset apo kapacitetet plotësuese apo të specializuara, autoritetet përkatëse mund të kërkojnë asistencën qendrore. Si do që të jetë, SIME është i bazuar në konceptin që juridiksionet lokale mbajnë autoritetin e plotë mbi komandën, kontrollin dhe aktivitetet e reagimit për fushat e tyre juridiksionale. Aderimi në SIME iu mundëson strukturave lokale që resurset shtesë t'i përdorin me efikasitet.

Roli themelor i gatishmërisë në menaxhimin emergjent dhe reagimin ndaj incidenteve është koncept universal i inkorporuar edhe në SIME edhe në PRK. Edhe pse elementet specifike të gatishmërisë të përshkruara në të dyja dokumentet mund të ndryshojnë pak midis tyre, konceptet mbeten plotësuese për njëri tjetrin. Elementet

kyçe të ndodhura në kuadër të komponentës së gatishmërisë të SIME-së dhe PRK-së, janë të përshkruar dhe organizuar sipas mënyrës së asistimit më të mirë të akterëve kryesor, në zhvillimin efikas dhe efektiv të kapaciteteve të menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve.

2. ROLET E GATISHMËRISË

Aktivitetet e gatishmërisë duhet të koordinohen midis të gjitha agjencive dhe organizatave përkatëse brenda juridiksionit dhe midis juridiksioneve. OJQ-të dhe sektori privat, duhet të përfshihen në këto përpjekje, përderisa shpeshherë ofrojnë shërbime të lidhura për incidente dhe janë pronar dhe operator të infrastrukturës kritike dhe resurseve kyçe, të cilat mund të përfshihen në menaxhimin emergjent dhe reagimin ndaj incidenteve. Edhe pse jo të integruar drejtpërsëdrejti në SIME, individët luajnë rol kritik në gatishmëri dhe nga ata pritët që ta përgatisin vetveten dhe familjet e tyre për të gjitha llojet e rreziqeve të mundshme. Juridiksionet duhet të kenë programe për përkrahjen dhe mbështetjen e gatishmërisë së individëve dhe të komunitetit (edukimi publik, sesionet trajnuese, demonstrimet praktike), përfshirë përgatitjen e atyre me nevoja të veçanta.

a. Organizmat e gatishmërisë

Organizmat e gatishmërisë ofrojnë koordinim të aktiviteteve të menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve para një incidenti apo ngjarjeje të planifikuar. Këto organizma renditen nga grupet e individëve, tek komitetet e vogla deri tek organizimet e mëdha, të cilët përfaqësojnë morinë e komiteteve, grupeve të planifikimit apo organizimeve tjera. Organizmat e gatishmërisë duhet të takohen rregullisht dhe koordinojnë me njëri -tjetrin për të siguruar një përqendrim adekuat në të ndihmuarit e grupeve dhe juridiksioneve në arritjen e nevojave të tyre të gatishmërisë.

Nevojat e juridiksioneve të përfshira, do të diktojnë se sa shpesh këto organizma duhet të bëjnë punën e tyre dhe mënyrën se si ata do të strukturohen. Kur aktivitetet e gatishmërisë duhet të kryhen rregullisht në juridiksione, organizmat e gatishmërisë duhet të jenë shumë-juridiksional dhe ndërinstytucional si dhe të përfshijnë pronarët dhe operatorët e infrastrukturës kritike, OJQ-të dhe sektorin privat (kur është e nevojshme). Memorandumet apo marrëveshjet duhet të vendosen midis palëve të nevojshme, kështu që secili do të jetë në dijeni të kapaciteteve, pritjeve dhe roleve të tjetrit.

Organizmat e gatishmërisë midis tjerave mund t'i ndërmarrin edhe veprimet në vijim:

- Krijimin dhe koordinimin planeve operative emergjente, protokolleve dhe procedurave, përfshirë komunikimin dhe vetëdijësimin publik.
- Integrimin dhe koordinimin e aktiviteteve dhe funksioneve brenda fushë veprimit të tyre.

- Vendosjen e standardeve, udhëzimeve dhe protokolleve të nevojshme për përkrahjen e ndërveprueshmërisë dhe konsiderimit të aspektit të sigurisë për reaguesit.
- Adaptimin e standardeve, udhëzimeve dhe procedurave për kërkimin dhe sigurimin e resurseve.
- Identifikimin e resurseve dhe nevojave tjera, dhe caktimin e prioriteteve për përdorimin e tyre.
- Inkurajimin e programeve për trajnime, ushtrime, vlerësime dhe veprime korigjuese.
- Sigurimin e vendosjes dhe mirëmbajtjes së marrëveshjeve të nevojshme për ndihmë reciproke dhe marrëveshjeve për ndihmë dhe shpërndarje me OJQ-të dhe sektorin privat.
- Përdorimin e Sistemeve të Koordinimit Ndër-Institucional sipas nevojës, për ngjarjet e planifikuara (paradat apo ngjarjet sportive), apo për llojet specifike të incidenteve (gripi i shpezëve, etj.).
- Planifikimin e mbështetjes operative shkencore, e cila mund të bëhet në çdo nivel të qeverisjes dhe dhënien e kontributit me ide të reja në hulumtimin dhe zhvillimin e teknologjive të reja.
- Kryerjen e analizave pas veprimit për të fuqizuar gatishmërinë në të ardhmen.

b. Zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar

Zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar, duhet të kenë njohje të qartë të roleve dhe përgjegjësi të tyre, për të pasur menaxhim emergjent dhe reagim të suksesshëm në incidente. Në këta zyrtarë përfshihet personeli administrativ dhe politik si dhe udhëheqësit e institucioneve dhe agjencive, të cilët kanë rol udhëheqës në juridiksion, përfshirë ligjvënësit dhe shefat ekzekutiv, qoftë të zgjedhur (kryetarët e komunave), apo të emëruar (koordinatorët regjional dhe drejtorët e drejtorive komunale). Ndonëse rolet e tyre mund të kërkojnë nga ata sigurimin e drejtimit dhe udhëzimeve për strukturat gjatë një incidenti, aktivitetet e tyre të përditshme jo domosdoshmërisht përqendrohen në menaxhimin emergjent dhe reagimin ndaj incidenteve.

Për t'i shërbyer më mirë emërimit të tyre, zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar duhet të bëjnë me sa vijon:

- Kuptojnë, përkushtohen dhe marrin trajnim për SIME-në dhe marrin pjesë në ushtrime.
- Mbajnë një kuptim të menaxhimit elementar emergjent, vijimësisë së operimit dhe vijimësisë së planeve qeveritare, kapaciteteve reaguese të juridiksionit dhe inicimin e shpalljes së gjendjes emergjente.
- Udhëheqin dhe inkurajojnë përpjekjet e gatishmërisë brenda komunitetit, agjencive të juridiksionit, OJQ-ve dhe sektorit privat, sipas nevojës.
- Ndihmojnë në vendosjen e marrëdhënieve (përfshirë marrëveshjet për ndihmë reciproke dhe marrëveshjet për asistencë) me juridiksionet tjera dhe sipas nevojës me OJQ-të dhe sektorin privat.

- Mbështesin dhe inkurajojnë pjesmarrjen në përpjekjet parandaluese brenda juridiksionit dhe sipas nevojës me OJQ-të dhe sektorin privat.
- Ofrojnë udhëzime për juridiksionet, dikasteret dhe agjencitë e tyre me politikatat e vendosura qartë për implementimin e SIME-së.
- Kuptojnë rolet dhe rregullat në juridiksionet e tyre të cilat lidhen me menaxhimin emergjent dhe reagimin ndaj incidenteve.
- Mbajnë njohuri mbi Infrastrukturën Kritike dhe Resurset Kryesore (këtu tutje IKRK) brenda juridiksioneve të tyre, efektet e mundshme të incidenteve mbi to dhe prioritetet e restaurimit të tyre.

Zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar, gjithashtu mund të ftohen të ndihmojnë në përshtatjen dhe rishikimin e ligjeve, politikave dhe buxhetit për të ndihmuar përpjekjet e gatishmërisë dhe për të përmirësuar aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve.

Një incident mund të ketë përzierje të implikimeve politike, ekonomike, sociale, mjedisore, sigurisë publike, shëndetit publik dhe implikime financiare me efekt të mundshëm afatgjatë. Shpeshherë incidentet kërkojnë reagim të koordinuar (midis agjencive, juridiksioneve, OJQ-ve dhe sektorit privat), gjatë të cilëve zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar duhet të marrin vendime të vështira në kushte krize. Zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar duhet të jenë në dijeni të asaj se si mund të funksionojë SIME, për sigurimin e përpjekjes bashkëpunuese të reagimit, në lidhje me zvogëlimin e implikimeve të mundshme të një incidenti.

(1) Zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar gjatë një incidenti

Kryesisht, zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar nuk ndodhen në vendngjarjen e një incidenti, por duhet të kenë mundësinë për tu takuar dhe komunikuar me Komandantin e Incidentit (KI)/Komandën e Bashkuar (KB), sipas nevojës. Varësisht nga natyra e incidentit apo niveli i emergjencës së përgjithshme, zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar do të mund të funksiononin nga lokacionet në vijim:

- Zyrtarët e agjencive apo juridiksioneve;
- Qendrat Operative Emergjente;
- Objektet që shërbejnë si hapësirë për koordinim ndërinstytucional;

Zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar duhet të kontribuojnë në politikatat, drejtimin dhe autoritetin e KI/KB. Koordinimi i duhur midis zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar dhe KI/KB mund të jetë vendimtar për menaxhimin e suksesshëm të një incidenti. Zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar duhet t'i komunikojnë qartë pikëpamjet e tyre tek KI/KB. Sipas diktimit të kohës dhe politikave të agjencive, çështjet në vijim duhet të komunikohen, dokumentohen dhe sigurohen qartë për KI/KB:

- Çështjet e sigurisë;
- Çështjet mjedisore;
- Kufizimet ligjore dhe politike;

- Çështjet e lidhura me shërbimet dhe restaurimet e infrastrukturës kritike;
- Çështjet ekonomike, politike dhe sociale;
- Çështjet financiare;

c. Organizatat Jo-qeveritare

OJQ-të siç janë ato të bazuara në komunitet, besim, apo organizata kombëtare (Kryqi i Kuq), luajnë rol jetik në aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident. OJQ-të të cilat kanë kapacitet dhe vullnet të përfshihen duhet të integrohen plotësisht në përpjekjet përgatitore të juridiksionit, posaqërisht në planifikime, trajnime dhe ushtrime. Për më tepër, duhet të vendosen marrëveshjet me OJQ-të para një incidenti, kështu që secila organizatë është në dijeni të kapaciteteve, pritjeve dhe roleve të organizatave tjera.

Është e rekomanueshme që ekzekutivët kryesor dhe kryesuesit e OJQ-ve ta përdorin SIME-në për ngjarjet e planifikuara apo për incidente, për arsye se përdorimi i tij përmirëson kapacitetin e organizatës, për tu integruar në menaxhimin e incidentit. Edhe pse pajtueshmëria me SIME-në, nuk mandatohen për OJQ-të, aderimi në procedurat dhe terminologjinë e SIME-së kërkon nga Personeli me mision të lidhur për fatkeqësi, që të kaloj trajnimin e nevojshëm, gjë që do të ndihmojë integrimin e vazhdueshëm të OJQ-ve në përpjekjet përgatitore të juridiksionit përkatës.

d. Sekori privat

Sektori privat luan rol jetik në menaxhimin emergjent dhe reagimin ndaj incidenteve, dhe duhet të inkorporohet në të gjitha aspektet e SIME-së. Shërbimet, industrinë, korporatat, bizneset dhe shoqatat profesionale dhe tregtare, në mënyrë tipike janë të përfshira në aspektet kritike të reagimit emergjent dhe menaxhimit të incidentit. Këto organizata duhet të përgatiten për incidentet e të gjitha rreziqeve të cilët mund të ndikojnë në aftësinë e tyre, për të shpërndarë të mira dhe shërbime. Është esenciale që organizatat e sektorit privat të përfshira drejtpërsëdrejti në menaxhimin emergjent dhe reagimin në incident, apo të përcaktuara si komponentë e infrastrukturës kritike (spitalet, kompanitë e shërbimeve publike dhe private, shkollat), të përfshihen, sipas nevojës në përpjekjet përgatitore të juridiksionit. Edhe pse entitetet e sektorit privat nuk mund të obligohen të jenë në pajtim me SIME-në, rekomandohet fuqishëm që ato organizata të sektorit privat të përfshira drejtpërsëdrejti në operacionet reaguese, të kenë personelin e tyre të trajnuar në SIME dhe që elementet reaguese të organizatave të tyre të jenë në pajtim me SIME-në.

Qeveritë e dy niveleve duhet të punojnë me sektorin privat për të caktuar morinë e pritjeve të përbashkëta në pajtim me rolet, përgjegjësitë dhe mënyrat e operimit të nivelit qendror, regional dhe lokal. Këto pritje duhet të përhapen gjerësisht dhe të zhvillohen trajnime dhe ushtrime të nevojshme, në mënyrë që ato të kuptohen plotësisht shumë përpara një incidenti. Këto pritje janë veçanërisht të rëndësishme për organizatat private të përfshira në objektet e IKRK-së. Për më tepër, organizatat e sektorit privat mund të dëshirojnë të hyjnë në marrëveshje për asistencë me qeveritë

apo organizatat tjera të sektorit privat për të qartësuar kapacitetet, rolet dhe pritjet respektive të palëve të përfshira në përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve.

Përfudimisht, sektori privat mund të jetë burim për praktikat më të mira në menaxhimin emergjent dhe reagimin ndaj incidenteve.

Bota akademike gjithashtu luan rol domethënës në sistem. Shumë institucione akademike mund të asistojnë në afrimin e trajnimeve për reaguesit dhe liderët e komunitetit në aspektet e SIME-së. Për më tepër, shumë kurse të studimeve përfshijnë trajnimin dhe konceptet e SIME-së në kurikulimet e tyre. Komuniteti akademik është gjithashtu mjet parësor për zhvillimin e koncepteve dhe parimeve të reja.

4. ELEMENTET E GATISHMËRISË

Përpjekjet e gatishmërisë duhet të vërtetojnë dhe mirëmbajnë planet, politikat dhe procedurat që përshkruajnë se si ato do t'i caktojnë prioritetet, koordinojnë, menaxhojnë dhe mbështesin informimin dhe resurset. Elementet e përshkruara më poshtë ndërtojnë bazamentin e nevojshëm për reagim dhe rimëkëmbje efikase dhe efektive. Mbështetja e vazhdueshme sigurohet nga Instituti i Menaxhimit Emergjent, në fushat në vijim: trajnime dhe ushtrime, kualifikim, licenim dhe çertifikim të personelit dhe çertifikim të pajisjeve.

a. Planifikimi i gatishmërisë

Planet duhet të jenë realiste, të shkallëzuara dhe të aplikuar për të gjitha llojet e incidenteve, nga ndodhitë e përditshme tek incidentet që kërkojnë aktivizimin e ndihmës reciproke ndër-regionale dhe ndër-komunale e deri tek ato që kërkojnë reagim të koordinuar qendror. Planet duhet të krijojnë bazë për trajnime dhe të ushtrohen periodikisht për të siguruar që të gjithë individët e përfshirë në reagim të janë në gjendje t'i zbatojnë detyrat me të cilat janë të ngarkuar. Është esenciale që planet t'i adresojnë trajnimet dhe ushtrimet dhe mundësojnë inkorporimin e analizave pas veprimit, mësimet të mësuara dhe veprimeve korrigjuese me marrëveshje të përgjegjshme në vijim të çdo incidenti apo ushtrimi të madh. Planet duhet të plotësohen periodikisht për t'i reflektuar ndryshimet në menaxhimin emergjent dhe mjedisin e reagimit ndaj incidenteve, sikurse edhe çdo ndryshim tjetër institucional apo organizativ.

Planet duhet të përshkruajnë mënyrën se si do të përdoret personeli, pajisjet dhe burimet tjera qeveritare dhe joqeveritare për mbështetjen e kërkesave të menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident. Planet janë bërthama operative e gatishmërisë dhe ofrojnë mekanizëm për vendosjen e prioriteteve, integrimin e juridiksioneve/organizatave dhe funksioneve të shumta, vendosjen e marrëdhënieve bashkëpunuese dhe sigurojnë që sistemet e komunikimit dhe sistemet tjera mbështesin efektivisht spektrin e plotë të aktiviteteve të menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident. Planet, gjithashtu duhet të inkorporojnë strategjitë për mbajtjen

e vijimësisë së qeverisjes dhe vijimësinë e veprimit gjatë dhe pas incidenteve, afrojnë mekanizma për të siguruar ripërtëritje të infrastrukturës kritike dhe stabilitet ekonomik të komuniteteve dhe përfshijnë planifikimin e hershëm të lidhur me mbrojtjen e reaguesve, menaxhmentit të resurseve dhe menaxhmentit të komunikimit dhe informimit.

Planet duhet t'i integrojnë të gjitha dikasteret, agjencitë dhe organizatat relevante (përfshirë OJQ-të dhe sektorin privat kur është e nevojshme), për të mundësuar aktivitet të koordinuar të menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve. Planet duhet të inkorporojnë procesin e përcaktuar qartë për kërkimin e asistencës nga dikasteret, agjencitë dhe organizatat e nevojshme. Meqenëse është e ditur që juridiksionet dhe organizatat do të hartojnë shumë lloje të planeve (siç janë planet e reagimit, parandalimit dhe rimëkëmbjes) është esenciale që këto plane të koordinohen mirë dhe ta plotësojnë njëri-tjetrin.

Çdo juridiksion në koordinim me agjencitë dhe organizatat përkatëse duhet të hartoj plane të cilat përcaktojnë shtrirjen e aktiviteteve të nevojshme për gatishmëri, menaxhim emergjent dhe reagim ndaj incidenteve për atë juridiksion. Sipas nevojës, juridiksionet gjithashtu duhet të hartojnë plane për skenare specifike të dala nga analizat e tyre të rreziqeve. Këto plane duhet të përshkruajnë strukturat organizative, rolet dhe përgjegjësitë, politikat dhe protokollat për sigurimin e mbështetjes në të gjitha incidentet, si dhe duhet të jenë mjaft gjithëpërfshirëse për plotësimin e nevojave të ndryshme të publikut. Edhe pse përgatitja e publikut është përtej fushëveprimit të SIME-së, planet gjithashtu duhet të përfshijnë vetëdijësimin publik, edukimin dhe planet dhe protokollat e komunikimit.

(1) Kapaciteti i vijimësisë

Fatkeqësitë e fundit natyrore dhe të faktorit njeri, kanë demonstruar nevojën për kapacitet të fuqishëm të vijimësisë në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe në sektorin privat, me qëllim të ruajtjes së formës tonë të qeverisjes sipas kushtetutës dhe vijimësinë e funksioneve esenciale kombëtare në të gjitha rrethanat e mundshme. Të siguruarit që lidhshipi, personeli mbështetës, komunikimi, shërbimet, infrastruktura dhe resurset tjera përkatëse me planifikimin përkatës të vijimësisë dhe menaxhim të programit, janë në dispozicion për mbështetjen e juridiksionit përkatës, është kritike për suksesin e menaxhimit emergjent dhe operacionet e reagimit ndaj incidenteve.

Qëllim i kapacitetit të vijimësisë është posedimi i aftësisë ripërtëritëse për ta përballuar çdo sfidë, kërcënim apo dobësi aktuale dhe të mundshme. Planifikimi i vijimësisë duhet të themelohet në të gjitha organizatat, përfshirë të gjitha nivelet e qeverisjes dhe sektorin privat, si dhe posaqërisht në ato organizata të cilat mbështesin funksionet esenciale kombëtare.

(2) Marrëveshjet për ndihmë reciproke dhe marrëveshjet për asistencë

Marrëveshjet për ndihmë reciproke dhe marrëveshjet për asistencë, janë marrëveshje midis agjencive, organizatave dhe juridiksioneve të cilat sigurojnë mekanizëm për përfitimin e shpejtë të asistencës emergjente në formën e personelit, pajisjeve, materialeve dhe shërbimeve tjera të ngjashme. Objektivi parësor është të mundësohet dislokimi i shpejtë afat shkurtër i mbështetjes emergjente në prag, gjatë dhe pas një incidenti. Marrëveshja e nënshkruar nuk obligon përfitimin apo pranimin e ndihmës por afron mjete për tu përdorur, nëse incidenti e dikton nevojën. Ekzistojnë disa lloje të këtyre marrëveshjeve, duke përfshirë por jo kufizuar, bazuar si në vijim:

- **Ndihma reciproke automatike:** Marrëveshje që premtojnë reagim dhe dërgim automatik të resurseve të kërkuara pa miratim specifik. Këto marrëveshje janë zakonisht kontrata bazike.
- **Ndihma reciproke lokale:** Marrëveshje midis juridiksioneve apo organizatave fqinjë që përfshijnë kërkesën formale për asistencë dhe kryesisht mbulojnë hapësirë më të madhe gjeografike se sa ndihma reciproke automatike.
- **Ndihma reciproke regjionale:** Marrëveshje regjionale për ndihmë reciproke midis shumë juridiksioneve të cilat zakonisht sponzorohen nga këshilli i komunave apo trup i ngjashëm.
- **Marrëveshjet ndërshtetërore:** Asistencë nga jashtë shtetit nëpërmjet marrëveshjeve të mirëkuptimit të cilat mbështesin përpjekjet reaguese.
- **Marrëveshjet ndërkombëtare:** Marrëveshje midis Republikës së Kosovës dhe vendeve tjera për shkëmbimin e aseteve në një emergjencë.
- **Marrëveshjet tjera:** Çdo marrëveshje, qoftë formale apo jo formale, e përdorur për të kërkuar apo siguruar asistencë dhe resurse midis juridiksioneve të çdo niveli të qeverisjes, QJQ-ve apo sektorit privat.

Juridiksionet duhet të jenë palë e marrëveshjeve me juridiksionet apo organizatat përkatëse prej të cilave ato presin të pranojnë asistencë, apo për të cilat duhet të sigurojnë asistencë. Zyrtarët e autorizuar nga secili juridiksion dhe organizatë pjesëmarrëse duhet t'i miratojnë kolektivisht të gjitha marrëveshjet e ndihmës reciproke dhe marrëveshjet e asistencës.

Memorandumet e mirëkuptimit dhe memorandumet e marrëveshjes janë të nevojshme me sektorin privat dhe OJQ-të, përfshirë ato të bazuara në komunitet, besim dhe organizatat kombëtare siç janë: Kryqi i Kuq dhe Shoqatat Humanitare, për të mundësuar shpërndarje me kohë të asistencës gjatë incidenteve.

b. Procedurat dhe protokollet

Procedurat dhe protokollet duhet t'i detajizojnë veprimet specifike për implementimin e planit apo sistemit të caktuar. I gjithë personeli i menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatat e tyre përkatëse, duhet të vendosin procedura dhe protokolle të cilat shndërrohen në lista kontrolluese të drejtuara në veprime specifike për tu përdorur gjatë operacioneve të reagimit në incident.

Procedurat dokumentohen dhe implementohen me lista kontrolluese, lista të resurseve, harta, skema dhe të dhëna tjera përkatëse, mekanizmat për njoftimin e personelit, proceseve për përfitimin dhe përdorimin e pajisjeve, furnizimeve dhe automjeteve, metodat e arritjes së marrëveshjeve për ndihmë reciproke dhe marrëveshjeve për asistencë, mekanizma për raportimin e informacioneve tek qendrat operative të dikastereve dhe qendrat operative emergjente si dhe udhëzimet për operacionet e komunikimit, përfshirë lidhshmërinë midis qeverive, OJQ-ve dhe sektorit privat. Ekzistojnë katër nivele standarde të dokumenteve procedurale:

- *Procedurat standarde operative apo manualët operativ:* Dokument i plotë referues i cili afron qëllimin, autoritetin, kohëzgjatjen dhe detajet për mënyrën e preferuar për zbatimin e një funksioni apo numrit të funksioneve të ndërlidhura në formë unike.
- *Udhëzues për operacionet fushore apo doracak për menaxhimin e incidentit:* Pako e qëndrueshme apo udhëzues xhepi i cili përmban informacione esenciale të nevojshme, për kryerjen e detyrave apo funksioneve të caktuara.
- *Udhëzues për mobilizim:* Dokument referues i përdorur nga agjencitë/organizatat i cili përvijon marrëveshjet, proceset dhe procedurat e përdorura nga të gjitha organizatat pjesëmarrëse për aktivizimin, grumbullimin dhe transportimin e resurseve.
- *Ndihmës pune:* Lista-kontrolluese apo pasqyra tjera ndihmëse të menduara për të siguruar që hapat specifike për kryerjen e detyrës apo angazhimit të përmbushen saktë.

Protokollet janë grup i udhëzimeve të caktuara për veprimet (të cilat mund të caktohen nga individët, ekipet, funksionet apo kapacitetet) në rrethana specifike të ndryshme. Vendosja e protokolleve siguron rangimin në vendosjen e radhës, autorizimeve dhe delegimeve të nevojshme për autorizimin e zbatimit të shpejtë të detyrës, funksionit apo numrit të funksioneve të ndërlidhura pa pas nevojë të kërkohej leje e posaqme. Protokollet lejojnë, autorizojnë personelin e caktuar (bazuar në përvojën dhe autoritetin e deleguar) të vlerësojnë situatën, ndërmarrin hapa të menjëhershëm për intervenim dhe zgjerojnë përpjekjet e tyre deri në nivelin e caktuar para se të jenë të nevojshme udhëzime dhe autorizime tjera plotësuese.

c. Trajnimet dhe ushtrimet

Personeli me rol të caktuar në menaxhim emergjent dhe reagim në incident në të gjitha nivelet e qeverisjes (përfshirë personat me pozitë lidhshme, siç janë zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar), duhet të jenë të trajnuar si duhet, për t'i përmirësuar kapacitetet gjithëkombëtare përball të gjitha rreziqeve. Për më tepër, OJQ-të dhe entitetet e sektorit privat me rol të drejtpërdrejt në operacionet reaguese duhet të inkurajohen fuqishëm që të marrin pjesë në trajnimet dhe ushtrimet e SIME-së. Kurset trajnuese të standardizuara të SIME-së të përqendruara në strukturën, proceset dhe sistemet koordinuese operative, së bashku me kurset e përqendruara në disiplina specifike dhe përvojën e agjencive specifike, ndihmojnë të sigurohemi që personeli i menaxhimit/reagimit emergjent mund të funksionoj së bashku, në mënyrë

efektive gjatë një incidenti. Trajnimet dhe ushtrimet duhet të lidhen në mënyrë specifike për përgjegjësitë e personelit të përfshirë në menaxhimin e incidentit. Monitorimi dhe mundësitë, për lejimin e personelit me më pak përvojë për t'i vëzhguar ata më me shumë përvojë gjatë një incidenti aktual, duhet të përfshihet për ta rritur karakterin e trajnimeve dhe ushtrimeve. Për më tepër, ushtrimet duhet të dizajonohen në atë mënyrë që i lejon personelit të simulojë role të komandimit të shumëfishtë, mbikëqyrjes apo lidhshmërit, kurdo që të jetë e mundur.

Nivelet trajnuese të SIME-së varen nga niveli i përfshirjes së individëve, juridiksioneve apo organizatave në menaxhimin emergjent dhe aktivitetet e reagimit ndaj incidenteve. Trajnimi duhet tu lejoj pjesëmarrësve të:

- Përdorin konceptet dhe parimet e SIME-së në ushtrime, ngjarje të planifikuara dhe incidente aktuale.
- Ndjehen më komod me përdorimin e SIME-së, përfshirë Sistemin e Komandës së Incidentit.

Për ta përmirësuar performancën e SIME-së, personeli i menaxhimit/reagimit emergjent, gjithashtu duhet të marrë pjesë në ushtrimet reale (përfshirë incidentet shumë-disiplinore, shumë-juridiksionale dhe ndërveprimin e OJQ-ve dhe sektorit privat), për ta përmirësuar koordinimin dhe ndërveprimin reciprok. Ushtrimi i vërtetë i komponentëve të SIME-së mund të bëhet duke përdorur një ushtrim apo serinë e ushtrimeve, që secili prej tyre vlerëson aspektet specifike të SIME-së dhe komponentëve të tij. Ushtrimet duhet të bëhen me palët e përcaktuara në planet strategjike dhe operative (planet operative emergjente) përfshirë dikasterët, agjencitë, partnerët e marrëveshjeve të ndihmës reciproke dhe marrëveshjeve të asistencës, OJQ-të dhe sektorin privat.

Ushtrimet duhet të përmbajnë mekanizëm për inkorporimin e veprimeve korigjuese dhe mësimet të mësuara nga incidentet në procesin e planifikimit. Ushtrimet gjithashtu duhet të mbulojnë me sa vijon:

- Të gjitha aspektet e planit, posaqërisht proceset dhe procedurat për aktivizimin e marrëveshjeve lokale, brenda shtetërore dhe ndërshtetërore për ndihmë reciproke dhe asistencë.
- Njohuritë e nevojshme për aktivizimin e këtyre marrëveshjeve.

d. Kualifikimi dhe çertifikimi i personelit

Element kritik i gatishmërisë së SIME-së është përdorimi i standardeve kombëtare të cilat i mundësojnë strukturave të përbashkëta apo kompatible të kualifikojnë, licencojnë dhe çertifikojnë personelin e tyre të menaxhimit/reagimit emergjent. Standardet do të ndihmojnë në të siguarit që personeli i tillë posedon minimumin e njohurive, shkathtësive dhe përvojës së domosdoshme për zbatimin e aktiviteteve të menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident, të sigurt dhe me efektivitet. Në mënyrë tipike standardet përfshijnë trajnimet, përvojën, çertifikimin, vërtetimin dhe

gjendjen fizike dhe mjekësore. Agjencitë certifikuese qendrore, regionale dhe lokale dhe organizatat private dhe profesionale me personel të përfshirë në menaxhimin emergjent dhe reagim në incident, janë të inkurajuar të certifikojnë individët në disiplinat apo juridiksionet e tyre përkatëse.

Kriteri themelor për këtë certifikim vullnetar do të vendoset nga Instituti i Menaxhimit Emergjent, pas konsultimit me ekspertët, partnerët përkatës dhe trupat e njohur autoritativ, të cilët do të detajzojnë standardet e lidhura me pragun minimal, për pozitat specifike të menaxhimit emergjent, i cili i mundëson personelit të certifikuar të marrë pjesë, sipas nevojës, në incidentet e nivelit kombëtar.

e. Certifikimi i pajisjeve

Personeli i menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatat e tyre përkatëse varen nga lloje dhe modele të ndryshme të pajisjeve për zbatimin e detyrave esenciale. Komponentë kritike e gatishmërisë është sigurimi i pajisjeve të cilat do të performojnë sipas standardeve të caktuara, përfshirë kapacitetin për të qenë ndërveprues me pajisjet e përdorura në juridiksionet tjera apo organizatat pjesëmarrëse. Ndërlidhur me këtë është edhe nevoja për të pas pasqyrën e përbashkët të kapaciteteve të pajisjeve të caktuara, për të mundësuar planifikim më të mirë, para një incidenti dhe shkallëzim të shpejtë si dhe fleksibilitet në plotësimin e nevojave të një incidenti.

5. PARANDALIMI/ZBUTJA E EFEKTIT TË RREZIQEVE

Parandalimi/Zbutja: është një element i rëndësishëm i menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve. Ajo siguron bazament kritik në përpjekjen për zvogëlimin e humbjeve në jetë dhe prona si dhe zvogëlimin e dëmeve në mjedis nga fatkeqësitë natyrore dhe të faktorit njeri, duke evituar apo pakësuar efektin e fatkeqësisë. Parandalimi/Zbutja siguron vlerë për publikun duke krijuar komunitete më të sigurta dhe pengimin e ciklit të dëmeve të fatkeqësisë, rindërtimit dhe dëmeve të përsëritura. Veprimet parandaluese/zbutëse duhet të koordinohen me efektivitet midis KI/KB dhe operatorëve të objekteve/shërbimeve të IKRK-së. Këto aktivitete apo veprime në shumcën e rasteve do të kenë efekt të qëndrueshëm afatgjatë. Menaxhimi i rrezikut (proces për matjen apo vlerësimin e rrezikut dhe ndërtimin e strategjive për menaxhimin e tij) është një aspekt esencial i parandalimit/zbutjes.

Në strategjitë e menaxhimit të rrezikut mund të përfshihen evitimi i rrezikut (zhvendosja e strukturave nga zonat e përmytshme), zvogëlimi i efektit negativ të rrezikut (përforcimi i ndërtesave duke vendosur barrierat përreth tyre), apo pranimi i disa apo të gjitha pasojave të rrezikut të caktuar.

Në shembujt e aktiviteteve të parandalimit/zbutjes përfshihen:

- Aktivitetet e vazhdueshme të edukimit publik të destinuara për të zvogëluar humbjet në jetë dhe shkatërrimin e të mirave materiale;

- Përputhja me, apo zgjerimi i menaxhmentit të zonave të përmytura dhe rregulloreve për shfrytëzimin e tokave;
- Fuqizimi i saktë i kodeve të ndërtimit, standardeve seizmike dhe kërkesat për ndërtimet e reja, apo riparimi i ndërtesave ekzistuese;
- Përkrahja e masave për të siguruar mbrojtjen dhe ripërtëritjen e IKRK-së të destinuara për të siguruar vijimësi të biznesit dhe stabilitet ekonomik të komuniteteve;
- Sigurimi i shtëpive apo bizneseve të dëmtuara në zonat e përmytshme, zhvendosja e strukturave dhe kthimi i pronës në hapësirë të hapur, apo për përdorim rekreativ;
- Identifikimi, dhe ri-furnizimi i strehimoreve dhe hapësirave të sigurta për të ndihmuar mbrojtjen e njerëzve në shtëpitë e tyre, ndërtesat publike dhe shkolla në zonat e rrezikshme;
- Implementimi i programit për të dhënat jetike në të gjitha nivelet e qeverisjes për të parandaluar humbjen e dokumenteve dhe të dhënave vendimtare;
- Shkëmbimi i informacioneve inteligjente dhe lidhjet që shpiejnë në aktivitetet tjera të zbatimit të ligjit, siç janë infiltrimi në celulën terroriste për parandalimin e një sulmi;
- Ri- pikëtimi periodik i rreziqeve apo zonave të mundshme të rrezikshme, duke përdor teknikat gjeohapësinore;
- Menaxhimi i të dhënave lidhur me incidentet historike për mbështetjen e analizave dhe planifikimit strategjik;
- Vendosja e rrugëve të evakuimit për rrezikun specifik;

KOMPONENTI II:

KOMUNIKIMI DHE MENAXHIMI I INFORMIMIT

Aktivitetet efektive të menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident varen në besimin në sisteme fleksibile të komunikimit dhe informimit, të cilët sigurojnë pasqyrë të përbashkët operative për personelin e menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatat e tyre përkatëse. Krijimi dhe mbajtja e pasqyrës së përbashkët operative dhe sigurimi i mundësisë për qasje dhe ndërveprim, janë qëllime parimore të komponentës së Komunikimit dhe Menaxhimit të Informimit të SIME-së. Komunikimi i planifikuar, i vendosur dhe i aplikuar si duhet, mundëson shpërndarje të informacioneve midis elementeve të komandës dhe mbështetjes, si dhe sipas nevojës midis agjencive dhe organizatave bashkëpunuese.

Komunikimet në incident lehtësohen përmes hartimit dhe përdorimit të planeve të përbashkëta të komunikimit dhe pajisjeve, proceseve, standardeve dhe arkitekturave ndërvepruese të komunikimit. Gjatë një incidenti, kjo qasje e integruar nxitë njësitë operative dhe mbështetëse të organizatave të ndryshme të mbajnë lidhje komunikimi dhe njohje të situatës. Planifikimi i komunikimit dhe menaxhimit të informimit duhet t'i adresojë politikat, pajisjet, sistemet si dhe standardet e lidhura me incidentet dhe trajnimin e nevojshëm për arritjen e komunikimit të integruar.

A. KONCEPTET DHE PARIMET

Konceptet dhe parimet e përvijuara të kësaj komponente përforcojnë përdorimin e sistemit fleksibil të komunikimit dhe informimit, në të cilin personeli i menaxhimit/reagimit emergjent mund të mbaj rrjedh konstante të informimit gjatë një incidenti. Këto koncepte dhe parime potencojnë nevojën për pasqyrën e përbashkët operative dhe mirëmbajtjen e saj, nevojën për ndërveprueshmëri, siguri, mundësi shkallëzimi dhe mobilitetshmëri si dhe nevojën për aftësi ripërtëritëse dhe zëvendësuese të çdo sistemi dhe përbërësve të tij.

1. PASQYRA E PËRBASHKËT OPERATIVE

Pasqyra e përbashkët operative krijohet dhe mirëmbahet duke grumbulluar, shkrirë, sintetizuar dhe shpërndarë informacionet tek të gjitha palët përkatëse. Arritja e pasqyrës së përbashkët operative i mundëson personelit në vendngjarje dhe jashtë saj (në Post Komandën e Incidentit, Qendrën Operative Emergjente, Grupin e Koordinimit Ndërinstitucional), të kenë të njëjtat informacione për incidentin, përfshirë disponueshmërinë dhe vendodhjen e resurseve si dhe statusin e asistencës së kërkuar. Për më tepër, pasqyra e përbashkët operative afron një këndvështrim të incidentit i cili i mundëson Komandantit të Incidentit (KI), Komandës së Bashkuar (KB) dhe agjencive dhe organizatave mbështetëse të marrin vendime efektive të qëndrueshme dhe me kohë. Në mënyrë që të mbahet njohja me situatën, komunikimi dhe informacionet për incidentin duhet të plotësohen/përditësohen vazhdimisht. Posedimi i pasqyrës së përbashkët operative gjatë një incidenti ndihmon për të siguruar qëndrueshmëri për të gjithë personelin e menaxhimit/reagimit emergjent të angazhuar në një incident.

2. NDËRVEPRUESHMËRIA

Ndërveprueshmëria e sistemve dhe mjeteve të komunikimit i mundëson personelit të menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatave të tyre përkatëse, të komunikojnë brenda dhe midis agjencive dhe juridiksioneve përmes zërit, të dhënave apo në mënyrë video, në kohë reale. Është esenciale që këto sisteme të komunikimit të jenë të afta të ndërveprojnë, meqenëse menaxhimi i suksesshëm emergjent dhe operacionet e suksesshme të reagimit në incident, kërkojnë rrjedhë të vazhdueshme të informacioneve kritike midis juridiksioneve, disiplinave, organizatave dhe agjencive.

Planifikimi i ndërveprueshmërisë kërkon llogaritjen e të pa priturve dhe sfidave të menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident. Planet e ndërveprueshmërisë duhet të përfshijnë çështjet e qeverisjes, procedurave standarde operative (PSO), teknologjisë, trajnimeve dhe ushtrimeve, si dhe çështjet e përdorimit brenda kontekstit të stresit dhe kaosit të përpjekjes më të madhe reaguese. Vendimmarrja e koordinuar midis agjencive dhe juridiksioneve, është e domosdoshme për të vendosur qeverisje të duhur dhe koherente, dhe është kritike në arritjen e ndërveprueshmërisë. Marrëveshjet dhe PSO-të duhet të artikulojnë qartë proceset, procedurat dhe protokollet e nevojshme për arritjen e ndërveprueshmërisë.

3. BESUESHMËRIA, SHKALLZUESHMËRIA DHE MOBILITETI

Sistemet e komunikimit dhe informimit duhet të jenë të dizajnuara që të jenë fleksibile, të besueshme dhe të shkallëzueshme në mënyrë që të funksionojnë në çdo lloj të incidentit, pa marrë parasysh shkakun, madhësinë, vendndodhjen apo kompleksitetin e tij. Ato duhet të jenë të përshtatshme për operim në juridiksion/agjenci më vete, juridiksion më vete me përfshirje të shumë agjencive apo në shumë juridiksione me përfshirje të shumë agjencive. Sistemet e komunikimit duhet të jenë të aplikueshme dhe të pranueshme për shfrytëzuesit, të gatshme për tu

përshtatur me teknologjitë e reja dhe të besueshme në kontekstin e çdo incidenti, në të cilin pritet të reagojë personeli i menaxhimit/reagimit emergjent.

Mobiliteti i radio teknologjive, protokolleve dhe frekuencave midis personelit të menaxhimit/reagimit emergjent do të mundësoj integrim, transportim dhe dislokim të suksesshëm dhe efektiv, të sistemeve të komunikimit kur është e domosdoshme. Mobiliteti përfshinë caktimin e radio frekuencave standarde midis juridiksioneve, gjë që u mundëson reaguesve të marrin pjesë në një incident jashtë juridiksionit të tyre dhe ende të përdorin pajisje të njohura për ta.

Shkallzueshmëria ndryshon nga mobiliteti në atë që: shkallzueshmëria iu mundëson reaguesve ta shtojnë numrin e shfrytëzuesve në sistem, derisa mobiliteti mundëson ndërveprimin e sistemeve të cilat normalisht janë të ndryshëm.

4. RIPËRTRITSHMËRIA DHE ZËVENDËSUESHMËRIA

Ripërtritshmëria është mundësia e sistemeve të komunikimit për të mbijetuar dhe vazhduar të performojnë edhe pas dëmtimit apo humbjes së infrastrukturës. Kjo kërkon nga sistemet e komunikimit të shmangen nga të mbështeturit vetëm në rrjetet e sofistikuar por të cenueshme të sistemeve mbështetëse. Praktikrat e ripërtritshmërisë do mund të përfshinin qendra më të forta dispeqerike dhe sisteme të transmetimit apo infrastrukturës, të cilat mund t'i përballojnë rreziqet e njohura. Hapësirat e antenave transmetuese të jenë të pajisura me sisteme të pavarura të energjisë për të siguruar operim të tyre të vazhdueshëm gjatë shkurtesave të energjisë.

B. KARAKTERISTIKAT E MENAXHIMIT

Personeli i menaxhimit/reagimit emergjent, duhet të jetë në gjendje të menaxhoj komunikimet dhe informimin në incident në mënyrë efektive. Pa marrë parasysh mënyrën e komunikimit të informacioneve, duhet të ndiqen procedurat dhe protokollet e caktuara. Ashtu siç ndryshon teknologjia edhe mënyrat e shkëmbimit të informacioneve përmirësohen, në të njëjtën mënyrë do të evoluojnë edhe procedurat e menaxhimit.

1. LLOJET E STANDARDIZUARA TË KOMUNIKIMIT

Menaxhimi i suksesshëm i komunikimit dhe informimit, kërkon që personeli i menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatat e tyre përkatëse të përdorin lloje të standardizuara të komunikimit. Përcaktimi i individit apo agjencisë/organizatës përgjegjëse për këto komunikime është i shtjelluar në komponentën e komandës dhe menaxhmentit.

Në vijim është lista e llojeve të standardizuara të komunikimit:

- **Komunikimi strategjik:** Drejtim i nivelit të lartë, përfshirë vendimet për caktimin e prioriteteve të resurseve, përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi dhe kurset e veprimit të reagimit të përgjithshëm në incident.
- **Komunikimi operato/taktik:** Komunikimi midis komandës dhe elementeve të mbështetjes dhe sipas nevojës, me agjencitë dhe organizatat bashkëpunuese.
- **Komunikimi mbështetës:** Koordinim në mbështetje të komunikimit strategjik dhe taktik (komunikimi midis spitaleve lidhur me porositjen e resurseve, dërgimin dhe përcjelljen nga qendrat logjistike, komunikimi i trafikut dhe punëve publike).
- **Komunikimi publik:** Paralajmërimi dhe alarmimi emergjent, konferencat për shtyp, etj.

2. POLITIKA DHE PLANIFIKIMI

Politikat dhe planifikimi i koordinuar i komunikimit siguron bazë për menaxhim efektiv të komunikimit dhe informimit. Megjithëse, menaxhimi i komunikimit dhe informimit është i rëndësishëm gjatë operacioneve të rregullta, procedurat dhe protokollet e vendosura mirë, bëhen vendimtare gjatë aktiviteteve të reagimit në incident.

Planifikimi i kujdesshëm duhet të përcaktoj se çfarë sisteme dhe platforma të komunikimit do të përdoren, kush mund t'i përdor ato, cilat informacione janë esenciale në mjediset e ndryshme, parametrat teknik të të gjitha pajisjeve dhe sistemeve si dhe çështjet tjera përkatëse.

Rrjedha e informimit midis të gjitha palëve të interesit është vendimtare, ndërsa ndërveprueshmëria paraqet sfidë shtesë, kur merren parasysh organizatat joqeveritare (OJQ-të), sektori privat dhe pronarët/operatorët e infrastrukturës kritike. Të gjitha palët relevante të interesit duhet të përfshihen në takime dhe sesione të planifikimit, me qëllim të formulimit të planeve dhe strategjive më të plota dhe më të integruara të komunikimit. Standardet e teknologjisë dhe pajisjeve, gjithashtu duhet të ndahen kur është e nevojshme për t'i pajisur palët e interesit me mundësinë për të qenë ndërveprues dhe kompatibil.

Politikat dhe planet e fuqishme të menaxhimit të komunikimit duhet të përfshijnë informacionet lidhur me aspektet e komunikimit dhe menaxhimit të informimit në vijim:

- Nevojat informative duhet të përcaktohen nga juridiksioni/organizata. Këto nevoja zakonisht plotësohen në nivelet qendrore, regjionale dhe lokale në harmoni me OJQ-të dhe sektorin privat dhe parimisht nëpërmjet organizmave të gatishmërisë.
- Sistemi i menaxhimit të informimit i juridiksionit apo organizatës duhet të ofrojë udhëzime, standarde dhe mjete për të mundësuar integrimin e nevojave informative në pasqyrën e përbashkët operative.

- Procedurat dhe protokollet për lëshimin e paralajmërimeve, njoftimeve për incidentin dhe informacioneve tjera vendimtare përhapen nëpërmjet rrjeteve të kombinuara të përdorura nga QOE-të. Njoftimet bëhen tek nivelet përkatëse juridiksionale dhe tek OJQ-të dhe sektori privat përmes mekanizmave të caktuar të specifikuar në planet operative emergjente dhe planet e veprimit në incident.
- Agjencitë në të gjitha nivelet duhet të planifikojnë paraprakisht për përdorimin efektiv dhe efikas të teknologjisë së menaxhimit të informimit (kompjuterët, rrjetet dhe mekanizmat e shkëmbimit të informacioneve) për integrimin e të gjitha funksioneve të komandimit, koordinimit dhe mbështetjes, të përfshira në menaxhimin e incidentit dhe për të mundësuar shkëmbimin e informacioneve kritike dhe regjistrimin e veprimeve të nevojshme korigjuese.

3. MARRËVESHJET

Të gjithë partnerët e identifikuar në procesin e planifikimit pjesëmarrës në planin operativ emergjent të juridiksionit, duhet të kenë marrëveshje të vendosura për të siguruar që elementet brenda planeve dhe procedurave do të jenë në fuqi, në kohën e një incidenti. Marrëveshjet duhet t'i saktësojnë të gjitha sistemet dhe platformat e komunikimit nëpërmjet të cilave palët janë pajtuar t'i përdorin apo shkëmbejnë informacionet.

4. STANDARDET E PAJISJEVE DHE TRAJNIMI

Pajisjet e komunikimit të përdorura nga personeli i menaxhimit/reagimit emergjent, zakonisht konsistojnë nga komponentet dhe sistemet të cilat mund të lidhen nëpërmjet ndërlidhësve të zakonshëm, shumica prej të cilëve, për të siguruar shtyllën e tyre operative mbështeten në sektorin privat. Sistemet publike/private të komunikimit dhe pajisjet e lidhura duhet të përmirësohen dhe plotësohen rregullisht, për arsye se mirëmbajtja e tyre është esenciale për aktivitet të efektshëm të menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident. Kur vendosen standardet lidhur me sistemet dhe pajisjet duhet të merret parasysh gama e gjerë e rrethanave në të cilat do të përdoren sistemet e komunikimit. Trajnimet dhe ushtrimet duhet të angazhojnë sisteme dhe pajisje ndërvepruese, sepse është e domosdoshme që personeli pjesëmarrës t'i kuptoj kapacitetet dhe kufizimet e tyre para një incidenti.

C. ORGANIZIMI DHE OPERACIONET

1. INFORMACIONET E INCIDENTIT

Gjatë kursit të një incidenti, informimi është jetik në asistimin e KI, KB, agjencive dhe organizatave mbështetëse në marrjen e vendimeve. Shumica e informacioneve përdoren për funksione të ndryshme brenda Sistemit të Komandës së Incidentit. Për shembull, i njëjti informacion mund të:

- Ndihmoj në procesin e planifikimit për hartimin e Planit të Veprimit në Incident (PVI).
- Jetë çështje kyçe në publikimin e informacioneve publike.
- Asistoj Sektorin e Financave/Administratës në përcaktimin e kostos së incidentit.
- Përcaktoj nevojën për përfshirje plotësuese të resurseve të OJQ-ve apo sektorit privat.
- Identifikoj çështjet e sigurisë.
- Përcjell një kërkesë për informim.

Në vijim janë shembuj të informacioneve të gjeneruara nga një incident të cilat mund të përdoren për qëllime të vendimmarrjes.

a. Shpallja e incidentit, raportet e situatës dhe raportet e gjendjes

Procedurat e raportimit dhe dokumentimit të incidentit duhet të jenë të standardizuara për t'u siguruar që njohja e situatës po mbahet, dhe që personeli i menaxhimit/reagimit emergjent ka qasje të lehtë në informacionet kritike. Raportet e situatës afrojnë fotografinë e pas periudhës operative dhe përmbajnë informacione të konfirmuara apo vërtetuara lidhur me detajet specifike (kush, çka, kur, ku dhe si), të lidhura me incidentin. Raportet e gjendjes (të cilat mund të përfshihen në raportet e situatës) bartin informacione të lidhura saktësisht për gjendjen e resurseve (disponueshmëria apo angazhimi i tyre).

Transmetimi i të dhënave në formatin e përbashkët, mundëson bartjen e informacioneve përkatëse tek juridiksionet dhe organizatat përkatëse dhe tek sistemi kombëtar, i cili mund të merret me kureshtjet, vlerësimin dhe analizimin e informacioneve të zakonshme dhe atyre inteligjente.

b. Të dhënat analitike

Të dhënat (siç janë informacionet mbi monitorimin e shëndetit publik dhe mjedisit) duhet të grumbullohen sipas mënyrës e cila zbaton përkufizime dhe teknika standarde të grumbullimit të të dhënave. Të dhënat pastaj duhet të transmetohen duke përdorur procese të standardizuara të analizimit. Gjatë incidenteve që kërkojnë nxjerrjen e mostrave të shëndetit publik dhe mjedisit, zakonisht shumë organizata të niveleve të ndryshme grumbullojnë të dhëna, prandaj standardizimi i grumbullimit dhe analizimit të të dhënave është kritik. Për më tepër, standardizimi i mostrimit dhe grumbullimit të të dhënave mundëson analiza më të besueshme dhe përmirëson cilësinë e vlerësimeve të siguruara për vendimmarrësit.

c. Të dhënat gjeohapësinore

Informimi gjeohapësinor është i definuar si informacion që i përket hapësirës gjeografike si dhe karakteristikave të veçorive dhe kufijve natyror dhe të përvijuar. Zakonisht përdoret për integrimin e vlerësimeve, raporteve për situatën dhe shpalljet

e incidentit, në pasqyrën e përgjithshme operative dhe si mjet për shkrirjen dhe analizimin e të dhënave, për sintetizimin e shumë burimeve të të dhënave dhe imazheve. Përdorimi i të dhënave gjeohapësinore (dhe njohja e kapacitetit të tyre inteligjent) është e një rëndësie të madhe gjatë incidenteve. Kapacitetet e informacioneve gjeohapësinore duhet të menaxhohen përmes përpjekjeve të gatishmërisë dhe të integrohen brenda elementeve të komandimit, koordinimit dhe mbështetjes së një incidenti, përfshirë menaxhimin e resurseve dhe informimin publik.

Përdorimi i të dhënave gjeohapësinore duhet të jetë i lidhur me standarde të qëndrueshme, për shkak se ka mundësi të keqinterpretohen, të zhvendosen gabimisht apo të keqpërdoren në ndonjë formë tjetër. Standardet që mbulojnë informimin gjeohapësinor, duhet gjithashtu t'i japin mundësi sistemeve të përdoren në hapësira të largëta fushore apo zonat e shkretuara, ku telekomunikimi nuk është në gjendje të përballoj imazhet e gjera apo mund të jetë i kufizuar në aspektin e pajisjeve elektronike të informatikës.

2. STANDARDET DHE FORMATET E KOMUNIKIMIT

Standardet e komunikimit dhe të dhënave, testimet e ndërlidhura dhe mekanizmat shoqëruar të pajtueshmërisë, janë të nevojshme për tu mundësuar organizatave të ndryshme të punojnë së bashku në mënyrë efektive. Kjo përfshinë vendosjen e serisë së elementeve dhe funksioneve organizative, "klasifikimin" e përbashkët të resurseve për të reflektuar kapacitetet specifike dhe treguesit e përbashkët, për objektet dhe hapësirat operacionale të përdorura për të mbështetur operacionet e incidentit. Terminologjia e përbashkët, standardet dhe procedurat duhet të vendosen dhe detajizohen në plane dhe marrëveshje, kur është e mundur.

Nga juridiksionet mund të kërkohet të jenë në pajtim me standardet kombëtare të komunikimit të ndërveprueshëm. Standardet përkatëse për përdoruesit e SIME-së, do të caktohen nga Instituti i Menaxhimit Emergjent (IME), në partneritet me organizatat e njohura në zhvillimin e standardeve.

a. Procedurat për përdorimin e radiove

Procedurat dhe protokollet për mjetet e komunikimit specifike për incident dhe informacionet tjera kritike të incidentit, duhet të vendosen në marrëveshje apo plane, më herët para ndonjë incidenti. Këto procedura dhe protokolle formojnë bazamentin për hartimin e planit të komunikimit gjatë një incidenti. Për të bërë të njohur pranimin e informacioneve emergjente do të jetë e nevojshme qendra e pranimit. Për më tepër, çdo agjenci/organizatë duhet të jetë përgjegjëse për shpërndarjen e këtyre informacioneve tek personeli i tyre përkatës përgjegjës për planin e komunikimit.

I gjithë personeli i menaxhimit/reagimit emergjent që merr pjesë në aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidentit, duhet t'i ndjek procedurat dhe

protokollat e njohura për vendosjen e ndërveprimit, koordinimit, komandimit dhe kontrollit.

b. Terminologjia e përbashkët, gjuhë e qartë, pajtueshmëri

Mundësitë e personelit të menaxhimit/reagimit emergjent të disiplinave, juridiksioneve, organizatave dhe agjencive të ndryshme për të punuar së bashku, varen shumë nga mundësia e tyre për të komunikuar me njëri tjetrin. Terminologjia e përbashkët i mundëson personelit të menaxhimit/reagimit emergjent të komunikojnë qartë me njëri-tjetrin dhe t'i koordinojnë aktivitetet me efektivitet, pa marrë parasysh madhësinë, shtrirjen, vendndodhjen apo kompleksitetin e incidentit.

Përdorimi i gjuhës së qartë (tekst të pastër), në menaxhimin emergjent dhe reagimin në incident, është çështje e sigurisë publike, e sidomos e sigurisë për personelin e menaxhimit/reagimit emergjent dhe atyre të goditur nga incidenti. Është kritike që të gjithë të përfshirët në një incident të dinë dhe përdorin struktura operative, terminologji, politika dhe procedura të vendosura bashkërisht. Kjo do ta lehtësojë ndërveprimin midis agjencive/organizatave, juridiksioneve dhe disiplinave.

Të gjitha komunikimet midis elementeve organizative gjatë një incidenti, çoftë zanore apo të shkruara, duhet të jenë në gjuhë të qartë, kjo siguron që shpërndarja e informacioneve është me kohë, e qartë, e njohur dhe e kupuar nga të gjithë pranuesit e paraparë. Kodet nuk duhet të përdoren dhe të gjitha komunikimet duhet të jenë të lidhura për mesazhet esenciale. Përdorimi i shkurtesave duhet të shmangët gjatë incidenteve që kërkojnë pjesëmarrjen e shumë agjencive apo organizatave. Politikat dhe procedurat të cilat përvetësojnë pajtueshmërinë duhet të definohen për të mundësuar shkëmbimin e informacioneve midis tërë personelit të menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatave të tyre përkatëse deri në masën më të mundshme.

c. Shifrimi apo gjuha taktike

Kur është e domosdoshme, personeli i menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatat e tyre përkatëse duhet të kenë metodologji dhe sistem të vendosur, për shifrimin e informacioneve në mënyrë që të ruhet siguria. Ndonëse gjuha e qartë mund të jetë e përshtatshme për shumicën e incidenteve, gjuha taktike nganjëherë është e detyrueshme për shkak të natyrës së incidentit (gjatë një ngjarje terroriste në vijim). Përdorimi i shifrimit të specializuar dhe gjuhës taktike duhet të inkorporohet në çdo PVI gjithëpërfshirës apo plan të komunikimit të menaxhimit të incidentit.

d. Sistemi i Informimit të Përbashkët dhe Qendrat e Informimit të Përbashkët

Sistemi i Informimit të Përbashkët (SIP) dhe Qendrat e Informimit të Përbashkët (QIP), janë të destinuara të kujdesen për përdorimin e formave të përbashkëta të komunikimit. SIP integron informacionet e incidentit dhe marrëdhëniet publike, në

organizim të bashkuar të destinuar për të siguruar informim të qëndrueshëm, të koordinuar, të saktë, të pranueshëm dhe me kohë, gjatë krizave apo operacioneve të incidentit.

QIP ofron strukturë për përpilimin dhe shpërndarjen e mesazheve të koordinuara lidhur me incidentin. Ajo harton, rekomandon dhe zbaton planet dhe strategjitë e informimit publik, këshillon KI, KB, agjencitë dhe organizatat mbështetëse lidhur me çështjet e marrëdhënieve publike, të cilat mund të ndikojnë në angazhim, dhe kontrollon thashethemet dhe informatat e pa sakta të cilat do të zvogëlonin besimin e publikut në përpjekjen e reagimit emergjent. QIP është pikë qendrore e kontaktit për media në vendngjarje të një incidenti.

Zyrtarët e informimit publik të të gjitha agjencive/organizatave pjesëmarrëse, duhet të bashkëvendosen në QIP.

e. Procedurat e internetit

Interneti dhe mjetet tjera të bazuara në portale (ëeb), mund të jenë burime për personelin e menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatat e tyre përkatëse. Për shembull, këto mjete mund të përdoren para dhe gjatë incidenteve, si mekanizëm për të afruar njohje të situatës për organizatat/agjencitë të përfshira në incident apo për publikun, kur është e nevojshme.

Procedurat për përdorimin e këtyre mjeteve gjatë një incidenti, duhet të vendosen për t'i përdorur ato si burim me vlerë i sistemit të komunikimit. Informacionet e pasqyruara apo shkëmbyera gjatë një incidenti nëpërmjet këtyre programeve duhet të ndjekin metoda të planifikuara dhe standardizuara dhe përgjithsisht të përputhen me standardet, procedurat dhe protokollat e përgjithshme.

f. Siguria e informacionit

Për të pasur siguri të informimit, duhet të vendosen procedura dhe protokolle. Sigurimi jo adekuat i informimit mund të rezultojë në lëshimin e parakohshëm, të pavend dhe të pjesshëm të tij, gjë që ngrit gjasat e keqkuptimit dhe komplikimit më të madh të çështjeve të sigurisë publike edhe ashtu të komplikuara. Lëshimi i informacioneve të klasifikuara apo senzitive të shëndetit publik, apo të sundimit të ligjit, mund ta rrezikojnë sigurinë kombëtare, hetimet në zhvillim apo shëndetin publik. Keqinformimi mund t'i vë në rrezik njerëzit, të shkaktojë panikë publike dhe të çrregullojë rrjedhën e duhur të informimit. Rregullimi i keqinformimit humbë kohën e çmuar dhe mundin e personelit reagues në incident.

Individët dhe organizatat që kanë qasje në informacionet e incidentit dhe në veçanti kontribuojnë me informacione në sistem (raportet e situatës), duhet të autorizohen dhe çertifikohen si duhet për qëllime sigurie. Kjo kërkon standarde kombëtare të autorizimit dhe çertifikimit për siguri, i cili është fleksibil dhe mjaft i fortë për të siguruar autorizim dhe mbrojtje adekuate të informacionit. Edhe pse IME është përgjegjëse për përkrahjen e vendosjes së këtyre standardeve, të gjitha nivelet e

qeverisjes, OJQ-të dhe sektori privat duhet të bashkëpunojnë në procesin e vërtetimit/autorizimit.

KOMPONENTI III:

MENAXHIMI I RESURSEVE

Menaxhimi emergjent dhe aktivitetet e reagimit në incident, kërkojnë menaxhim të kujdesshëm të resurseve (personelit, ekipeve, shërbimeve, objekteve, pajisjeve, dhe furnizimeve), për plotësimin e nevojave të incidentit. Përdorimi i koncepteve standarde të menaxhimit të resurseve siç janë klasifikimi, inventarizimi, organizimi dhe përcjellja do të ndihmoj dërgimin, dislokimin dhe rimëkëmbjen/riparimin e resurseve para, gjatë dhe pas një incidenti. Menaxhimi i resurseve duhet të jetë fleksibil dhe i shkallëzueshëm në mënyrë që të mbështetë çdo incident dhe të jetë i përshtatshëm me ndryshimet. Dislokimi efikas dhe i dobishëm i resurseve, kërkon që në të gjitha fazat e menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident të përdoren koncepte dhe parime të caktuara.

Nga incidentet e zakonshme lokale e deri tek incidentet që kërkojnë reagim të koordinuar qendror, menaxhimi i resurseve përfshinë koordinimin, mbikëqyrjen dhe proceset që sigurojnë resurse të nevojshme dhe me kohë gjatë një incidenti. Resurset mund të mbështesin operacionet në vendngjarje dhe në komandë, përmes Post Komandës së Incidentit (PKI) apo të funksionojnë brenda Sistemit të Koordinimit Ndër-Institucional (SKNI), duke shërbyer në një Qendër Operative Emergjente (QOE), apo vend të ngjashëm.

Derisa caktohen prioritetet, përcaktohen nevojat dhe porositen, përdoren sistemet e menaxhimit të resurseve për të bërë përpunimin e kërkesave për resurse. Në fazat e para të një incidenti, shumica e resurseve të kërkuara adresohen në nivel lokal apo nëpërmjet marrëveshjeve për ndihmë reciproke dhe marrëveshjeve për asistencë. Derisa një incident rritet në madhësi apo kompleksitet (apo nëse fillon menjëherë në shkallë të gjerë) nevojat për resurse mund të plotësohen edhe nëpërmjet burimeve tjera. Në rastet e konkurimit për resurse kritike, mund të përdoren SKNI-të, për të caktuar prioritetet dhe koordinuar ndarjen dhe shpërndarjen e resurseve, sipas disponueshmërisë së tyre, nevojave të incidenteve të tjera, si dhe sipas detyrimeve dhe çështjeve tjera.

A. KONCEPTET DHE PARIMET

1. KONCEPTET

Konceptet themelore të menaxhimit të resurseve janë:

- **Pajtimi:** Masa të mënyrës standarde për identifikimin, sigurimin, ndarjen dhe përcjelljen e resurseve.
- **Standardizimi:** Klasifikimi i resurseve për ta përmirësuar efektivitetin e marrëveshjeve për ndihmë reciproke apo për asistencë.
- **Koordinimi:** Lehtësimi dhe integrimi i resurseve për dobi optimale.
- **Përdorimi:** Inkorporimi i resurseve të disponueshme nga të gjitha nivelet e qeverisjes, oorganizatat joqeveritare (OJQ-ve) dhe sektori privat, në përpjekjet e juridiksionit në planifikimin e menaxhimit të resurseve.
- **Menaxhimi i informacioneve:** Masat për integrimin e plotë të elementeve të menaxhimit të komunikimit dhe informimit në organizimet, proceset, teknologjitë dhe mbështetjen e vendimmarrjes së menaxhimit të resurseve.
- **Akreditimi:** Përdorimi i kriterëve që sigurojnë trajnim të qëndrueshëm, liçencim dhe standarde të certifikimit.

2. PARIMET

Themelet e menaxhimit të resurseve janë të bazuar në pesë parimet e pëlqyeshme në vijim.

a. Planifikimi

Planifikimi i koordinuar, trajnimi sipas standardeve të përbashkëta dhe ushtrimet gjithëpërfshirëse, sigurojnë bazament për ndërveprueshmëri dhe përputhshmëri të resurseve përgjatë një incidenti. Juridiksionet duhet të punojnë së bashku herët, para një incidenti për t'i hartuar planet për identifikimin, porositjen, menaxhimin dhe angazhimin e resurseve. Procesi i planifikimit duhet të përfshijë identifikimin e nevojave për resurse, bazuar në rreziqet dhe dobësitë e juridiksionit përkatës dhe të ndërtojnë strategji alternative për plotësimin e resurseve të nevojshme.

Planifikimi mund të përfshij krijimin e politikave të reja për inkurajimin e parapozicionimit të resurseve afër vendit të paraparë të incidentit, për plotësimin e nevojave të parapara. Planet duhet t'i parashohin kushtet apo rrethanat të cilat mund të nxisin reagimin e caktuar, siç është ri-furnizimi i resurseve kur inventarët (listat e resurseve) arrijnë minimumin e paracaktuar. Organizatat dhe juridiksionet duhet ta kontrollojnë vazhdimisht gjendjen e resurseve të tyre në mënyrë që të kenë një listë të saktë të resurseve të disponueshme, në çdo kohë të dhënë. Për më tepër, personeli i menaxhimit/reagimit emergjent duhet të jetë i familjarizuar me *Planin e Reagimit Kombëtar* dhe duhet të jetë i përgatitur të integrohet dhe koordinoj me resurset qendrore.

b. Përdorimi i marrëveshjeve

Marrëveshjet midis të gjitha palëve që afrojnë apo kërkojnë resurse janë të domosdoshme, për të mundësuar menaxhim efikas dhe efektiv të tyre, gjatë zhvillimit të operacioneve të incidentit. Kjo përfshinë vendosjen dhe mbajtjen e marrëveshjeve dhe kontratave të qëndrueshme për shërbime dhe furnizime.

c. Kategorizimi i resurseve

Resurset organizohen sipas kategorisë, natyrës, llojit, madhësisë, kapacitetit, mundësive, shkathtësive dhe karakteristikave tjera. Kjo e bënë procesin e porositjes dhe dërgimit të resurseve në juridiksion dhe në mes juridiksioneve apo midis të gjitha niveleve të qeverisjes, OJQ-ve dhe sektorit privat, më të efektshëm dhe siguron që resurset e nevojshme të pranohen.

d. Identifikimi dhe porositja e resurseve

Procesi i menaxhimit të resurseve përdor metoda të standardizuara për të identifikuar, porositur, mobilizuar dhe përcjell resurset e nevojshme për mbështetjen e aktiviteteve të menaxhimit të incidentit. Ata që bartin përgjegjësi të menaxhimit të resurseve i përmbushin këto detyra, qoftë me kërkesën e Komandantit të Incidentit (KI), apo në pajtim me nevojat e planifikuara. Identifikimi dhe porositja e resurseve janë të gërshtuara. Në disa raste, procesi i identifikimit dhe porositjes është i ngjeshur, ku një KI vendos për resurset e nevojshme për detyrën e caktuar dhe saktëson porositjen personalisht drejtpërsëdrejti. Mirëpo në incidentet më të mëdha apo më komplekse, KI mund të mos jetë plotësisht në dijeni të resurseve në dispozicion. Në këtë pikë, KI mund t'i përcaktoj nevojat në bazë të objektivave të incidentit dhe ta përdor procesin e menaxhimit të resurseve për plotësimin e këtyre nevojave.

e. Menaxhimi efektiv i resurseve

Menaxhimi i resurseve përfshinë procedurat e sigurimit të resurseve, menaxhimin e informimit si dhe sistemet dhe protokollat rezervë për porositjen, mobilizimin, dërgimin dhe demobilizimin e resurseve.

(1) Procedurat e sigurimit/përvetësimit

Procedurat e sigurimit përdoren për plotësimin e resurseve për mbështetjen e nevojave operative. Shembujt përfshijnë caktimin e misioneve, kontraktimin, nxjerrjen nga stoqet ekzistuese dhe realizimin e blerjeve të vogla. Aspekti kryesor i procesit të inventarizimit është, përcaktimi nëse një organizatë duhet të ruaj/deponoj gjërat specifike para një incidenti. Resurset materiale mund të sigurohen heret dhe rezervohen apo plotësohen "pikërisht në kohë" përmes kontratave përkatëse para incidentit. Ata që bartin përgjegjësi të menaxhimit të resurseve marrin këtë vendim duke marrë parasysh urgjencën e nevojës, qoftë nëse gjërat e nevojshme apo sasitë e

mjaftueshme janë në dispozicion, qoftë nëse gjërat e nevojshme mund të prodhohen mjaftë shpejtë për të plotësuar kërkesën e caktuar.

Mbështetja strikte në rezerva ngrit çështjet që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë dhe kohëzgjatjen, megjithatë, mbështetja strikte në resurset “saktësisht në kohë” ngritë çështjet më vete të lidhura me shpërndarjen me kohë.

Asetet që llogariten “saktësisht në kohë”, duhet të llogariten saktësisht për të siguruar që juridiksionet e shumëfishta apo organizatat e sektorit privat, nuk mbështeten vetëm në të njëjtin aset reagues, gjë që mund të shpie drejt mungesës gjatë reagimit. Ata që kanë përgjegjësi të menaxhimit të resurseve duhet të krijojnë fonde të mjaftueshme në buxhetet e tyre për plotësime periodike, mirëmbajtje parandaluese dhe përmirësime kapitale. Një pjesë integrale e procedurave të sigurimit/përfitimit është vendosja e metodave dhe protokolleve për trajtimin dhe shpërndarjen e resurseve.

(2) Sistemet informative të menaxhmentit

Këto sisteme përdoren për të siguruar informacione për mbështetjen e vendimeve për menaxherët, nëpërmjet grumbullimit, plotësimit dhe përpunimit të të dhënave dhe përcjelljes së resurseve. Ato ngrisin rrjedhën e informatave për gjendjen e resurseve dhe sigurojnë të dhëna aktuale në mjedis të bartjes së shpejtë, ku juridiksionet e ndryshme, personeli i menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatat e tyre përkatëse menaxhojnë aspekte të ndryshme të incidentit dhe u duhet t'i koordinojnë përpjekjet e tyre. Shembujt e sistemeve të informimit të menaxhmentit përfshijnë, përcjelljen e resurseve, përcjelljen e transportimit, menaxhimin e inventarëve, raportimin dhe sistemet informative gjeografike. Kjo zgjedhje dhe përdorimi i sistemeve për menaxhimin e resurseve duhet të bazohet në identifikimin e nevojave për informacione brenda juridiksionit përkatës.

(3) Sistemet rezervë të informimit

Ata që bartin përgjegjësi të menaxhimit të resurseve, duhet të jenë në gjendje t'i identifikojnë dhe aktivizojnë sistemet rezervë për menaxhimin e resurseve, në rastet kur sistemi parësor informativ i menaxhmentit të resurseve çrregullohet apo nuk është në dispozicion. Sistemet e menaxhimit të informacioneve duhet gjithashtu të kenë mjaftë rezerva dhe furnizues të ndryshëm me energji dhe kapacitet të mjaftueshëm të komunikimit.

(4) Protokollet e porositjes, mobilizimit dhe demobilizimit

Me rastin e kërkimit të resurseve, ndiqen protokollet për caktimin e prioriteteve të kërkesave, aktivizimin dhe mobilizimin e resurseve për incidente dhe rikthimin e tyre në gjendjen paraprake. Organizmat e gatishmërisë vendosin protokolle standarde për tu përdor brenda juridiksionit të tyre. Shembujt përfshijnë sistemet e përcjelljes të cilët identifikojnë vendndodhjen dhe gjendjen e resurseve, të mobilizuara apo

dërguara si dhe procedurat për mobilizimin e resurseve dhe kthimin e tyre në gjendjen dhe vendndodhjen burimore.

B. MENAXHIMI I RESURSEVE

Për implementimin e këtyre koncepteve dhe parimeve në detyrat parësore të menaxhimit të resurseve SIME përfshinë procedura, metodologji dhe funksione të standardizuara në procesin e tij shtatë hapësh të menaxhimit të resurseve. Ky proces reflekton çështjet funksionale, faktorët gjeografik dhe praktikat e dëshmuara brenda disiplinave dhe është rregulluar vazhdimisht në raport me njohuritë e reja.


Mirëmbajtja e resurseve është e rëndësishme përgjatë tërë aspekteve të menaxhimit të resurseve. Mirëmbajtja para dislokimit të resursit siguron disponueshmëri dhe kapacitet.

Mirëmbajtja gjatë fazës së dislokimit siguron kapacitet të vazhdueshëm, siç është furnizimi adekuat me karburante gjatë përdorimit. Inspektimi dhe mirëmbajtja pas-operacionale siguron disponueshmëri të ardhshme.

Bazamenti për menaxhimin e resurseve i siguruar në këtë komponent do të zgjerohet dhe përmirësohet me kalimin e kohës në përpjekjen bashkëpunuese ndër-juridiksionale, ndër-disiplinore e udhëhequr nga Instituti i Menaxhimit Emergjent.

Procesi i menaxhimit të resurseve mund të ndahet në dy pjesë: menaxhimi i resurseve si një element i gatishmërisë dhe menaxhimi i resurseve gjatë një incidenti. Aktivitetet e gatishmërisë (klasifikimi i resurseve, akreditimi dhe inventarizimi), zhvillohen në vijimësi për të ndihmuar në të siguruarit që resurset janë të gatshme për tu mobilizuar kur ftohen në një incident. Menaxhimi i resurseve gjatë një incidenti është proces i caktuar (shih. Figurën 1), me fillim dhe mbarim të dallueshëm specifik për nevojat e incidentit të caktuar.

Figura 1. Menaxhimi i resurseve gjatë një incidenti



1. IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE

Kur ndodh një incident, ata që bartin përgjegjësi të menaxhimit të resurseve duhet vazhdimisht të identifikojnë, përmirësojnë dhe vërtetojnë kërkesat e resurseve. Ky proces përfshinë identifikimin me saktësi të asaj se çka dhe sa është e nevojshme, ku dhe kur është e nevojshme dhe kush do t'i pranoj apo përdor ato. Në resurset për tu identifikuar, në këtë mënyrë përfshihen pajisjet, furnizimet, shërbimet dhe personeli apo ekipet e reagimit emergjent. Nëse kërkuesi është në pamundësi të përshkruaj një gjë sipas llojit apo klasifikimit, ata që kanë përgjegjësi të menaxhimit të resurseve duhet të afrojnë këshilla teknike për të mundësuar të përcaktohen kërkesat dhe të shndërrohen në specifikacion përkatës.

Disponueshmëria e resurseve dhe kërkesat do të ndryshojnë vazhdimisht me evolimin e incidentit. Rrjedhimisht gjithë personeli i menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatat e tyre përkatëse që marrin pjesë në një operacion, duhet të koordinojnë ngushtë përgjatë këtij procesi. Koordinimi duhet të filloj sa më heret që të jetë e mundur, e preferueshme para nevojës për aktivitete të reagimit në incident.

Në rrethanat kur një incident është i projektuar të ketë implikime katastrofike (si: shtrëngatë; apo përmbytje e madhe), qeveria dhe degët e saj regjionale mund t'i parapozicionojnë resurset në zonën e parashikuar të incidentit. Në rastet kur ekziston

kohë për vlerësimin e kërkesave dhe planifikim për incident katastrofik, reagimi qendror do të koordinohet me juridiksionet regjionale dhe lokale dhe pozicionimi i resurseve qendrore do të bashkangjitet për adresimin e situatës specifike.

2. POROSITJA DHE SIGURIMI

Kërkesat për resurset që nuk mund të sigurohen në nivel lokal, dorëzohen duke përdorur procedura standarde për porositjen e resurseve. Kryesisht këto kërkesa së pari dërgohen tek një lokalitet fqinjë apo në regjion e pastaj në qendër.

Ciklet e vendimit për vendosjen dhe plotësimin e porosive të resurseve janë të ndryshme për personelin fushor/vendngjarje, me përgjegjësi të menaxhimit të resurseve dhe proceseve të koordinimit të resurseve, siç është SKNI. KI do t'i bëjë kërkesat për resurse në bazë të prioriteteve që marrin parasysh periudhat aktuale dhe pasuese operative. Vendimet lidhur me ndarjen e resurseve janë të bazuara në protokollet e organizatës apo agjencisë dhe ndoshta edhe kërkesat e incidenteve tjera. Resurset e kërkuara do të mobilizohen vetëm me pëlqimin e juridiksionit nga i cili është kërkuar të sigurohen resurset e caktuara. Mospërputhjet midis resurseve të kërkuara dhe atyre të disponueshme për shpërndarje, duhet të komunikohen tek pala kërkuuese.

3. MOBILIZIMI

Personeli i menaxhimit/reagimit emergjent fillon mobilizimin kur njoftohet përmes kanaleve të caktuara zyrtare. Në kohën e njoftimit ata japin datën, kohën dhe vendin ku duhet shkuar, mënyrën e transportimit për në incident, kohën dhe datën e menduar për arritje, vendin e raportimit/paraqitjes (adresën, emrin e personit për kontakt dhe numrin e telefonit), detyrën e pritur në incident, kahjen e parashikuar për dislokim, numrin e porosisë së resursit, numrin e incidentit, si dhe shpenzimet e zbatueshme dhe kodet financiare. Proceset e përcjelljes së resurseve dhe mobilizimit janë drejtëpërsëdrejti të lidhura. Kur resurset arrijnë në vendngjarje ato duhet të kontrollohen formalisht/në mënyrë korrekte. Kjo e fillon procesin e kontrollit të hyrjes në vendngjarje dhe vërteton porositë e kërkuara. Njoftimi që resurset kanë arritur bëhet nëpërmjet kanaleve përkatëse.

Procesi i mobilizimit mund të përfshijë planifikimin e dislokimit, bazuar në udhëzimet ekzistuese ndër-institucionale të mobilizimit, pajimit, trajnimit, përcaktimit të pikave të grumbullimit të cilat kanë hapësira të përshtatshme për mbështetje logjistike, dhe sigurimit të transportit për dërgimin e resurseve në incident sa më shpejtë, në linjë me prioritetet dhe buxhetin e disponueshëm. Planet e mobilizimit duhet të pranojnë që disa resurse janë hapësira fikse, siç janë laboratorët, spitalet, QOE-të, strehimoret dhe sistemet e menaxhimit të mbeturinave. Këto shërbime ndihmojnë operacionet pa u zhvendosur në zonën e incidentit. Planet dhe sistemet për monitorimin e gjendjes së mobilizimit të resurseve duhet të jenë mjaft fleksibile për tu adaptuar për të dyja llojet e mobilizimit.

Manaxherët duhet të planifikojnë dhe përgatiten për procesin e demobilizimit në të njëjtën kohë kur e fillojnë procesin e mobilizimit të resurseve. Planifikimi i hershëm për demobilizim mundëson llogaridhënie dhe e bënë transportimin e resurseve sa më efikas që është e mundur në të dy aspektet, atë të kostos dhe kohës së shpërndarjes.

4. PËRCJELLJA DHE RAPORTIMI

Përcjellja e resurseve është proces standard i integruar i zhvilluar para, gjatë dhe pas një incidenti nga i gjithë personeli i menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatat e tyre përkatëse. Ky proces siguron pasqyrë të qartë të asaj se ku janë të vendosura resurset, ndihmon personelin të përgatitet për pranimin e tyre, ruan sigurinë e pajisjeve, furnizimeve dhe personelit, dhe mundëson koordinimin dhe qarkullimin e tyre. Ata që bartin përgjegjësi të menaxhimit të resurseve përdorin procedurat e vendosura për t'i përcjell në vijimësi resurset nga mobilizimi e deri tek demobilizimi. Manaxherët duhet t'i ndjekin të gjitha procedurat për sigurimin dhe menaxhimin e resurseve, duke përfshirë bashkërendimin, llogaritjen, auditimin dhe inventarizimin e tyre.

5. RIMËKËMBJA DHE DEMOBILIZIMI

Rimëkëmbja/riparimi, përfshinë sistemimin përfundimtar të resurseve, përfshirë edhe ato të vendosura në incident edhe ato në hapësira/objekte fikse. Gjatë këtij procesi, rehabilitohen resurset, rimbushen/furnizohen, shkarkohen dhe/apo kthehen prapa.

Demobilizimi është kthimi i organizuar, i sigurtë dhe efikas i një resursi të incidentit në gjendjen dhe vendin e mëparshëm burimor. Mund të filloj në çdo pikë të një incidenti, por duhet të filloj sa më shpejtë që të jetë e mundur për të mundësuar llogaridhënie të mirëfilltë. Procesi i demobilizimit duhet të koordinohet midis incidentit (eve) dhe SKNI-ve për të bërë ri-aktimin e resurseve, nëse është e nevojshme dhe për t'i caktuar prioritetet për nevoja kritike gjatë demobilizimit.

Njësia e Demobilizimit në Sektorin e Planifikimit, harton një plan të demobilizimit nga incidenti, i cili përmban udhëzime specifike të demobilizimit. Planet dhe proceset e demobilizimit duhet të përfshijnë masat që rregullojnë kthimin e sigurtë të resurseve në gjendjen dhe vendet e tyre burimore dhe njoftimin e kthimit të tyre. Demobilizimi, gjithashtu duhet t'i përfshij proceset për përcjelljen e resurseve dhe për adresimin e kompensimeve në fuqi. Për më tepër, dokumentacioni lidhur me transportimin e resurseve duhet të grumbullohet dhe ruhet për çështje të kompensimit, nëse aplikohet.

a. Resurset jo të harxhueshme

Resurset jo të harxhueshme (personeli, automjetet e zjarrfikjes dhe pajisjet e qëndrueshme) llogariten plotësisht edhe gjatë incidentit edhe kur ato kthehen tek organizata që e ka siguruar. Organizata pastaj rikthen resurset në kapacitetin e plotë

funksional dhe i përgatit ato për mobilizimin e radhës. Gjërat e prishura apo humbura, duhet të zëvendësohen përmes sistemit përkatës për ri-furnizim nga organizata me përgjegjësi faturuese për incident, apo sipas përcaktimeve në marrëveshjet ekzistuese. Është me rëndësi që resurset e ambienteve fikse, gjithashtu të rikthehen në kapacitetin e tyre të plotë funksional, me qëllim të sigurimit të gatishmërisë për mobilizimin e radhës. Në rastin e resurseve njerëzore (Ekipet e Menaxhimit të Incidentit), duhet të sigurohen hapësira dhe kohë e përshtatshme për pushim dhe rikuperim. Gjithashtu, duhet të adresohen edhe çështjet e shëndetit profesional dhe atij mendor, përfshirë monitorimin e efekteve të menjëhershme dhe afat-gjata të incidentit (kronike dhe akute), në personelin e menaxhimit/reagimit emergjent.

b. Resurset e harxhueshme

Resurset e harxhueshme, siç janë uji, ushqimi, karburantet dhe furnizimet tjera të përdorimit të njehershëm, duhet të llogariten plotësisht. Organizata e menaxhimit të incidentit bartë kostot e resurseve të harxhueshme, sipas autorizimeve në marrëveshjet financiare të zbatuara nga organizmat e gatishmërisë. Resurset e kthyer të cilat nuk janë në gjendje të restaurimit, qoftë të harxhueshme apo të pa harxhueshme, duhet të deklarohen si teprica sipas rregulloreve dhe politikave të caktuara të juridiksionit, agjencisë apo organizatës kontrolluese.

Menaxhimi i mbeturinave është çështje e posaçme në procesin e rimëkëmbjes së resurseve, si ato që kërkojnë trajtim dhe hudhje të veçantë (mbeturinat biologjike dhe furnizimet, rrënojat dhe pajisjet e kontaminuara), trajtohen sipas rregullave dhe politikave të caktuara.

6. KOMPENSIMI

Kompensimi afron mekanizëm për kompensimin e fondeve të shpenzuara për aktivitetet specifike për incidentin. Proceset për kompensim, luajnë një rol të rëndësishëm në vendosjen dhe mbajtjen e gatishmërisë së resurseve dhe duhet të jenë të vendosura për të siguruar që, furnizuesit me resurse të kompensohen me kohë. Ato duhet të përfshijnë mekanizmat për grumbullimin e faturave, vërtetimin e shumave të shpenzuara kundrejt shtrirjes së detyrës, sigurimin e përfshirjes së autoriteteve të nevojshme dhe qasjen në programet e kompensimit. Mekanizmat e kompensimit duhet të jenë të përfshirë në planet e gatishmërisë, marrëveshjet e ndihmës reciproke dhe marrëveshjet e asistencës.

7. INVENTARIZIMI

Menaxhmenti i resurseve përdor sisteme të ndryshme të inventarizimit të resurseve për të bërë vlerësimin e disponueshmërisë së aseteve të siguruar përmes juridiksioneve. Organizmat e gatishmërisë duhet të inventarizojnë dhe mbajnë të dhëna aktuale mbi resurset e tyre të disponueshme. Të dhënat pastaj i vëhen në dispozicion qendrave të komunikimit/dispeqerive dhe QOE-ve si dhe strukturave

brenda SKNI-së. Resurset e pëcaktuara brenda një sistemi të inventarizimit nuk janë tregues i disponueshmërisë automatike. Juridiksioni apo pronari i resurseve bartë përgjegjësinë përfundimtare të përcaktimit të disponueshmërisë së tyre.

Sistemet e inventarizimit për menaxhimin e resurseve duhet të jenë me mundësi përshtatjeje dhe shkallëzimi, si dhe duhet të llogarisin për mundësinë e dyfishimit të personelit apo pajisjeve. Përmbledhjet e resurseve në veçanti duhet të reflektojnë qartë çdo mbingarkim/dyfishim të personelit midis grupeve të ndryshme të resurseve. Inventarët e personelit duhet të reflektojnë resursin e vetëm me shkathtësi të shumëfishtë, duke u kujdesur të mos teprohet shuma e përgjithshme e resurseve. Për shembull, shumë zjarrfikës kanë edhe certifikata të Teknikëve Emergjent Mjekësor (TEM). Përmbledhja e resurseve pastaj mund ta llogarit zjarrfikësin si zjarrfikës apo TEM, por jo për të dyja. Shuma e përgjithshme duhet të reflektoj numrin e përgjithshëm të personelit të disponueshëm.

Resurset e lëvizshme kanë profil të ndryshëm të inventarizimit, porositjes dhe reagimit, varësisht nga përdorimi i tyre parësor gjatë fazave të reagimit dhe rimëkëmbjes të një incidenti. Planifikimi për përdorimin, inventarizimin dhe përcjelljejen e resurseve duhet të pranojë diferencën themelore në dislokimin e resurseve në fazat e reagimit dhe rimëkëmbjes. Faza e reagimit mbështetet fuqishëm në marrëveshjet e ndihmës reciproke dhe marrëveshjet për asistencë, derisa resurset e rimëkëmbjes zakonisht përfitohen nëpërmjet kontratave me OJQ-të dhe sektorin privat.

a. Akreditimi/Nostrifikimi

Procesi i akreditimit ngërthen në vete vlerësimin objektiv dhe dokumentimin e certifikatës, licencës apo diplomës ekzistuese të një individi, nivelin e trajnimit dhe përvojës, dhe zotësinë apo aftësinë për t'i plotësuar standardet e pranuar kombëtare, të afrojnë shërbime të caktuara apo funksione, si dhe për të kryer detyra të caktuara, në rrethana të caktuara, gjatë një incidenti.

Sipas SIME-së akreditimi është proces administrativ për vërtetimin e kualifikimeve të personelit dhe sigurimit të autorizimeve për kryerjen e funksioneve të caktuara dhe për të pas qasje të caktuar në një incident që përfshinë ndihmën reciproke.

Edhe pse akreditimi përfshinë lëshimin e kartës së identifikimit apo vërtetimit, ai është i ndarë dhe i ndryshëm nga procesi i shenjzimit në incident. Kur qasja në një vend kontrollohet nëpërmjet shenjave identifikuese speciale, procesi i shenjzimit duhet të jetë i bazuar në verifikimin e identitetit, kualifikimit dhe autorizimit për dislokim.

Organizatata që përdorin vullnetarë, e sidomos vullnetarë spontan, janë përgjegjëse për të siguruar të drejtën e secilit vullnetar për të marrë pjesë në reagim. Këto organizata/agjenci qeveritare përgjegjëse për koordinimin e reagimeve emergjente, agjencitë e menaxhimit të vullnetarëve (Kryqi i Kuq), dhe shfrytëzuesit tjerë të

mundshëm të vullnetarëve (spitalet, dikasteret e zjarrfikjes dhe policisë, etj.), duhet të vendosin protokolle që qeverisin mënyrën e aktivizimit dhe përdorimit të vullnetarëve.

b. Identifikimi dhe klasifikimi i resurseve

Klasifikimi i resurseve është kategorizim sipas kapacitetit, resurseve të kërkuara, dislokuara dhe të përdorura në incident. Standardet matëse që përcaktojnë kapacitetin dhe nivelin e performacës së resursit, shërbejnë si bazë për kategorizim. Shfrytëzuesit e resurseve në të gjitha nivelet i përdorin këto standarde për identifikimin/përcaktimin dhe inventarizimin e resurseve. Për nga natyra resurset mund të ndahen në nën-kategori, për definim më të saktë të kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave specifike. Klasifikimi i resurseve është proces i vazhdueshëm, i dizajnuar për të qenë sa më i thjeshtë që është e mundur dhe për të mundësuar përdorimin e rregullt dhe saktësi në plotësimin e resurseve të nevojshme. Për t'i lejuar resurset të dislokohen dhe përdoren në baza kombëtare, IME (me kontributin e organizatave qendrore, regjionale, lokale, sektorit privat, joqeveritare dhe organizatat profesionale kombëtare), është përgjegjëse për mundësimin e vendosjes dhe publikimit të standardeve kombëtare, për klasifikimin e resurseve dhe për të siguruar që këto resurse të klasifikuara, reflektojnë kapacitetin operativ të tyre.

(1) Kategoria

Ky është funksion për të cilin resursi do të jetë më i dobishëm. Tabela 2 renditë shembujt e kategorive të përdorura në protokollin qendror të klasifikimit të resurseve.

Tabela 2. Shembull i kategorive për klasifikimin qendror të resurseve

• Transporti	• Shëndeti dhe mjekësia
• Komunikimi	• Kërkimi dhe shpëtimi
• Punët publike dhe inxhinierike	• Reagimi ndaj materieve të rrezikshme
• Zjarrfikja	• Ushqimi dhe uji
• Informimi dhe planifikimi	• Energjia
• Sundimi i ligjit dhe siguria	• Informimi publik
• Kujdesi masiv	• Çështjet e kafshëve dhe bujqësore
• Menaxhimi i resurseve	• Vullnetarët dhe donacionet

(2) Natyra e resursit

Natyrat i referohet klasave të gjera që karakterizojnë resurset e ngjajshme siç janë ekipet, personeli, pajisjet, artikujt furnizues, automjetet dhe fluturaket.

(a) Komponentët

Komponentët janë elementet që e përbëjnë resursin. Për shembull, një kompani makinash mund të renditet si poseduese e tetë elementeve të pasqyruara më poshtë në tabelën 3.

**Tabela 3. Shembull i Resursit me shumë Komponentë
(Ekipi Zjarrfikës)**

(1) Pompë	(5) Cisternë uji
(2) Zorrë 2½"	(6) Shkallë
(3) Zorrë 1¾"	(7) Derdhës kryesor
(4) Vegla dore	(8) Personel

Si një shembull tjetër, ekipet standarde të kërkim shpëtimit urban përbëhen nga dy ekipe me nga 31 persona, katër qen dhe pako me pajisje gjithëpërfshirëse. Pakoja është e ndarë në pesë elemente të ndara me ngjyra të ndryshme dhe është e ruajtur në kontejner të cilët plotësojnë këkesa specifike.

(b) Masat

Masat janë standarde të cilat përcaktojnë mundësitë apo kapacitetin. Masat specifike të përdorura do të varen nga natyra e resursit të klasifikuar dhe misioni i paraparë. Masat duhet të jenë të dobishme në përshkrimin e kapacitetit të resursit për mbështetjen e misionit. Si një shembull, masa për ekipin për asistencë në fatkeqësitë mjekësore është: numri i pacientëve të cilët mund të trajtohen në ditë. Një masë e përshtatshme për tubin mund të jetë sasia e ujit që rrjedh nëpër të për një orë.

(3) Lloji

Lloji i referohet nivelit të kapacitetit të resursit. Caktimi i klasës "Lloji 1" për resursin tregon që ka nivelin e kapacitetit më të madh se klasifikimi. "Lloji 2" i të njëjtit resurs (për shembull, për shkak të fuqisë, madhësisë apo kapacitetit të tij), dhe kështu me radhë deri te "Lloji 4". Klasifikimi pajis menaxherët me informacione plotësuese për t'i ndihmuar ata në përzgjedhje dhe përdorim sa më të mirë të resurseve. Në disa raste, resursi mund të ketë më pak apo më shumë se katër lloje, në rastet e tilla, ose do të caktohen lloje plotësuese ose lloji do të përshkruhet si "i pa përdorshëm". Lloji i caktuar për një resurs apo komponenti i tij është i bazuar në minimumin e kapacitetit të tij të përshkruar sipas masës (ve) të përcaktuara për atë resurs.

KOMPONENTI IV:

KOMANDA DHE MENAXHMENTI

Komponentët e SIME-së të shtjelluara më heret (gatishmëria, komunikimi dhe informimi si dhe menaxhimi i resurseve), sigurojnë kornizë për të mundësuar autoritet të qartë të reagimit, sigurimit të resurseve dhe menaxhim efektiv gjatë reagimit në incident. Sistemi i Komandës së Incidentit (SKI), Sistemi i Koordinimit Ndërinstitucional (SKNI) dhe Informimi Publik janë elementet themelore të menaxhimit të incidentit. Këto elemente afrojnë standardizim përmes terminologjisë së qëndrueshme dhe strukturave të caktuara organizative. Menaxhimi emergjent dhe reagimi në incident i referohet spektrit të gjerë të aktiviteteve dhe organizimeve që afrojnë operacione, koordinim dhe mbështetje efektive dhe efikase. Menaxhimi i incidentit, sipas destinacionit, përfshinë drejtimin e operacioneve specifike të incidentit, përvetësimin, koordinimin dhe shpërndarjen e resurseve në vendet e incidentit, si dhe shkëmbimin e informacioneve të incidentit me publikun. Duke marrë së bashku këto elemente të komandës dhe menaxhmenti, theksojmë se janë aspektet më të dukshme të menaxhimit të incidentit, në mënyrë tipike të zbatuara me sensin e urgjencës. Ky komponent përshkruan sistemet e përdorura për mbështetjen e operacioneve të komandës dhe menaxhmentit.

A. SISTEMI I KOMANDËS SË INCIDENTIT

Shumica e incidenteve menaxhohen në nivelin lokal dhe në mënyrë tipike ballafaqohen nga qendrat lokale dispeqerike/komunikimit dhe personeli i menaxhimit/reagimit emergjent, brenda juridiksionit të vetëm. Shumica e nevojave reaguese nuk shkojnë më tutje. Në rrethanat tjera, incidentet që fillojnë me reagim me vete, brenda juridiksionit të vetëm, me shpejtësi zgjerohen në nivele shumë-disiplinore, shumë-juridiksionale, duke kërkuar resurse të konsiderueshme plotësuese dhe mbështetje të gjerë operacionale. SKI afron mekanizëm kryesor fleksibil, për menaxhim të koordinuar dhe bashkëpunues të incidentit, qoftë për incidentet që kërkojnë resurse plotësuese apo që janë siguruar nga organizatat e ndryshme, brenda një juridiksioni të vetëm apo jashtë tij, ose për incidente komplekse

me implikime kombëtare (shpërthimi i një sëmundje infektive apo sulmi bioterrorist). Kur një incident i vetëm mbulon hapësirë të gjerë gjeografike, mund të jenë të nevojshme shumë agjenci lokale të menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident. "Agjencitë" reaguese janë të përcaktuara si agjenci qeveritare, megjithëse në raste të caktuara mund të përfshihen organizatat joqeveritare (OJQ-të), dhe organizatat e sektorit privat. Koordinimi efektiv ndër-juridiksional duke përdorur procese dhe sisteme është apsolutisht kritik në këtë situatë.

SKI është sistem menaxhues i përdorur gjerësisht i dizajnuar për të mundësuar menaxhim efektiv, efikas të incidentit duke integruar kombinimin e shërbimeve, pajisjeve, personelit, procedurave dhe komunikimet që operojnë brenda strukturës së përbashkët organizative. SKI është formë themelore e menaxhmentit e krijuar në model standard, me qëllimin e mundësisimit të menaxherëve të incidentit, që të identifikojnë çështjet kryesore të lidhura për incidentin (në të shumten e rasteve nën rrethana urgjente) pa sakrifikuar vëmendjen e cilës do komponentë të sistemit të komandës.

SKI përdoret për organizimin e operaconeve në vendngjarje për spektrin e gjerë të emergjencave nga incidentet e vogla deri tek ato komplekse, te dyja natyrore dhe të shkaktuara nga faktori njeri. Niveli reagues fushor, është vendi ku personeli i menaxhimit/reagimit emergjent, nën komandën e autoritetit përkatës, zbaton vendime taktike në reagim të drejtpërdrejtë ndaj një incidenti apo kërcënimi të caktuar. Resurset nga nivelet qendrore, regjionale dhe lokale, kur dislokohen si duhet, bëhen pjesë e SKI-së fushor.

Si sistem, SKI është jashtëzakonisht i dobishëm, jo vetëm pse afron strukturë organizative për menaxhimin e incidentit, por gjithashtu drejton procesin për planifikimin, ndërtimin dhe përshtatjen e kësaj strukture. Përdorimi i SKI-së për çdo incident apo ngjarje të planifikuar ndihmon ngritjen dhe mbajtjen e shkathtësive të nevojshme për incidentet në shkallë të gjerë.

SKI përdoret nga të gjitha nivelet e qeverisjes sikurse edhe nga shumë OJQ dhe sektori privat. SKI është gjithashtu i zbatueshëm edhe në disiplina të shumta. Normalisht është i strukturuar për t'i përkrah aktivitetet në pesë fushat e mëdha funksionale: komandë, operacione, planifikim, logjistik dhe financa/administratë. Inteligenca/hetimet, është fusha e gjashtë opsionale e cila aktivizohet mbi bazën rast - pas - rasti.

Aktet e terrorizmit biologjik, kimik, radiologjik dhe nuklear, mund të paraqesin sfida unike për strukturën tradicionale të SKI-së. Incidentet që nuk janë specifik për vendndodhje, janë gjeografikisht të shpërndarë apo evoluojnë me kalimin e kohës, do të kërkojnë koordinim të jashtëzakonshëm midis të gjithë pjesëmarrësve, përfshirë të gjitha nivelet e qeverisjes, si dhe OJQ-të dhe sektorin privat.

1. KARAKTERISTIKAT E MENAXHMENTIT

SKI është i bazuar në 14 karakteristika të dëshmuara, që secila prej tyre veç e veç kontribuon në forcën dhe efkasitetin e tërë sistemit.

a. Terminologjia unike

SKI vendos terminologji unike e cila i mundëson organizatave të ndryshme të menaxhimit dhe mbështetjes së incidentit të punojnë së bashku në morinë e gjerë të funksioneve të menaxhimit të incidentit dhe skenareve të ndryshme të rrezikshme. Kjo terminologji unike mbulon me sa vijon:

(1) *Funksionet organizative*

Funksionet kryesore dhe njësitë funksionale me përgjegjësi të menaxhimit të incidentit janë të emërtuara dhe përcaktuara. Terminologjia për elementet organizative është standarde dhe e përputhshme.

(2) *Përshkrimet e resurseve*

Resurseve kryesore (përfshirë personelin, shërbimet, pajisjet kryesore dhe artikujt furnizues) që mbështesin aktivitetet e menaxhimit të incidentit u jepen emra unik dhe janë të “klasifikuar” sipas kapacitetit të tyre, për ta ndihmuar evitimin e konfuzionit dhe për ta shtuar bashkëveprimin.

(3) *Hapësirat përcjellëse të incidentit*

Terminologjia unike është përdorur për përcaktimin e hapësirave përcjellëse në afërsi të zonës së incidentit të cilat do të përdoren gjatë kursit të zhvillimit të një incidenti.

b. Organizimi i përshtatshëm

Struktura organizative e SKI-së zhvillohet sipas mënyrës së përshtatshmërisë në raport me madhësinë dhe kompleksitetin e incidentit, si dhe në raport me specifikat e mjedisit të rrezikut të krijuar nga incidenti. Kur nevojitet, mund të themelohen elemente të ndara funksionale, secila prej të cilave mund të nën-ndahet më tutje për ta rritur organizimin menaxhial të brendshëm dhe koordinimin e jashtëm. Përgjegjësia përfundimtare për themelimin dhe zgjerimin e SKI-së i mbetet komandës së incidentit, e cila organizimin e SKI-së e bazon në kërkesat e situatës. Me shtimin e kompleksitetit të incidentit, organizimi zgjerohet nga lartë poshtë, sipas delegimit të përgjegjësive funksionale. Në harmoni me zgjerimin strukturor, zgjerohet edhe numri i pozitave menaxheriale dhe mbikëqyrëse, për të bërë adresimin e kërkesave të incidentit në mënyrë adekuate.

c. Manaxhimi sipas objektivave

Manaxhimi sipas objektivave komunikohet përgjatë tërë strukturës së SKI-së dhe përfshinë:

- Vendosjen e objektivave për incidentin.
- Ndërtimin e strategjive bazuar në objektivat e incidentit.
- Hartimin, vendosjen dhe lëshimin e detyrave të caktuara, planeve, procedurave dhe protokolleve.
- Vendosjen e taktikave apo detyrave specifike të matshme për aktivitetet e ndryshme funksionale të menaxhimit të incidentit dhe drejtimin e përpjekjeve për përmbushjen e tyre, në mbështetje të strategjive të përcaktuara.
- Dokumentimin e rezultateve për të matur performancën dhe për t'i mundësuar veprimet korigjuese.

d. Planifikimi i veprimeve në incident

Planifikimi i përqendruar dhe i koordinuar i veprimeve në incident, duhet t'i drejtoj të gjitha aktivitetet reaguese. Një Plan Veprimi në Incident (PVI) afron mjete koncize, koherente të kapjes dhe komunikimit të prioriteteve, objektivave, strategjive dhe taktikave të përgjithshme të incidentit, në kontekst të aktiviteteve operative dhe atyre mbështetëse.

Secili incident duhet të ketë një plan veprimi. Megjithëse, jo të gjitha incidentet kërkojnë plan të shkruar. Nevoja për plane të shkruara dhe shtojca bazohet në kërkesat e incidentit dhe vendimin e Komandantit të Incidentit (KI), apo Komandës së Bashkuar (KB). Shumica e operacioneve fillestare reaguese nuk pushtohen me PVI formal. Megjithatë, nëse një incident ka gjasa të zgjerohet përtej një periudhe operative, bëhet më kompleks apo involvon shumë juridiksione apo agjenci, përgatitja e PVI-së së shkruar do të bëhet jashtëzakonisht e rëndësishme për të mirëbajtur operacione efektive, efikase dhe të sigurta.

e. Hark kontrolli i menaxhueshëm

Harku i kontrollit është çelës i menaxhimit efektiv dhe efikas të incidentit. Mbikëqyrësit duhet të jenë në gjendje t'i mbikëqyrin dhe kontrollojnë në mënyrë adekuate vartësit e tyre, si dhe të komunikojnë me ta dhe t'i menaxhojnë të gjitha resurset nën mbikëqyrjen e tyre. Lloji i incidentit, natyra e detyrës, rreziku dhe faktorët e sigurisë si dhe distancat midis personelit dhe resurseve të gjitha ndikojnë në çështjet e harkut të kontrollit.

f. Objektet përcjellëse të incidentit

Lloje të ndryshme të objekteve mbështetëse operationale vendosen në afërsi të një incidenti, varësisht nga madhësia dhe kompleksiteti i tij, për përmbushjen e një mori qëllimesh. KI do të drejtoj përcaktimin dhe vendvendosjen e objekteve bazuar në kërkesat e situatës. Në mënyrë tipike në objektet e përcaktuara përfshihen post komandat e incidentit, kampet, pikat e grumbullimit të trupave, hapësirat për trajtimin e të lënduarve në masë, pikat e shpërndarjes dhe të tjera sipas nevojës.

g. Menaxhimi gjithëpërfshirës i resurseve

Mbajtja e një pasqyre aktuale dhe të plotë të shfrytëzimit të resurseve është komponentë kritike e menaxhimit të incidentit dhe reagimit në incident. Në resurset për tu identifikuar në këtë mënyrë përfshihen personeli, ekipet, pajisjet, furnizimet, shërbimet dhe objektet përcjellëse në dispozicion apo të mundshme për ngarkim me detyrë apo për ndarje. Menaxhimi i resurseve është përshkruar në hollësi në komponentën III.

h. Komunikimi i integruar

Komunikimi në incident mundësohet përmes hartimit dhe përdorimit të planeve unike të komunikimit, proceseve dhe arkitetkurës ndërvepruese të komunikimit. Kjo qasje e integruar ndërlidh njësitë operative dhe mbështetëse të agjencive të ndryshme të përfshira dhe është e domosdoshme të mirëmbahet ndërlidhja komunikuese dhe disiplina, si dhe për të mundësuar njohje të përbashkët të situatës dhe ndërveprimit. Planifikimi i gatishmërisë duhet të adresojë pajisjet, sistemet dhe protokollat e nevojshme për arritjen e komunikimit të integruar zanor (verbal) dhe të shkruar.

i. Ngritja dhe transferi i komandës

Funksioni i komandës duhet të ngritet qartazi nga fillimi i operacioneve të incidentit. Agjencia me autoritetin parësor për incidentin, cakton personin përgjegjës për ngritjen e komandës në vendngjarje. Me rastin e transferit të komandës, procesi duhet të përfshijë brifingun (udhëzimet -të gjitha informacionet esenciale) për vazhdimin e operacioneve të sigurta dhe efektive.

j. Zinxhiri i komandës dhe uniteti i komandës

Zinxhiri i komandës i referohet linjës së rregullt të autoritetit brenda rangjeve të organizimit të menaxhimit të incidentit. Uniteti i komandës nënkupton që të gjithë individët kanë mbikëqyrësin e caktuar, tek i cili ata raportojnë në vendin e ngjarjes së incidentit. Këto parime qartësojnë marrëdhëniet raportuese dhe eliminojnë hutinë e shkaktuar nga direktivat e shumëfishta kontradiktore. Menaxherët e incidentit në të gjitha nivelet duhet të jenë në gjendje të drejtojnë veprimet e tërë personelit nën mbikëqyrjen e tyre.

k. Komanda e bashkuar

Në incidentet që përfshijnë juridiksione të shumëfishta, juridiksion të vetëm me përfshirje të agjencive të shumëfishta apo juridiksione të shumëfishta me përfshirje të agjencive të shumëfishta, komanda e bashkuar iu mundëson agjencive me nivel të ndryshëm të autoritetit dhe përgjegjësisë ligjore, gjeografike apo funksionale, të punojnë së bashku në mënyrë më efektive, pa prekur autoritetin, përgjegjësinë apo përgjegjshmërinë individuale të agjencive.

1. Përgjegjshmëria

Përgjegjshmëria efektive e resurseve në të gjitha nivelet juridiksionale dhe brenda fushave funksionale individuale gjatë operacioneve të incidentit është esenciale. Në funksion të kësaj, kontrolli në hyrje/dalje, planifikimi i veprimeve në incident, bashkimi i komandës, përgjegjësia personale, harku i kontrollit dhe përcjellja e resurseve janë parime të përgjegjshmërisë, të cilat duhet të përkrahen.

m. Dërgimi/Dislokimi

Resurset duhet të reagojnë vetëm kur të kërkohen apo dërgohen nga një autoritet përkatës, përmes sistemit të vendosur të menaxhimit të resurseve. Resurset jo të kërkuar duhet të përmbahen nga dislokimi spontan për ta shmang mbingarkimin e pranuesit dhe kanaleve të ndërlikuara të llogaridhënies.

n. Menaxhimi i informacioneve të zakonshme dhe inteligjente

Struktura e menaxhimit të incidentit duhet të vendos proces për grumbullimin, analizimin, vlerësimin, shkëmbimin dhe menaxhimin e informacioneve dhe inteligjencës lidhur me incidentin.

2. KOMANDA E INCIDENTIT DHE PERSONLEI I KOMANDËS

Komanda e incidentit është përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm të incidentit. Menaxhimi i përgjithshëm përfshinë caktimin e personelit të komandës të nevojshëm për zbatimin e funksioneve të komandës. Personlei i komandës dhe personeli i përgjithshëm zakonisht janë të vendosur në Post Komandën e Incidentit (PKI).

a. Komanda e incidentit

Funksioni i komandës mund të zhvillohet në një apo dy mënyra të përgjithshme:

- Komand më vete i incidenti dhe
- Komanda e bashkuar

(1) Komand më vete i incidentit

Kur një incident ndodh brenda juridiksionit të vetëm dhe nuk ekziston mbishtresim i agjencive juridiksionale apo funksionale, duhet të caktohet një KI më vete, me përgjegjësini e përgjithshme të menaxhimit nga autoriteti përkatës juridiksional (në disa raste kur menaxhimi i incidentit kalon kufijtë juridiksional apo funksional të agjencisë, KI më vete mund të caktohet nëse bëhet me pajtim).

KI i caktuar/emëruar do t'i vendos objektivat e incidentit në të cilat do të bazohet planifikimi i veprimeve pasuese në incident. KI do të miratoj PVI-në dhe të gjitha kërkesat e lidhura me angazhimin dhe lirimimin e resurseve të incidentit.

(2) Komanda e bashkuar

Komanda e Bashkuar është një element i rëndësishëm në menaxhimin ndër-juridiskional dhe ndër-institucional të incidentit. Ajo ofron udhëzime për t'ju mundësuar agjencive me përgjegjësi të ndryshme ligjore, gjeografike dhe funksionale për të koordinuar, planifikuar dhe ndërvepruar në mënyrë efektive. Si përpjekje ekipore, KB i lejon të gjitha agjencive me autoritet juridiksional apo përgjegjësi funksionale për incidentin, për të siguruar së bashku drejtim menaxherial përmes vendosjes së objektivave dhe strategjive të përbashkëta dhe një PVI të vetëm. Secila agjenci pjesëmarrëse mban autoritetin, përgjegjësinë dhe llogaridhënien e saj.

KB funksionon si një strukturë më vete e integruar e menaxhimit, e cila përfshinë:

- Komandën e bashkëvendosur në PKI.
- Një Shef të Sektorit të Operacioneve për t'i drejtuar përpjekjet taktike.
- Procesin e koordinuar për porositjen/angazhimin e resurseve.
- Funksionet e përbashkëta të planifikimit, logjistikës dhe financës/administratës, kurdo që të jetë e mundur.
- Miratimin e koordinuar të informacioneve për publikim.

Të gjitha agjencitë e përfaqësuara në strukturën e KB kontribuojnë në procesin e:

- Përzgjedhjes së objektivave;
- Përcaktimit të strategjive të përgjithshme;
- Të siguruarit që planifikimi i përbashkët i aktiviteteve taktike është duke u kryer në përputhje me objektivat e miratuara;
- Sigurimit të integritetit të operacioneve taktike;
- Aprovimit, angazhimit dhe përdorimit maksimal të resurseve të ndara për incident;

Përbërja e saktë e strukturës së KB do të varet nga vendndodhja(et) e incidentit (cilat juridiksione apo organizata janë të përfshira) dhe lloji i incidentit (cilat agjenci funksionale të juridiksionit(ve) apo organizatës(ve) janë të nevojshme). Caktimi i një KI më vete për disa incidente shumë juridiksionale (nëse planifikohet paraprakisht), mund të merret parasysh me qëllim të promovimit të unifikimit më të madh të përpjekjes dhe efikasitetit.

Zyrtarët e agjencive të caktuara që marrin pjesë në KB, përfaqësojnë autoritete ligjore të ndryshme dhe përgjegjësi të fushave të ndryshme funksionale dhe përdorin proces bashkëpunues për vendosjen, përcaktimin dhe renditjen e proriteteve për incidentin dhe për përcaktimin e objektivave të përshtatshme me prioritetet e caktuara. Agjencitë që janë të përfshira në incident por me më pak autoritet apo përgjegjësi juridiksionale, përcaktohen si agjenci mbështetëse apo si agjenci ndihmëse. Ato janë të përfaqësuara në strukturën e komandës dhe ndikojnë në koordinim në emër të agjencive të tyre përkatëse si dhe veprojnë si zyrtar ndërlidhës. Përgjegjësitë

juridiksionale të zyrtarëve të shumëfishtë të menaxhmentit të incidentit janë të konsoliduar në procesin e vetëm të planifikimit i cili përfshinë:

- Përgjegjësitë për menaxhimin e incidentit;
- Objektivat e incidentit;
- Disponueshmërinë dhe kapacitetet e resurseve;
- Kufizimet;
- Fushat e pajtimit dhe mospajtimit midis zyrtarëve të agjencive;

Incidentet menaxhohen sipas një qasjeje të vetme bashkëpunuese e cila përfshinë:

- Strukturë organizative unike;
- Postë komandë të vetme të incidentit;
- Proces të unifikuar të planifikimit;
- Menaxhim të unifikuar të resurseve;

Nën KB, PVI punohet nga Sektori i Planifikimit dhe aprovohet nga KB. Personi i vetëm (Shefi i Sektorit Operativ) drejton zbatimin taktik të PVI-së. Shefi i Sektorit Operativ zakonisht do të vie nga organizata me përfshirje më të madhe juridiksionale. Pjesëmarrësit e KB-së do të pajtohen në caktimin e Shefit të Sektorit Operativ.

KB funksionon më së miri kur anëtarët pjesëmarrës të saj bashkëvendosen në PKI dhe zbatojnë praktikën në vijim:

- Zgjedhin nga një Shef të Sektorit Operativ për çdo periudhë operative;
- Mbajnë të informuar njëri tjetrin lidhur me kërkesat specifike;
- Vendosin objektiva, prioritete dhe strategji të konsoliduara të incidentit;
- Vendosin sistem të vetëm për renditjen/angazhimin e resurseve;
- Hartojnë PVI të konsoliduar të shkruar apo verbal për tu vlerësuar dhe plotësuar në intervale të rregullta;
- Vendosin procedura për vendimmarrje dhe dokumentim të përbashkët;

b. Personeli i komandës

Në një strukturë të komandës së incidentit, personeli i komandës në mënyrë tipike përfshinë zyrtarin për informimin publik, zyrtarin për siguri dhe zyrtarin për ndërlidhje, të cilët raportojnë drejtpërsëdrejti tek KI/KB dhe sipas nevojës mund të kenë asistent (shih figurën 4). Mund të jenë nevojshme edhe pozita shtesë, varësisht nga natyra, shtrirja, kompleksiteti dhe lokacioni (et) e incidentit (eve), apo sipas kërkesave specifike të caktuara nga KI/KB.

(1) Zyrtari për Informim Publik

Zyrtari për Informim Publik (ZIP), është përgjegjës për ballafaqim me publikun dhe mediat dhe me agjencitë tjera me kërkesa për informacione të lidhura me incidentin.

ZIP grumbullon, verifikon, koordinon dhe shpërndan informacione aktuale, të pranueshme dhe me kohë mbi shkakun, madhësinë dhe gjendjen aktuale, dhe çështjet tjera të interesit të përgjithshëm për të dyja audiencat, të brendshme dhe të jashtme. ZIP gjithashtu mund të zbatoj edhe rol kyç në monitorimin e informimit publik. Pavarësisht nëse struktura e komandës është më vete apo e bashkuar, për çdo incident duhet të caktohet vetëm një ZIP. Asistentët mund të caktohen nga agjencitë, dikasteret apo organizatat tjera të përfshira. KI/KB duhet ta aprovoj lëshimin e çdo informacioni të lidhur me incidentin. Në incidentet e shkallës së gjerë apo kur janë të ngritura postë komanda të shumëfishta, ZIP duhet të marrë pjesë në, apo të udhëheq Qendrën për Informim të Përbashkët (QIP), me qëllim të sigurimit të lidhjes logjike në pajisjen e publikut me informacione.

(2) Zyrtari për Siguri

Zyrtari për Siguri i përcjell operacionet e incidentit dhe e këshillon KI/KB rreth të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë e operacioneve, përfshirë shëndetin dhe sigurinë e personelit të reagimit emergjent. Përgjegjësia përfundimtare për zhvillim të sigurtë të operacioneve për menaxhimin e incidentit i mbetet KI/KB dhe mbikëqyrësve në të gjitha nivelet e menaxhimit të incidentit. Anasjelltas zyrtari për siguri është përgjegjës para KI/KB për sistemet dhe procedurat e nevojshme për sigurimin e vlerësimit të vazhdueshëm të mjediseve të rrezikshme, përfshirë planin e sigurisë, koordinimin e përpjekjeve për siguri të agjencive të shumëfishta dhe zbatimin e masave për përkrahjen e sigurisë për reaguesit emergjent si dhe sigurisë së përgjithshme të operacioneve të incidentit.

Zyrtari për Siguri ka autoritetin e menjëhershëm për ndalimin apo parandalimin e akteve të pasigurta gjatë operacioneve të incidentit. Është e rëndësishme të theksohet që agjencitë, organizatat apo juridiksionet që kontribuojnë në përpjekjet e përbashkëta të menaxhimit të sigurisë, nuk humbin identitetin e tyre individual apo përgjegjësinë për programet, politikat dhe personelin e tyre. Përkundrazi, secili kontribuon në përpjekjen e përgjithshme për mbrojtjen e gjithë personelit reagues të përfshirë në operacionet e incidentit.


(3) Zyrtari për Ndërlidhje

Zyrtari për Ndërlidhje është pikë kontakti i komandës së incidentit për përfaqësuesit e agjencive tjera qeveritare, OJQ-ve dhe sektorit privat (pa autoritet juridiksional apo legal), për të siguruar qasje në politikat e agjencive të tyre, disponueshmërinë e resurseve dhe çështjet tjera të lidhura për incidentin. Qoftë nën strukturën e KI-së më vete apo të KB-së, përfaqësuesit e agjencive dhe organizatave ndihmëse apo bashkëpunuese, koordinojnë nëpërmjet zyrtarit për ndërlidhje. Përfaqësuesit e agjencive apo strukturës së caktuar për një incident duhet të kenë autoritetin e të folurit në emër të agjencive apo organizatave të tyre përkatëse, për të gjitha çështjet, në vijim të konsultimeve të nevojshme me udhëheqësinë e tyre. Asistentë dhe personel nga agjencitë apo organizatat tjera (publike apo private) të përfshirë në aktivitetet e menaxhimit të incidentit mund të caktohen tek zyrtari për ndërlidhje për lehtësimin e koordinimit.

(4) Personeli plotësues i Komandës

Varësisht nga natyra dhe vendndodhja e incidentit apo nga kërkesat specifike të caktuara nga komanda e incidentit, mund të jenë të nevojshme edhe pozita plotësuese të personelit të komandës. Për shembull, këshilltari për çështje ligjore mund të caktohet në Sektorin e Planifikimit, si specialist teknik apo drejtpësdrejt në Personelin e Komandës për ta këshilluar komandën e incidentit, lidhur me çështjet ligjore, siç janë: shpalljet emergjente, ligjshmëria e urdhrave për evakuim dhe karantinë dhe të drejtat ligjore dhe kufizimet që kanë të bëjnë me lirinë e qasjes së mediave. Ngjashëm, këshilltari mjekësor mund të caktohet për të ofruar këshilla dhe rekomandime lidhur me shërbimet mjekësore dhe të shëndetit mendor, lëndimet në masë, kujdesin akut, kontrollin e mjeteve biologjike, epidemiologjitë apo çështjet e parandalimit masiv, posaçërisht në reagim ndaj incidentit bio-terrorist. Për më tepër, mund të caktohet këshilltari për nevoja speciale për të afruar ekspertizë lidhur me shërbimet e komunikimit, transportit, mbikëqyrjes dhe shërbimet esenciale për popullatat e ndryshme në zonën e goditur.

Figura 4. Sistemi i Komandës së Incidentit: Personeli i Komandës dhe Personeli i Përgjithshëm



Struktura e komandës dhe menaxhmentit është e vendosur në PKI. Komanda e incidentit drejton operacionet nga PKI, e cila kryesisht vendoset në vendndodhjen e incidentit apo afër tij. Në mënyrë tipike, për çdo incident ngritet një PKI. Duke qenë

se personeli i menaxhimit/reagimit emergjent pozicionohen, ata duhet (pavarësisht përkatësisë së agjencisë) të raportojnë dhe kontrollohen në hyrje të pikës së grumbullimit të trupave, bazës, kampit apo lokacionit të caktuar dhe të njoftojnë KI/KB për ta marrë detyrën në pajtim me procedurat e vendosura nga KI/KB.

3. PERSONELI I PËRGJITHSHËM


Personeli i përgjithshëm është përgjegjës për aspektet funksionale të strukturës së komandës së incidentit. Personeli i përgjithshëm në mënyrë tipike përbëhet prej shefave të sektorëve të operacioneve, planifikimit, logjistikës dhe financave/administratës. Shefat e sektorëve mund të kenë të caktuar një apo më shumë zëvendës, të caktuar nga agjencitë tjera në rastet e incidenteve shumë juridiksionale.

a. Sektori Operativ

Ky sektor është përgjegjës për të gjitha aktivitetet taktike të përqendruara në zvogëlimin e rrezikut imediat, shpëtimin e jetëve dhe të mirave materiale, vendosjen e kontrollit mbi situatën dhe rivendosjen e operacioneve të zakonshme. Siguria e shpëtimtarëve dhe reaguesve do të jetë gjithmonë prioriteti më i lartë dhe objektivi i parë në PVI.

Figura 5 përshkruan strukturën organizative të sektorit operativ. Zgjerimi i kësaj strukture themelore mund të ndryshoj në raport me një numër çështjesh dhe faktorësh operativ. Në disa raste, mund të përdoret qasja strikte funksionale. Në raste tjera, struktura organizative do të përcaktohet nëpërmjet kufijve gjeografik/juridiksional. Në shumë të tjera, mund të jetë i përshtatshëm kombinimi i çështjeve funksionale dhe gjeografike. SKI afron fleksibilitet në përcaktimin e qasjes së drejtë strukturore për rrethanat specifike të incidentit të dhënë.

Figura 5. Elementet kryesore organizative të Sektorit Operativ



(1) Shefi i Sektorit Operativ

Shefi i Sektorit Operativ është përgjegjës para komandës së incidentit për menaxhim të drejtpërdrejtë të të gjitha aktiviteteve taktike të lidhura me incidentin. Shefi i Sektorit Operativ do t'i caktoj taktikat për periudhën e caktuar operative. Për çdo periudhë operative duhet të caktohet një Shef i Sektorit Operativ dhe përgjegjësitë e tij ngërthejnë në vete përfshirjen e drejtpërdrejtë në hartimin e PVI-së.

(2) Degët

Degët mund të jenë funksionale, gjeografike apo te dyja, varësisht nga rrethanat e incidentit. Kryesisht, degët ngriten kur numri i divizioneve apo grupeve tejkalon harkun e rekomanduar të kontrollit. Degët identifikohen me anë të përdorimit të numrave romak apo fushave funksionale.

(3) Divizionet apo grupet

Divizionet dhe/apo grupet ngriten kur numri i resurseve tejkalon harkun e menaxhueshëm të kontrollit të Komandës së Incidentit dhe Shefit të Sektorit Operativ. Divizionet ngriten për ta ndarë incidentin në fusha fizike apo gjeografike të operacionit. Grupet ngriten për ta ndarë incidentin në fusha funksionale të operacionit. Për lloje të caktuara të incidenteve, komanda e incidentit përgjegjësinë e evakuimit apo kujdesit masiv mund t'ia caktoj grupit funksional të sektorit operativ. Nivele shtesë mund të ekzistojnë nën nivelin e divizionit apo grupit.

(4) Resurset

Resurset mund të organizohen dhe menaxhohen në tri mënyra të ndryshme, varësisht nga kërkesat e incidentit.

- **Si resurse më vete:** Personel apo pajisje individuale dhe çdo operator shoqërues.
- **Si task forcë:** Çdo kombinim i resurseve të mbledhura në mbështetje të misionit specifik apo nevojës operacionale. Të gjitha elementet e resurseve brenda Task Forcës duhet të kenë mjete unike të komunikimit dhe udhëheqës të caktuar.
- **Si ekip sulmues:** Numër i caktuar i resurseve të të njëjtës natyrë dhe lloj të cilët kanë të caktuar një numër minimal të personelit. Të gjitha elementet e resursit brenda ekipit sulmues duhet të kenë mjete unike të komunikimit dhe udhëheqës të caktuar.

Kur është e nevojshme, përdorimi i Task Forcave dhe Ekipeve Sulmuese inkurajohet, për ta optimalizuar shfrytëzimin e resurseve, zvogëluar harkun e kontrollit dhe për ta zvogëluar kompleksitetin e koordinimit dhe komunikimit të menaxhmentit të incidentit.

b. Sektori i planifikimit

Sektori i planifikimit grumbullon, vlerëson dhe shpërndan informacionet e zakonshme dhe inteligjente lidhur me gjendjen e incidentit tek KI/KB, dhe personeli i menaxhimit të incidentit. Ky sektor pastaj përgatit raporte të gjendjes, pasqyron informacionet mbi situatën, mban gjendjen e resurseve të caktuara për incident si dhe përgatit dhe dokumenton PVI-në, bazuar në të hyrat e Sektorit Operativ dhe udhëzimeve të KI/KB-së.

Siç paqyrohet në figurën 6, sektori i planifikimit është i përbërë prej katër njësive parësore, si dhe numrit të specialistëve teknik për të asistuar në vlerësimin e situatës, hartimin e planeve opsionale dhe parashikimin e kërkesave për resurse shtesë. Brenda sektorit të planifikimit, njësitë parësore i plotësojnë kërkesat funksionale në vijim:

- **Njësia e resurseve:** Përgjegjëse për regjistrimin e gjendjes së resurseve të zotuarra për incident. Kjo njësi gjithashtu vlerëson resurset e angazhuara aktualisht në incident, efektin që do ta kenë resurset plotësuese në incident dhe nevojat e parashikuara për resurse.
- **Njësia e situatës/gjendjes:** Përgjegjëse për grumbullimin, organizimin dhe analizimin e informacioneve për gjendjen e incidentit dhe analizimin e situatës në zhvillim.
- **Njësia e demobilizimit:** Përgjegjëse për të siguruar demobilizim të rregullt, të sigurt dhe efikas të resurseve të incidentit.
- **Njësia e dokumentimit:** Përgjegjëse për grumbullimin, regjistrimin dhe ruajtjen e të gjitha dokumenteve relevante për incidentin.
- **Specialisti(ët) teknik:** Personel me shkathësi të veçantë i cili mund të përdoret kudo në strukturën e SKI-së.

Figura 6. Struktura e Sektorit të Planifikimit



Sektori i planifikimit normalisht është përgjegjës për grumbullimin dhe shpërndarjen e informacioneve dhe inteligjencës kritike për incident, përveç nëse KI/KB e vendos këtë funksion diku tjetër. Sektori i planifikimit, gjithashtu është përgjegjës për përpunimin e PVI-së. PVI përfshinë objektivat dhe strategjitë e përgjithshme të incidentit të caktuara nga komanda e incidentit. Në rastin e KB-së, PVI duhet t'i adresoj në mënyrë adekuate nevojat misionare dhe politike të secilës agjenci juridiksionale, si dhe ndërveprimin midis juridiksioneve, agjencive funksionale dhe organizatave të sektorit privat. PVI, gjithashtu adreson taktikat dhe aktivitetet mbështetëse të nevojshme për periudhën e planifikuar operative, kryesisht 12 deri në 24 orë.

PVI duhet t'i përfshijë ndryshimet në strategji dhe taktika, bazuar në "mësimet e mësuara" gjatë periudhave të mëhershme operative. PVI i shkruar është i rëndësishëm posaçërisht kur:

- Resurset e shumë agjencive dhe/apo shumë juridiksioneve janë të përfshira;
- Incidenti do t'i kaloj disa periudha operative;
- Ndërrimi i personelit dhe/apo pajisjeve në turne është i nevojshëm dhe
- Ekziston nevoja e dokumentimit të veprimeve dhe vendimeve.

PVI në mënyrë tipike do të përmbaj në vete një numër të komponentëve të pasqyruar në tabelën 5.

Tabela 5. Mostër e konturës së PVI-së

Komponenta :	Përgatitet nga :
Objektivat e incidentit	Komandanti i incidentit
Skema organizative	Njësia e resurseve
Lista e caktimit të detyrave	Njësia e resurseve
Plani radiokomunikimit në incident	Njësia e komunikimit
Plani mjekësor	Njësia mjekësore
Hartat e incidentit	Njësia e situatës
Plani i sigurisë/Mesazhi i përgjithshëm i sigurisë	Zyrtari për siguri
Komponente tjera të mundshme (të varura nga incidenti)	
Përmbledhja e operacioneve ajrore	Operacionet ajrore
Plani i qarkullimit/trafikut	Njësia e mbështetjes tokësore
Plani i dekontaminimit	Specialisti teknik
Plani i hudhjes së mbeturinave/Rrënojave	Specialisti teknik
Plani i demobilizimit	Njësia e demobilizimit

Plani i sigurisë së vendndodhjes	Zbatimi i ligjit, specialisti teknik apo menaxheri i sigurisë
Plani i hetimeve	Zbatimi i ligjit
Plani i ruajtjes së provave	Zbatimi i ligjit
Plani i evakuimit	Sipas nevojës
Plani i strehimit/Kujdesit masiv	Sipas nevojës
Tjetër (sipas nevojës)	Sipas nevojës


c. Sektori i Logjistikës

Sektori i Logjistikës (Shih figurën 7), është përgjegjës për të gjitha nevojat e shërbimeve mbështetëse të nevojshme për mundësimin e menaxhimit efektiv dhe efikas të incidentit, përfshirë porositjen e resurseve nga vendet jashtë incidentit.

Ky sektor, gjithashtu afron shërbime, siguri (të hapësirave dhe personelit të komandës së incidentit) transport, artikuj furnizues, mirëmbajtje të pajisjeve dhe furnizim me karburante, shërbime të ushqimit, mbështetje të teknologjisë së komunikimit dhe informimit dhe shërbime mjekësore për reaguesit emergjent, përfshirë vaksinimin sipas nevojës. Brenda sektorit të logjistikës pesë njësi parësore përmbushin kërkesat funksionale:

- *Njësia e furnizimit:* Porosit, pranon, deponon dhe përpunon të gjitha resurset e lidhura për incidentin, personelin dhe artikujt furnizues.
- *Njësia e mbështetjes tokësore:* Siguron tërë transportin tokësor gjatë një incidenti. Në lidhje të ngushtë me sigurimin e transportit, njësia gjithashtu është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe furnizimin e automjeteve, mbajtjen e shënimeve për shfrytëzimin e tyre dhe hartimin e planeve të trafikut/qarkullimit.
- *Njësia e objekteve:* Vendos, mirëmban dhe çmonton të gjitha objektet e përdorura në mbështetje të operacioneve të incidentit. Njësia, gjithashtu afron shërbime të mirëmbajtjes dhe sigurisë të nevojshme për mbështetjen e operacioneve të incidentit.
- *Njësia e ushqimit:* Përcakton nevojat për ushqim dhe ujë, planifikon menytë, porosit ushqim, afron hapësira për zierje, zien, shërben, mirëmbanë hapësirat e shërbimeve të ushqimit dhe menaxhon çështjet e sigurisë së ushqimit.
- *Njësia e komunikimit:* Në përgjegjësitë kryesore përfshihen planifikimin e komunikimit efektiv si dhe përfitimin, vendosjen, mirëmbajtjen dhe llogaridhënien për pajisjet e komunikimit.
- *Njësia mjekësore:* Përgjegjëse për afrimin e shërbimeve efektive dhe efikase të mjekësisë për personelin e incidentit.

Figura 7. Struktura e Sektorit të Logjistikës




d. Sektori i Financave/Administratës

Sektori i Financave/Administratës ngritet kur aktivitetet e menaxhimit të incidentit kërkojnë shërbime të mbështetjes financiare dhe shërbime tjera administrative në vendngjarje, apo specifike për incidentin. Disa nga funksionet të cilat bëjnë brenda fushëveprimit të këtij sektori janë: regjistrimi i kohës së punës së personelit të angazhuar, mirëmbajtja e kontratave tregëtare, administrimi i këkesave dhe kompensimit dhe zhvillimi i një analize të kostos së incidentit.

Sektori i Financave/Administratës është pjesë kritike e SKI-së, në incidentet e gjëra komplekse që përfshijnë mjete financiare të konsiderueshme, që burojnë nga shërbimet e shumëfishta. Për më tepër, shefi i sektorit duhet t'i përcjell dhe raportoj tek komanda e incidentit kostot e ndodhura gjatë zhvillimit të incidentit. Kjo i mundëson KI/KB-së t'i parashikojë nevojat për fonde shtesë para se operacionet të goditen negativisht. Figura 8 ilustron strukturën themelore të Sektorit të Financave/Administratës. Kur sektori i këtillë ngritet, njësitë e pasqyruara në strukturë mund të plotësohen me personel sipas nevojës. Brenda Sektorit të Financave/Administratës, katër njësi parësore përmbushin kërkesat funksionale:

- *Njësia e kompensimeve/parashtrësive:* përgjegjëse për çështjet financiare që rezultojnë nga dëmtimi i të mirave materiale, lëndimeve apo fataliteteve në incident.
- *Njësia e kostos:* përgjegjëse për përcjelljen e kostove, analizimin e të dhënave për kostot, bërjen e llogarive dhe propozimin e masave për kursim.
- *Njësia e prokurimit:* Përgjegjëse për çështje financiare që kanë të bëjnë me kontratat tregëtare.
- *Njësia e kohës:* Përgjegjëse për regjistrimin e kohës së angazhimit për personelin e incidentit dhe pajisjet e marra.

Figura 8. Struktura e Sektorit të Financave/Administratës



e. Funkzioni Inteligent/Hetues

Grumbullimi, analizimi dhe shkëmbimi i informacioneve inteligjente të lidhura me incidentin, janë elemente të rëndësishme të SKI-së. Normalisht, informacionet operative dhe informacionet inteligjente për situatën janë funksione menaxhmenti të vendosura në Sektorin e Planifikimit, me përqendrim në tri fusha inteligjente të incidentit: gjendja e situatës, gjendja e resurseve dhe gjendja e pritshme e situatës apo eskalimi i mundshëm. Këto informacione dhe inteligjenca përdoren për vendimmarrjen e menaxhmentit të incidentit. Për më tepër, specialistët teknik në Sektorin e Planifikimit mund të përdoren për të afruar informacione specifike të cilat mbështesin vendimet taktike.

Strukturat e menaxhimit të incidentit, gjithashtu duhet të ngritin sistem për grumbullimin, analizimin dhe shkëmbimin e informacioneve të dala gjatë përpjekjeve inteligjente/hetimore të incidentit.

Disa incidente kërkojnë informacione inteligjente dhe hetimore, të cilat definojnë në një mënyrë nga dy mënyrat. Së pari, definohet si informacion i cili shpie në zbulim, parandalim, kuptim të shpejtë dhe persekutim të aktiviteteve kriminale apo personave të ngatërruar, përfshirë incidentet terroriste. Së dyti, definohet si informacion i cili shpie në përcaktimin e shkakut, parashikimin e shtrirjes, vlerësimin e efektit goditës apo përzgjedhjes së kundërmasave për incidentin e dhënë (pa marrë parasysh burimin), siç janë ngjarjet e shëndetit publik, shpërthimi sëmundjeve apo zjarreve me burim të panjohur.

SKI mundëson fleksibilitet organizativ, funksioni i inteligjencës/hetimeve, mund të vendoset në disa vende të ndryshme brenda strukturës organizative.

- **Brenda sektorit të planifikimit:** Kjo është vendosja tradicionale e këtij funksioni dhe është e përshtatshme për incidentet me pak apo fare nevoja

për infarmacione hetimore dhe as sasi të konsiderueshme të informacioneve të specializuara.

- ***Si Sektor i veçant i personelit të përgjithshëm:*** Ky opsion mund të jetë i përshtatshëm kur ekziston komponentë e konsiderueshme e inteligjencës/hetimeve në incident për qëllime kriminale apo epidemiologjike, apo kur janë të përfshira shumë agjenci hetimore. Sektori i veçantë i inteligjencës/hetimeve mund të jetë i nevojshëm kur informacionet tepër speciale kërkojnë analiza teknike ose janë kritike dhe senzitive në kohë për operacionet e shpëtimit (incidentet kimike, biologjike apo nukleare), apo kur ekziston nevoja për inteligjencë të klasifikuar.
- ***Brenda sektorit operativ:*** Ky opsion mund të jetë i përshtatshëm për incidentet që kërkojnë shkallë të lartë të ndërlidhjes dhe koordinimit midis informacioneve hetimore dhe taktikave operative të angazhuara.
- ***Brenda personelit të komandës:*** Ky opsion mund të jetë i përshtatshëm për incidente me pak nevojë për informacione taktike apo inteligjencë të klasifikuar dhe kur përfaqësuesit e agjencisë mbështetëse ofrojnë informacione të kohës reale për KI/KB.

Misioni i Funkcionit të Inteligjencës/Hetimeve është, të siguroj që të gjitha operacionet, funksionet dhe aktivitetet hetimore si dhe inteligjente brenda reagimit të incidentit të menaxhohen, koordinohen dhe drejtohen si duhet, në mënyrë që të:

- Parandalohen/ zbulohen aktivitetet, incidentet apo sulmet tjera;
- Grumbullohen, përpunohen, analizohen dhe shpërndahen si duhet informacionet inteligjente;
- Kryhen hetime të plota dhe gjithëpërfshirëse;
- Identifikohet, përpunohet, grumbullohet, krijohet zinxhiri i ruajtjes për mbrojtjen, ekzaminimin/ analizimin dhe deponimin e të gjitha provave dëshmuese;
- Përcaktohet burimi apo shakaku dhe kontrollonhet përhapja dhe efekti, në hetimin e incidenteve në rritje (zjarreve, shpërthimit të sëmundjeve, etj.);

Funksioni Inteligent/Hetues ka përgjegjësitë të cilat kryqëzojnë të gjitha interesat e dikasterëve të përfshirë gjatë një incidenti, megjithatë, funksionet e caktuara mbesin specifike për misionin e zbatuesve të ligjit. Dy shembuj të kësaj janë identifikimi dhe kapja e shpejt e të gjithë autorëve të krimit dhe persekutimi i suksesshëm i të gjithë të akuzuarëve.

Pavarësisht organizimit të Funkcionit të Inteligjencës/Hetimeve, do të mbahet lidhje e ngushtë dhe informacionet do të transmetohen në komandën e incidentit, sektorin operativ dhe sektorin e planifikimit. Megjithatë, informacionet e klasifikuara që kërkojnë skanim sigurie, informacione senzitive apo taktika specifike hetimore të cilat do të komplementonin hetimet, do të shkëmbehen vetëm me ata që kanë skanim adekuat të sigurisë apo nevojën për të ditur për to.

Funksioni i Inteligjencës/Hetimeve mund të organizohet në një mori mënyrash. Në vijim janë shembujt e grupeve të cilat mund të aktivizohen, nëse nevoiten:

- *Grupi i operacioneve hetimore:* përgjegjës për përpjekjen e përgjithshme hetimore.
- *Grupi inteligjent:* Përgjegjës për sigurimin e informacioneve inteligjente të pa klasifikuara të klasifikuara dhe të burimeve të hapura.
- *Grupi forenzik/mjeko-ligjor:* Përgjegjës për grumbullimin dhe integrimin e provave forenzike dhe në incidentet e natyrës kriminale, integritetin e vendit të krimit.
- *Grupi mbështetës hetimor:* Përgjegjës për të siguruar që personeli hetues i nevojshëm të vëhet në dispozicion me shpejtësi dhe se resurset e domosdoshme janë shpërndarë, mirëmbajtur, mbrojtur, deponuar dhe kthyer, kur është e nevojshme.

Mund të krijohen grupe tjera për tu marrë me përgjegjësitë në vijim: të siguruarit që personat e humbur apo të pa identifikur dhe mbetjet njerëzore, janë hetuar dhe identifikuar me shpejtësi dhe se njoftimet e nevojshme janë bërë me kohë.

4. EKIPET E MENAXHIMIT TË INCIDENTIT

Një Ekip i Menxhimit të Incidentit (këtu e tutje EMI), është një strukturë e komandës së incidentit e përbërë nga pjesëtarët e personelit të komandës dhe atij të përgjithshëm si dhe personelit tjetër përkatës në një strukturë të SKI-së, dhe mund të dislokohet apo aktivizohet sipas nevojës. EMI-të qendrore dhe disa lokale, do të kanë procedura operative formale të vendosura të certifikimit dhe kualifikimit, njoftimit, dislokimit dhe veprimit. Në raste tjera, EMI-të do të formohen në incidente apo ngjarje specifike. Niveli i trajnimit dhe ekspertizës së pjesëtarëve të EMI-ve, së bashku me përgjegjësitë dhe kërkesat formale të reagimit, janë faktor në përcaktimin e një lloji apo niveli të EMI-t.

5. KOMANDA REGJIONALE

a. Përshkrimi

Komanda Regjionale është një strukturë për mbikëqyrjen e menaxhimit të shumë incidenteve të përballura individualisht nga një strukturë e ndarë e SKI-së, apo për ta mbikëqyrë menaxhimin e incidentit shumë të madh apo evolues, që angazhon shumë EMI. Një kryeshef i Agjencisë apo zyrtar tjetër publik me përgjegjësi juridiksionale për incidentin, zakonisht merr vendimin për ngritjen e një komande regjionale. Një komandë regjionale aktivizohet vetëm nëse është e domosdoshme, varësisht nga kompleksiteti i incidentit dhe çështjeve të harkut të kontrollit të menaxhimit të incidentit.


Komandat regjionale janë posaqërisht të përshtatshme për incidentet të cilat në mënyrë tipike nuk janë specifike në aspektin e vendndodhjes, nuk janë menjëherë të

identifikueshme, gjeografikisht janë të shpërndarë dhe evoluojnë me kalimin e kohës (emergjencat e shëndetit publik, tërmetet, trazirat civile dhe çdo hapësirë gjeografike ku përdoren disa EMI dhe të gjitha këto incidente, kërkojnë resurse të ngjashme). Incidentet si këto, si dhe aktet terorizmit biologjik, kimik, radiologjik dhe nuklear, kërkojnë reagim ndërqeveritar, të OJQ-ve dhe sektorit privat, me koordinim të shkallës së gjerë, të kryer në mënyrë tipike në nivel më të lartë juridiksional. Komanda regjionale, gjithashtu përdoret kur: një numër i incidenteve të të njëjtit lloj, në të njëjtën hapësirë, konkurojnë për të njëjtat resurse, siç janë incidentet e shumta me materie të rrezikshme apo zjarret.

Kur incidentet janë të llojeve të ndryshme dhe nuk kanë të njëjtat kërkesa për resurse, ato zakonisht përballohen si incidente të ndara apo koordinohen përmes Qendrave Operative Emergjente (QOE) apo Grupit Koordinues Ndërinstitucional (Grupi KNI). Nëse incidentet nën autoritetin e komandës regjionale përfshijnë juridiksione të shumëfishta, duhet të ngritet komanda e bashkuar regjionale e veçantë (shih fig. 9). Kjo i mundëson secilit juridiksion të ketë përfaqësim të duhur në komandë.

Komanda regjionale nuk duhet të jetë e ndërlikuar me funksione të cilat kryhen nga SKNI. Komanda regjionale mbikëqyrë koordinimin e incidentit/eve, ndërsa elementet e SKNI (qendrat e komunikimit/dispeqerisë, QOE apo Grupi i KNI) koordinon mbështetjen.

Figura 9. Zinxhiri i komandës dhe relacionet e raportimit



Sqarim: Vija me pika që lidh QOE/Grupin KNI me Kryeshefat e Agjencive dhe Komandantin Regjional/Komandën e Bashkuar Regjionale, përfaqëson lidhjen e komunikimit dhe koordinimit midis QOE/Grupit KNI dhe Strukturës së Komandës.

b. Përgjegjësitë

Për incidentet nën autoritetin e saj, komanda regjionale ka përgjegjësitë në vijim:

- Vendosja e objektivave të përgjithshme për zonën/at e goditur;
- Koordinimi i vendosjes së objektivave dhe strategjive të secilit incident;
- (Ri) ndarja e resurseve me ndryshimin e prioriteteve të caktuara;
- Sigurimi që incidentet të menaxhohen si duhet;
- Sigurimi i komunikimit efektiv;
- Sigurimi që objektivat e incidentit janë përmbushur dhe nuk janë në kundërshtim me njeri tjetrin apo me politikat e agjencisë;
- Identifikimi i nevojave për resurse kritike dhe raportimi i tyre tek QOE/Grupet e ngritura të KNI-së;
- Sigurimi që rimëkëmbja afatshkurte “emergjente”, është koordinuar për të ndihmuar në kalimin në operacionet e rimëkëmbjes së plotë;

B. SISTEMET E KOORDINIMIT NDËR-INSTITUCIONAL

Koordinimi ndër-institucional është **proces** i cili i mundëson të gjitha niveleve të qeverisjes dhe të gjitha disiplinave të punojnë së bashku, në mënyrë më efektive dhe më efikase. Koordinimi ndër-institucional ndodh nëpër disiplina të ndryshme të përfshira në menaxhimin e incidentit, nëpër linja juridiksionale apo nëpër nivele të qeverisjes.

Koordinimi ndër-institucional mundet dhe ndodh në baza të rregullta sa herë që personeli nga agjencitë e ndryshme ndërvepron në aktivitetet e tilla si gatishmëria, parandalimi, reagimi, rimëkëmbja dhe zbutja e rreziqeve. Në të shumtën e rasteve, agjencitë bashkëpunuese vendosin SKNI për të përcaktuar më mirë se si do të punojnë së bashku dhe si të funksionojnë në mënyrë më efektive; megjithëse koordinimi ndër-institucional mund të ndodh edhe pa vendosjen e protokolleve. SKNI-të mund të vihen në lëvizje pa marrë parasysh lokacionin, titujt e personelit apo strukturën organizative. SKNI-të përfshijnë resurset e planifikimit dhe koordinimit dhe mbështetjen tjetër për ngjarjet e planifikuara, të lajmëruara dhe të pa paraljmëruara. SKNI përcakton praktikën e punës, procedurat standarde operative dhe protokollet përmes të cilave agjencitë pjesëmarrëse do t'i koordinojnë veprimet e tyre të ndërsjella. Elementet integrale të SKNI-së janë procedurat dhe protokollet e dispeqerisë, struktura e komandës së incidentit dhe aktivitetet e koordinimit dhe mbështetjes që zënë vend në një QOE të aktivizuar. Përfundimisht, SKNI siguron mbështetje, koordinim dhe asistencë në vendimet e nivelit politik për strukturën SKNI-së e cila menaxhon një incident.

Marrëveshjet e shkruara i mundësojnë agjencive brenda sistemit të zhvillojnë aktivitete me përdorimin e rregullave të caktuara dhe shpeshherë janë të vet-përcaktuara nga organizatat pjesëmarrëse. SKNI i implementuar plotësisht është kritik për aktivitet të lehtë, të koordinimit ndër-institucional dhe esencial për suksesin dhe sigurinë e reagimit. Për më tepër, përdorimi i SKNI-së është një nga komponentët fundamental të komandës dhe menaxhmentit brenda SIME-së, përderisa promovon shkallëzimin dhe fleksibilitetin të domosdoshme për reagim të koordinuar.

1. DEFINICIONI

Funksioni përsosor i SKNI-së është t'i koordinoj aktivitetet mbi nivelin fushor dhe të bëjë caktimin e prioriteteve të kërkesave të incidentit për resurset kritike apo konkruuese, në mënyrë që të ndihmohet koordinimi i operacioneve në teren. SKNI përbëhet nga kombinimi i elementeve të: personelit, procedurave, protokolleve, praktikave të punës dhe komunikimit të integruar në një sistem të përbashkët. Për qëllime të koordinimit të resurseve dhe mbështetjes midis shumë juridiksioneve, këto sisteme mund të zbatohen nga lokacionet fikse apo përmes aranzhimeve tjera të përvijuara në sistem.

Në disa raste, SKNI është informal dhe i bazuar në marrëveshjet verbale midis juridiksioneve, por zakonisht janë më formale dhe mbështeten me marrëveshje të shkruar, procedura operative dhe protokolle. Procesi formal (ku çështjet adresohen para ndodhjes së një incidenti) është qasje e preferuar dhe e rekomanduar, meqenëse e fuqizon funksionin e koordinimit. Derisa marrëveshjet "ad-hok" midis juridiksioneve mund të rezultojnë në koordinim efektiv ndër-institucional në incidentet relativisht të vogla, koordinimi në incidentet e mëdha, më komplekse është më i suksesshëm kur ndodh brenda sistemit të planifikuar dhe ndërtuar mirë.

2. ELEMENTET E SISTEMIT

SKNI përfshinë kombinimin e objekteve, pajisjeve, personelit dhe procedurave të integruara në një sistem unik me përgjegjësinë e koordinimit të resurseve dhe mbështetjes së operacioneve të reagimit.

a. Objektet/hapësirat e punës

Nevoja për lokacion/e (qendrat e komunikimit/dispeqerisë, QOE-të, objektet e komunës) për t'i vendos aktivitetet e sistemit do të varet nga funksionet e parapara të sistemit.

b. Pajisjet

Për t'i përmbush aktivitetet e sistemit pajisjet (kompjuterët dhe telefonat), duhet të përcaktohen dhe prokurohen me kohë.

c. Personeli

Në personelin tipik përfshihen kryeshefat e Agjencive apo përfaqësuesit e tyre të caktuar, të cilët janë të autorizuar t'i zotojnë resurset dhe fondet e agjencive të tyre në përpjekjet e reagimit të koordinuar. Personeli, gjithashtu mund të autorizohet si përfaqësues edhe nga agjencitë tjera mbështetëse, OJQ-ve dhe sektori privat të cilët asistojnë në koordinimin e aktivitete përtej nivelit fushor.

d. Procedurat

Procedurat përfshijnë proceset, protokollet, marrëveshjet dhe praktikat e punës që përshkruajnë aktivitetet, marrëdhëniet dhe funksionalitetin e SKNI-së. Identifikimi i aktiviteve të komunikimit interaktiv dhe planet shoqëruese të implementimit janë komponente kritike të sistemit.

3. SHEMBUJ TË ELEMENTEVE TË SISTEMIT

Dy elementet zakonisht më të përdorshme të Sistemit të Koordinimit Ndër-Institucional janë QOE-të dhe grupet e KNI-së.

a. Qendra Operative Emergjente

QOE-të mund të organizohen sipas disiplinave kryesore (zjarrfikja, zbatimi i ligjit apo shërbimet emergjente mjekësore), sipas funksionit mbështetës emergjent (transporti, punët publike dhe inxhinieria apo mbështetja e resurseve), sipas juridiksionit (qyteti, komuna apo regjioni), apo sipas kombinimit të këtyre tri-jave. PKI-të kanë nevojë për lidhje të mira të komunikimit me QOE-të për të siguruar menaxhim efektiv dhe efikas të incidentit.

Shpesh agjencitë brenda juridiksionit politik do të vendosin koordinim, komunikim, kontroll, logjistikë, etj. në nivel dikasteri për zbatimin e menaxhimit të përgjithshëm të resurseve të tyre të angazhuara. Dikasteret qeveritare (agjencitë, zyrat, etj.), apo organizatat private gjithashtu mund të kenë qendra operative (të referuara këtu si Qendrat Operative të Dikastereve apo QOD), të cilat shërbejnë si ndërmjetës midis operacioneve në vijim të asaj organizate dhe operacioneve emergjente, në mbështetje të saj. QOD mundet ta mbështes incidentin drejtëpërsëdrejti dhe të pranoj informacione përkatëse për operacionet e saj. Në shumicën e rasteve, QOD-të fizikisht janë të përfaqësuara në QOE të përbashkët të agjencisë, nga zyrtarët e autorizuar të dikasterit apo agjencisë.

QOE-të mund të plotësohen nga personeli që përfaqëson juridiksionet e shumëfishta dhe disiplinat funksionale, si dhe një mori të gjerë të resurseve. Për shembull, QOE-ja lokale e ngritur në reagim ndaj incidentit bio-terrorist, me gjasë do të përfshinte përzierjen e personelit nga fusha e zbatimit të ligjit, menaxhimit emergjent, shëndetit publik dhe personelin (zyrtarët lokal, regjional dhe qendror të shëndetit publik, dhe me gjasë përfaqësuesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, shërbimeve emergjente mjekësore, etj.).

Madhësia fizike, plotësimi me personel dhe pajisja e një QOE, do të varet nga madhësia e juridiksionit, resurset në dispozicion dhe volumit të parashikuar të punës së menaxhimit të incidentit. QOE mund të organizohet dhe plotësohet me personel në disa mënyra. Pavarësisht strukture së saj të caktuar organizative, një QOE duhet të përfshijë funksionet kryesore në vijim: koordinimin; komunikimin, ndarjen e resurseve dhe përcjelljen e tyre, dhe grumbullimin, analizimin dhe shpërndarjen e informacioneve.

Në rastin e aktivizimit të QOE lokale, duhet të vendoset komunikim dhe koordinim midis komandës së incidentit dhe QOE-së. Strukturat fushore të SKI-së, gjithashtu duhet të vendosin komunikim me QOE-në lokale të aktivizuar, qoftë drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet organizatave të tyre përkatëse. Për më tepër, QOE-të në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe nëpër agjencitë funksionale duhet të jenë në gjendje të komunikojnë si duhet me QOE-të e tyre, përfshirë ato të mirëmbajtura nga organizatat e sektorit privat. Komunikimi midis QOE-ve duhet të jetë i besueshëm dhe të ketë kapacitet zëvendësues. Funksionimi efektiv i QOE-ve më së shpeshti varet nga ekzistenca e marrëveshjeve për ndihmë reciproke dhe protokolleve të përbashkëta të komunikimit midis agjencive pjesëmarrëse.

b. Grupi KNI

Në mënyrë tipike, kryeshefat e Agjencive apo të caktuarit e tyre, të cilët janë të autorizuar t'i zotojnë resurset dhe fondet e agjencisë bashkohen për të formuar grupet e KNI-së. Grupet e KNI-së, gjithashtu mund të njihen edhe si komitetete ndër-institucionale, komitetet e menaxhimit emergjent ose siç përcaktohet ndryshe nga sistemi. Personeli i caktuar në QOE i cili plotëson kriteret për pjesëmarrje në grupin e KNI-së, mund të obligohet ta përmbush atë rol.

Grupi i KNI-së nuk ka asnjë përfshirje të drejtpërdrejtë në incident dhe në shumicën e rasteve do të vendoset në njëfarë distance nga vendi/et, i incidentit. Në shumë raste grupi i KNI-së për t'i përmbush detyrat e caktuara mund të funksionoj edhe virtualisht.

Grupi i KNI-së mund të kërkoj strukturë mbështetëse për nevojat e tij logjistike dhe të dokumentimit, për t'i menaxhuar informacionet për mbështetjen e vendimeve të lidhura me incidentin siç janë përcjellja e resurseve kritike, situata dhe informacionet inteligjente apo hetimore, dhe për të afruar informacione publike për mediat dhe popullatën. Numri dhe shkathtësitë e personelit të tij do të ndryshojnë në raport me kompleksitetin e incidentit, nivelet e aktiviteteve, nevojave të grupit KNI dhe faktorëve tjerë të identifikuar përmes marrëveshjeve apo organizmave të gatishmërisë. Grupi i KNI-së mund të ngritet në çdo nivel (qendror, regional dhe lokal), apo në çdo disiplinë (menaxhimi emergjent, shëndeti publik, infrastruktura kritike, apo sektori privat).

4. FUNKSIONET PARËSORE TË SKNI-së

Sistemi Koordinues Ndër-Institucional për të qenë efikas dhe efektiv duhet të jetë edhe fleksibil edhe i shkallëzueshëm. SKNI në përgjithësi do të zbatoj funksione të përbashkëta gjatë një incidenti, megjithëse, jo të gjitha funksionet e sistemit do të zbatohen gjatë çdo incidenti dhe ato mund të mos ndodhin sipas radhës së caktuar.

a. Vlerësimi i situatës

Ky vlerësim përfshinë grumbullimin, përpunimin dhe pasqyrimin e të gjitha informacioneve të nevojshme. Kjo mund të merr formën e konsolidimit të raporteve të situatës, marrjen e informacioneve plotësuese dhe përgatitjen e hartave dhe tabelave të gjendjes.

b. Përcaktimi i prioriteteve të incidentit

Caktimi i prioriteteve midis incidenteve në vijim brenda fushave të ndryshme të përgjegjësisë është komponent tjetër i SKNI-së. Në mënyrë tipike, vendoset procesi apo procedura për koordinim me komandën regjionale apo komandat e incidentit, për ti caktuar prioritetet e kërkesave të incidentit për resurset kritike. Konsideratat shpesh për përcaktimin e prioriteteve përfshijnë:

- Situatat kërcënuese për jetën;
- Kërcënimet ndaj të mirave materiale;
- Mundësia e lartë e dëmeve;
- Kompleksiteti i incidentit;
- Efekti mjedisor;
- Efekti ekonomik;
- Krite tjera të vendosura nga SKNI;

c. Sigurimi dhe ndarja e resurseve kritike

Resurset kritike të përcaktuara do të sigurohen (nëse është e mundur) nga agjencitë apo juridiksionet e përfshira. Këto agjenci apo juridiksione mund t'i shkëmbejnë resurset për t'i plotësuar nevojat e incidentit. Resurset e disponueshme nga incidentet që ndodhen në procesin e demobilizimit mund të zhvendosen, për shembull, në incidentet me prioritet më të lartë. Resurset mund të sigurohen gjithashtu edhe nga jashtë zonës së goditur. Procedurat për sigurimin e resurseve nga jashtë do të ndryshojnë varësisht nga gjërat si: agjencitë e përfshira dhe marrëveshjet e shkruara.

d. Mbështetja për politikat përkatëse të menaxhimit të incidentit dhe aktivitetet ndër-institucionale

Funksioni parësor i SKNI-së është të koordinoj, mbështes dhe asistoj në vendimet e nivelit politik dhe aktivitetet ndër-institucionale relevante, me aktivitetet, politikat, prioritetet dhe strategjitë e menaxhimit të incidentit.

e. Koordinimi me elementet tjera të SKNI-së

Pjesë kritike e SKNI-së është përvijimi se si do të komunikoj dhe koordinoj secili element i sistemit me elementet tjera të sistemit në të njëjtin nivel, në nivelin më lartë dhe në nivelin më të ulët. Përfshirja në funksionet e koordinimit ndër-institucional në vijim të një incidenti, mund të jenë përgjegjës për përfshirjen e "mësimeve të

mësuarat në procedurat e tyre, protokollet, praktikat e punës dhe strategjitë e komunikimit. Këto përmirësime mund të kenë nevojë të koordinohen me organizmat tjerë përkatës të gatishmërisë.

f. Koordinimi me zyrtarët e zgjedhur dhe emëruar

Një funksion tjetër parësor i SKNI-së i përvijuar në sistem është: procesi apo procedura për mbajtjen e zyrtarëve të zgjedhur dhe emëruar në të gjitha nivelet e qeverisjes, të informuar. Mbajtja e këtyre zyrtarëve të informuar dhe mbështetja e tyre (posaqërisht atyre brenda juridiksioneve të goditura) është jashtëzakonisht e rëndësishme, për faktin se mund të jetë e nevojshme që resurset e pakta të lëvizin tek një agjenci apo juridiksion me prioritet më të lartë.

g. Koordinimi i përmbledhjeve informative

Duke u mbështetur në funksionin e vlerësimit të situatës, personeli i cili zbaton procedurat e koordinimit ndër-institucional mund të siguroj përmbledhje informative, për incidentet brenda fushës së përgjegjësive të tyre, si dhe të sigurojnë kontakt të agjencisë/juridiksionit për media dhe agjenci tjera të interesuara.

C. INFORMIMI PUBLIK

1. HYRJE

Informimi publik përbëhet prej proceseve, procedurave dhe sistemeve për komunikimin e informacioneve lidhur me shkakun, madhësinë dhe gjendjen aktuale të incidentit me kohë, saktë dhe pranueshëm tek publiku, reaguesit dhe palët tjera të goditur drejtpësdrejtë dhe tërthorazi. Informimi publik duhet të koordinohet dhe integrohet midis juridiksioneve, agjencive dhe organizatave, midis niveleve të qeverisjes, dhe me OJQ-të dhe sektorin privat. Informimi publik, strategjitë e edukimit dhe planet e komunikimit të punuara mirë ndihmojnë në të siguruarit që masat për shpëtimin e jetës, rrugët e evakuimit, rrezikun si dhe sistemi i alarmimit dhe informacionet tjera të sigurisë publike, janë të koordinuara dhe komunikuar tek adresat e numërta me kohë dhe si duhet.

2. PËRSHKRIMI I SISTEMIT DHE KOMPONENTËT E TIJ

a. Zyrtari për Informim Publik

Zyrtari për Informim Publik mbështet strukturën e komandës së incidentit, si pjesëtar i personelit të komandës. Zyrtari për informim publik këshillon KI/KB për të gjitha çështjet e informimit publik të lidhura me menaxhimin e incidentit. Zyrtari për informim publik, gjithashtu merret me kureshtjet e medias, publikut, dhe zyrtarëve të zgjedhur; informimin publik emergjent dhe paralajmërimin, monitorimin e thashethemeve dhe reagimin, marrëdhëniet me media, dhe funksionet tjera të nevojshme për marrjen, verifikimin, koordinimin dhe shpërndarjen e informacioneve

aktuale dhe të pranueshme lidhur me incidentin. Informacionet rreth shëndetit publik, sigurisë dhe mbrojtjes janë të një rëndësie të veçantë.

Zyrtarët e informimit publik janë në gjendje të krijojnë mesazhe të koordinuara dhe të qëndrueshme duke bashkëpunuar për të:

- Identifikuar informacionet kyçe që duhet të komunikohen tek publiku;
- Përpiluar mesazhe që përmbajnë informacione kyçe të cilat janë të qarta dhe të lehta për tu kuptuar nga të gjithë, përfshirë ata me nevoja të veçanta;
- Caktuar prioritetet e mesazheve për të siguruar shpërndarje të informacioneve me kohë pa e mbingarkuar audiencën;
- Verifikuar saktësinë e informacioneve përmes kanaleve përkatëse;
- Shpërndar mesazhe duke përdor mjetet më të mira të mundshme;

b. Sistemi i Informimit të Përbashkët

Sistemi i Informimit të Përbashkët (SIP), siguron mekanizëm për organizim, integrim dhe koordinim të informacioneve për të siguruar mesazhe aktuale, të pranueshme, të qëndrueshme dhe me kohë përgjatë juridiksioneve apo disiplinave të shumëfishta, me OJQ-të dhe sektorin privat. SIP përfshinë planet, protokollat, procedurat dhe strukturat e përdorura, për të siguruar informim publik. Zyrtarët e informimit publik të të gjitha niveleve dhe QIP-et e ngritura janë elemente kritike mbështetëse të SIP. Në elementet kyçe përfshihen:

- Koordinimi dhe integrimi ndërinstytucional;
- Grumbullimi, verifikimi, koordinimi dhe shpërndarja e mesazheve të qëndrueshme;
- Mbështetja për vendimmarrësit;
- Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria;

c. Qendra e Informimit të Përbashkët

QIP është lokacion qendror i cila ndihmon operacionet e SIP-it, ku personeli me përgjegjësi të informimit publik, zbaton funksione të informimit emergjent kritik, komunikimit emergjent dhe funksione të marrëdhënieve publike. QIP-et mund të ngriten në nivelet e ndryshme të qeverisjes apo në vendngjarjen e incidentit, ose mund të jenë komponentë e SKNI-së (Grupet e KNI apo QOE-të). Varësisht nga kërkesat e incidentit, një QIP për një incident specifik zakonisht ngritet në një vend të vetëm në vendngjarje, në koordinim me agjencitë e nivelit qendror, regional dhe lokal, apo në vet nivelin qendror nëse e kërkon situata. Publikimet kthjellohen nëpërmjet KI/KB, QOE/Grupi KNI dhe/apo zyrtarët qendror në rastet e incidenteve të koordinuara nga niveli qendror, për të siguruar mesazhe të qëndrueshme, për të shmang lëshimin e informacioneve konfliktuoze dhe për parandalimin e efektit negativ të tyre në operacionet e regimit. Ky proces formal i publikimit të informacioneve siguron mbrojtje të informacioneve të ndjeshme të incidentit. Edhe pse agjencitë mund të lëshojnë publikimet e tyre që kanë të bëjnë me politikat,

procedurat, programet dhe kapacitetet, megjithatë, kjo duhet të koordinohet me QIP(et), e incidenteve përkatëse.

Lokacioni më vete i QIP-it është i preferuar, por sistemi është mjaftë fleksibil dhe i përshtatshëm sa të akomodoj lokacione të shumëfishta fizike apo virtuale të QIP-it. Për shembull, QIP-et e shumëfishta mund të jenë të nevojshme për incidentin kompleks i cili përfshinë hapësirë të madhe gjeografike apo juridiksione të shumëfishta. Në rastet kur janë të aktivizuara QIP-et e shumëfishta, informimi duhet të koordinohet midis të gjitha QIP-eve përkatëse, secila qendër duhet të ketë procedura dhe protokolle për të komunikuar dhe koordinuar efektivisht me njëra tjetrën. Sa herë që ekzistojnë shumë QIP-e, autoriteti përfundimtar i publikimit të informacioneve duhet të jetë komanda e lartë, çoftë nëse përdoret struktura e komandës së bashkuar apo ajo regjionale. QIP qendror mund të përdoret kur një incident kërkon koordinim qendror dhe parashihet të jetë i gjatë (javë apo muaj), apo kur incidenti godet hapësirë të madhe të territorit të vendit.

QIP mund të organizohet në shumë mënyra, varësisht nga natyra e incidentit. Tabela 7 identifikon disa lloje të QIP-eve.

Tabela 7. Llojet e Qendrave të Informimit të Përbashkët

Incidentit	<ul style="list-style-type: none"> • Lokacion fizik optimal për bashkëvendosjen e zyrtarëve lokal të informimit publik dhe atyre të caktuar për KI-në; • Qasja e lehtë e mediave është parakusht i suksesit;
Virtuale	<ul style="list-style-type: none"> • Ngriten kur bashkëvendosja fizike nuk është e mundshme; • Inkorporon protokollin e komunikimit dhe teknologjisë;
Satelite	<ul style="list-style-type: none"> • Më e vogël sesa QIP-et tjera; • Parimisht ngritet për ta mbështet QIP të incidentit; • Operon nën kontrollin e QIP-it parësor për atë incident ;
Regjionale	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetë strukturat e shumta të incidentit në hapësirë të gjerë ; • Mund të ngritet në baza lokale dhe regjionale; • Qasja e mediave është e lartë;
Mbështetëse	<ul style="list-style-type: none"> • Ngritet për mbështetjen e disa QIP-eve të incidentit në disa regjione; • Ofron personel plotësues dhe resurse jashtë zonës së fatkeqësisë;
Qendrore	<ul style="list-style-type: none"> • Ngritet për incidentet me kohëzgjatje; • Ngritet për mbështetjen e aktiviteteve qendrore të reagimit; • E plotësuar me personel nga një numër i minsitrive dhe agjencioneve qendrore; • Qasja e medieve është e lartë;

d. Pavarësia organizative

Organizatat pjesëmarrëse në menaxhimin e incidentit mbajnë pavarësinë e tyre. Komanda e incidentit dhe SKNI janë përgjegjës për ngritjen dhe mbikëqyrjen e QIP-eve, përfshirë proceset për koordinimin dhe pastrimin e komunikimeve publike. Në rastin e komandës së bashkuar ministritë, agjencitë, organizatat apo juridiksionet që

kontribuojnë në menaxhimin e përbashkët të informimit publik, nuk humbin identitetin e tyre individual apo përgjegjësinë për programet apo politikat e tyre vetjake.

e. Dhënja e informacioneve tek publiku dhe palët e interesit

Procesi i dërgimit të informacioneve tek publiku dhe palët e interesit gjatë një incidenti është një cikël i vazhdueshëm i cili përfshin katër hapa.

(1) Grumbullimi i informacioneve

Grumbullimi i informacioneve është hapi i parë në procesin e dhënjes së Informacioneve tek publiku dhe palët e interesit. Informacionet grumbullohen nga:

- *Komanda në vendngjarje:* Burim i informacioneve zyrtare në vijim mbi përpjekjet e reagimit.
- *Zytari për informim publik në vendngjarje:* Raporton tek QIP çfarë vëren dhe dëgjon në incident nga mediat, zyrtarët e zgjedhur si dhe personeli i tyre dhe publiku.
- *Monitorimi i mediave:* të përdorura për vlerësimin e saktësisë dhe përmbajtjes së raporteve të medieve. Gjithashtu, ndihmon në identifikimin e trendeve të çështjeve të shkeljeve.
- *Lajmet e mediave:* burim i vlefshëm i informacioneve në zhvillim dhe çështjet aktuale.
- *Zyrtarët publik dhe të zgjedhur/emëruar:* pyetjet e zyrtarëve të zgjedhur/emëruar, liderët e komunitetit dhe publiku i përgjithshëm shpiejnë në çështje specifike të atyre në zonën e goditur.

(2) Verifikimi i informacioneve

Hapi tjetër në proces është verifikimi i saktësisë së informacioneve të grumbulluara, duke konsultuar burimet në vijim:

- *Zyrtarët tjerë të informimit publik në QIP:* Krahasimi i të dhënave – posaçërisht me zyrtarin kryesor të informimit publik dhe zyrtarët tjerë të informimit publik, që janë ndërlidhës të programeve të ndryshme të asistencës apo të partnerëve të reagimit/rimëkëmbjes - është një mënyrë e verifikimit të saktësisë së informacioneve.
- *Burimet e QOE:* Përfshijnë udhëheqësit e programeve, nga të cilët duhet të kërkohet të vërtetojnë informacionet.
- *Zyrtarët e informimit publik në vendngjarje:* Burim i vlefshëm për kontrollimin e saktësisë, së informacioneve të raportuara në QOE, me raportet nga mediat, zyrtarët e zyrtarëve të zgjedhur dhe njerëzit në vendngjarje.

(3) Koordinimi i informacioneve

Hapi tjetër në proces është koordinimi me zyrtarët tjerë të informimit publik që janë pjesë e SIP-it. Në këta zyrtarë përfshihen ata që janë të përfaqësuar në QIP dhe ata që punojnë nga një vend tjetër e që janë pjesë e SIP-it. Koordinimi i informacioneve përfshinë:

- **Krijimin e mesazhit(eve) kryesor:** Pas grumbullimit të informacioneve nga të gjitha burimet, punohen mesazhet e unifikuara të cilat adresojnë të gjitha nevojat informative dhe u caktohet prioriteti, në raport me strategjinë e përgjithshme qendrore, regjionale dhe lokale të reagimit dhe rimëkëmbjes. Misioni përfshinë dhënien e informacioneve aktuale, të qëndrueshme tek npersonat e duhur në kohën e duhur në mënyrë që të mund të marrin vendime të duhura.
- **Marrja e miratimit nga personat me autoritet:** Të siguruarit që informacioni është i qëndrueshëm, aktual dhe i pranueshëm. Procesi i miratimit duhet të jetë i efektshëm për të siguruar publikim me kohë të informacionit.

(4) Shpërndarja e Informacioneve

Hapi tjetër në proces është shpërndarja e informacioneve tek publiku dhe palët e interesit. Ky hap përfshinë:

- **Përdorimin e mënyrave të shumfishta:** Në një emergjencë, mund të mos ketë shumë opsione. Thirrjet telefonike dhe intervistat mund të jenë mënyrat parësore të dhënjes së informacioneve për media. Vizitat personale apo takimet në vendbanim mund të jenë vendi më efektiv për publikun, zyrtarët e zgjedhur/emëruar apo palët tjera të interesit.
- **Monitorimi i mediave:** Monitorimi i mediave është i pavlefshëm për të siguruar që mesazhi është kuptuar nga mediat dhe se është raportuar saktësisht dhe plotësisht. Pasaktësitë e rëndësishme duhet të adresohen para se të raportohen gabimisht për së dyti.

3. PLANIFIKIMI I KOMUNIKIMIT TË INFORMIMIT PUBLIK

Strategjitë e komunikimit të informacioneve dhe planifikimi, janë esenciale për të gjitha aspektet e informimit publik. Planet duhet të përfshijnë proceset, protokollet dhe procedurat që kërkojnë punimin e draft publikimeve, listat e mediave, dhe informacionet për kontakt për zyrtarët e zgjedhur/emëruar, liderët e komunitetit, organizatat e sektorit privat, dhe organizatat e shërbimit publik për të mundësuar shpërndarje të informacioneve publike aktuale, të qëndrueshme, të pranueshme dhe me kohë. Komunikimet e informimit publik duhet të jenë komponentë kritike e trajnimeve dhe ushtrimeve.

D. MARRËDHËNIET MIDIS ELEMENTEVE TË KOMANDËS DHE MENAXHMENTIT

SKI, SKNI dhe Informimi Publik në këtë dokument, janë përshkruar si elemente të ndara të komandës dhe menaxhmentit të SIME-së. Megjithatë, SIME mbështetet edhe në marrëdhëniet midis këtyre elementeve edhe në secilin veç e veç.

Disa marrëdhënie janë shpjeguar në hollësi. Për shembull, komanda regjionale dhe komanda e incidentit, koordinon me informimin publik informacionet specifike për incidentin përmes një zyrtari për informim publik në incident brenda SIP-it. Marrëdhënia midis komandës regjionale apo komandës së incidentit me SKNI-në është shpjeguar parimisht, përmes lidhjeve komunikuese midis komandës dhe/apo personelin e nivelit fushor, me përgjegjësit e menaxhimit të resurseve dhe pozitat e caktuara të personelit brenda koordinimit ndërinstitutional.

Këto marrëdhënie (së bashku me marrëveshjet tjera midis elementeve të komandës dhe menaxhmentit që nuk janë qartësuar më heret) duhet të qartësohen dhe dokumentohen ashtu siç evolon secili element gjatë një incidenti.

KOMPONENTI V:

MENAXHIMI DHE MIRËMBAJTJA NË VIJIM

Komponenta menaxhimi dhe mirëmbajtja në vijim e SIME-së përmban dy nën seksione: Institutin e Menaxhimit Emergjent (IME), dhe Teknologjitë Mbështetëse. Seksioni i IME-së përvijon përgjegjësitë e seksionit të teknologjive mbështetëse dhe shtjellon parimet e domosdoshme për ta eksploruar, shkencën dhe teknologjinë për përmirësimin e kapaciteteve dhe zvogëlimin e kostove/shpenzimeve.

A. INSTITUTI I MENAXHIMIT EMERGJENT

IME afron drejtime strategjike për sistemin dhe mbikëqyrjen e tij, duke mbështetur mirëmbajtjen e rregullt dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe komponentëve të tij për kohë të gjatë. IME nxitë pjesëmarrjen nga ministritë dhe agjencionet qendrore, organet regjionale dhe qeveritë lokale, dhe personelin e menaxhimit/reagimit emergjent, përfshirë ata nga OJQ-të dhe sektori privat. Plotësimet në SIME dhe çështjet tjera mund të propozohen nga të gjithë përdoruesit e tij (përfshirë qeverisjen e të gjitha niveleve, sektorin privat, organizatat vullnetare, botën akademike, organizatat jo fitimprurëse dhe shoqatat tjera profesionale të lidhura për SIME-në).

Për më tepër, IME administron kërkesat e SIME-së për përputhshmëri, ndihmon krijimin e standardeve udhëzuese për klasifikim dhe akreditim, mbështet trajnimet dhe ushtrimet e SIME-së dhe menaxhon botimet e materialeve të ndryshme të lidhura për te.

1. KONCEPTET DHE PARIMET

Procesi i menaxhimit dhe mirëmbajtjes së SIME-së siguron që të gjithë shfrytëzuesve dhe palëve të interesit (përfshirë të gjitha nivelet e qeverisjes, disiplinat funksionale, OJQ-të dhe sektorin privat) u jepet mundësia të marrin pjesë në aktivitetet e IME-së. Procesi i menaxhimit dhe mirëmbajtjes së SIME-së mbështetet fortë në mësimet e

mësuara nga incidentet aktuale, trajnimet dhe ushtrimet në menaxhimin e incidenteve si dhe praktikat më të mira të dëshmuara nëpër juridiksione dhe disiplina funksionale.

2. PROCESI I RISHIKIMIT TË SIME-së

Dokumenti i SIME-së do të rishikohet në ciklin 2 vjeçar dhe përmirësohet për të përfshirë udhëzimet e reja administrative, ndryshimet legislative dhe ndryshimet procedurale bazuar në mësimet e mësuara nga ushtrimet, incidentet aktuale dhe ngjarjet e planifikuara. Ndryshimet e propozuara në SIME do të dorëzohen në IME për tu shqyrtuar, miratuar dhe publikuar.

Ministri është përgjegjës për publikimin e plotësimeve dhe modifikimeve të dokumenteve të lidhura me SIME-në, përfshirë standardet, procedurat dhe materialet plotësuese. Dhe këtë do ta bëjë me konsultime të rregullta me ministrinë dhe agjencitë qendrore dhe qeverisjen lokale.

3. PËRGJEGJËSITË E INSTITUTIT TË MENAXHIMIT EMERGJENT

a. Administrimi dhe pëlqimi

Për ta menaxhuar administrimin në vijim dhe implementimin e SIME-së, përfshirë saktësimin e masave të pëlqimit, IME është përgjegjëse për të punuar në këtë drejtim me sa vijon:

- Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e programit kombëtar për aftësim dhe njohje të SIME-së, përfshirë udhëzimet e veçanta mbi qëllimin dhe përmbajtjen e këtij dokumenti dhe sistemit në përgjithësi;
- Promovimin e përputhmërisë midis standardeve të nivelit qendror për SIME-në dhe ato të zhvilluara nga grupet publike, private dhe profesionale;
- Lehtësimin e krijimit dhe mirëmbajtjes së dokumenteve dhe sistemeve të të dhënave të lidhura me kualifikimin, çertifikimin dhe akreditimin e personelit dhe organizatave të menaxhimit/reagimit emergjent;
- Vendorsjen e kriterëve të vlerësimit për komponentet e ndryshme të SIME-së, si dhe kërkesat për pëlqim;

b. Standardet dhe akreditimi

IME do të punoj me organizatat përkatëse për të siguruar zhvillimin dhe adaptimin e standardeve të përbashkëta kombëtare dhe sistemeve të akreditimit që janë në pajtim dhe të rreshtuara në implementuesit e SIME-së. Identifikimi, adaptimi dhe zhvillimi i standardeve të përbashkëta dhe programeve të akreditimit përfshinë me sa vijon:

- Lehtësimin e zhvillimit dhe publikimit të standardeve, udhëzimeve dhe protokolleve kombëtare për kualifikim, licensim dhe çertifikim të personelit të menaxhimit/reagimit emergjent, sipas nevojës;

- Rishikimin dhe miratimin e kërkesave të kualifikimit dhe çertifikimit specifik për disiplina;
- Ngritjen e sistemit për mirëmbajtjen e të dhënave për t'i pajis menaxherët e incidentit me informacione të hollësishme për kualifikim, përvojë dhe trajnim të nevojshme për akreditimin e personelit për pozitat qendrore të përshkruara të menaxhimit të incidentit;
- Koordinimin e standardeve profesionale minimale të çertifikimit dhe lehtësimin e dizajnit dhe implementimit të sistemit gjithëkombëtar të akreditimit;
- Lehtësimin e vendosjes së standardeve për performim, përputhshmëri dhe ndërveprueshmëri të pajisjeve dhe sistemeve të komunikimit të menaxhmentit të incidentit, përfshirë me sa vijon:
 - Lehtësimin e vendosjes dhe publikimit të standardeve kombëtare, udhëzuesve dhe protokolleve për çertifikimin e pajisjeve, përfshirë inkorporimin e standardeve ekzistuese dhe programet e çertifikimit të përdorura nga strukturat e menaxhimit të incidenteve dhe reagimit emergjent në vend;
 - Shqyrtimin dhe miratimin e listave të pajisjeve që plotësojnë këto kërkesa të caktuara çertifikuese;
 - Bashkëpunimi me organizatat përgjegjëse për vlerësimin dhe testimin e pajisjeve të reaguesve emergjent;
- Lehtësimin e zhvillimit dhe publikimit të standardeve kombëtare për klasifikimin e resurseve;
- Lehtësimin e përkufizimit dhe mirëmbajtjes së kornizës informative të nevojshme për ngritjen e sistemeve të informimit të SIME-së, përfshirë zhvillimin e standardeve për të dhënat;
- Koordinimin e vendosjes së standardeve teknike dhe teknologjike për përdoruesit e SIME-së;

c. Mbështetja e trajnimeve dhe ushtrimeve

Për të udhëhequr zhvillimin e trajnimeve dhe ushtrimeve që shtyjnë përpara njohuritë e agjencive dhe organizatave lidhur me SIME-në, miratimin dhe implementimin e tij, IME do të koordinoj me ta, për të bërë me sa vijon:

- Lehtësimin dhe përcaktimin e nevojave të përgjithshme për trajnime dhe zhvillimin e standardeve kombëtare të trajnimit dhe kurikulimit të kurseve të lidhura me SIME-në, përfshirë:
 - përdorimin e mundësive të modelimit dhe simulimit për programet e trajnimit dhe ushtrimeve;
 - Trajnimet e bazuara në terren, saktësimin e detyrave esenciale për misionin, nevojat për udhëzime të specializuara dhe trajnimet për instruktor si dhe dokumentacionin për plotësimin e kurseve për të gjithë përdoruesit e SIME-së;
 - Shqyrtimin dhe rekomandimin e kurseve trajnuese specifike për disiplina të SIME-së;

- Lehtësimin e standardeve, udhëzimeve dhe protokolleve kombëtare për trajnimet dhe ushtrimet e menaxhimit të incidentit, përfshirë marrjen parasysh të programeve ekzistuese të trajnimit dhe ushtrimeve në të gjitha nivelet juridiksionale;
- Lehtësimin e zhvillimit të trajnimeve të nevojshme për mbështetjen e inkuorporimit të SIME-së nëpër të gjitha nivelet juridiksionale;

d. Menaxhimi i publikimeve

Menaxhimi i publikimeve për SIME-në përfshinë zhvillimin e marrëveshjeve për emërtim dhe numërtim, shqyrtimin dhe ertifikimin e publikimeve, zhvillimin e metodave për kontrollin e publikimeve, identifikimin e resurseve dhe furnizuesve për shërbimet e publikimit, manaxhimin e shpërndarjes së publikimeve dhe sigurimin e qasjes në produkte.

Menaxhimi i publikimeve i SIME-së përfshinë llojet e produkteve në vijim:

- Informacionet për kualifikim;
- Informacionet për kurse trajnuese dhe ushtrime;
- Pakot e detyrave;
- Trajnimet për SKI-në, fomularët dhe mostrat;
- Udhëzuesit dhe lehtësuesit e punës;
- Programet kompjuterike;
- Resurset audio dhe video;
- Doracakët e praktikave më të mira/modelet/rekomandimet;

Për t'i menaxhuar publikimet lidhur me SIME-në, IME do të koordinoj me agjencitë dhe organizatat përkatëse dhe do të marrë udhëheqjen në:

- Lehtësimin e zhvillimit dhe mirëmbajtjes së sistemit për menaxhimin e publikimeve për publikimet dhe materialet e lidhura me SIME-në, përfshirë zhvillimin apo koordinimin e publikimeve të përgjithshme për të gjithë përdoruesit e SIME-së;
- Lëshimin e dokumenteve apo informacioneve përmes mjeteve të sistemit të SIME-së për menaxhimin e publikimeve;
- Lehtësimin, zhvillimin dhe publikimin e mostrave dhe materialeve të standardizuara, siç janë: dokumentet plotësuese dhe udhëzuesit, për ta mbështet implementimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të SIME-së;
- Rishikimin e nevojave për menaxhimin e publikimeve të lidhura për disiplina të caktuara;

B. TEKNOLOGJITË MBËSHTETËSE

Zhvillimi i vazhdueshëm i shkencës dhe teknologjisë është integral me përmirësimin dhe avancimin e vazhdueshëm të SIME-së.

Për të siguruar zhvillim efektiv të zgjidhjeve të shkencës dhe teknologjisë së menaxhimit të incidentit, IME duhet të punoj në koordinim me Sektorin e Shkencës dhe Teknologjisë për vlerësimin e nevojave të personelit të menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatave të tyre përkatëse.

1. KONCEPTET DHE PARIMET

SIME eksploron shkencën dhe teknologjinë për t'i përmirësuar kapacitetet dhe zvogëluar shpenzimet. Vëzhgon pesë parime kyçe të përcaktuara më poshtë.

a. Ndërveprueshmëria dhe kapaciteti

Sistemet që operojnë në mjedisin e menaxhimit të incidentit duhet të jenë në gjendje të bashkëveprojnë lehtë midis disiplinave dhe juridiksioneve. Ndërveprueshmëria dhe kapaciteti arrihen nëpërmjet përdorimit të mjeteve siç janë: standardet e komunikimit dhe të dhënave të përbashkëta, formularët e të dhënave digjitale, standardet e pajisjeve dhe standardet e dizajnit.

b. Mbështetja teknologjike

Mbështetja teknologjike është përdorimi dhe inkorporimi i teknologjisë së re dhe asaj ekzistuese për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në të gjitha aspektet e menaxhimit të incidentit. Mbështetja teknologjike lejon organizatat që përdorin SIME-në të rrisin të gjitha aspektet e menaxhimit të incidentit dhe reagimit ndaj incidentit.

c. Standardet e teknologjisë

Sistemet dhe teknologjia mbështetëse janë të bazuara në nevojat e përcaktuara në koordinim me qeverisjen e të gjitha niveleve, si dhe OJQ-të, sektorin privat dhe organizatat profesionale kombëtare. Standardet kombëtare mund të jenë të nevojshme për të mundur ndërveprimin dhe kapacitetin e sistemeve kyçe përgjatë juridiksioneve dhe/apo disiplinave.

d. Nevojat e gjëra

Nevojat për teknologji të re, procedura, protokolle dhe standarde për lehtësimin e menaxhimit të incidentit, përcaktohen para, gjatë dhe pas një incidenti. Derisa këto nevoja mund t'i tejkalojnë resurset e disponueshme, SIME afron mekanizëm për grumbullimin e nevojave dhe resurseve dhe caktimin e prioriteteve për to.

ANEX. I

KORNIZA LIGJORE DHE INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
2. Ligji për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi tjera Nr.2006/02/L-68;
3. Ligji për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës Nr.2008/03-L050;
4. Ligji për Mbrojtje nga Zjarri Nr.2006/02-L41;
5. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr.2008/03-L048;
6. Ligji për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës Nr.2008/03-L045;
7. Ligji për Policinë Nr. 03/L-035;
8. Ligji për Telekomunikacionin Nr.2002/7;
9. Ligji për Transportin rrugor Nr. 2004/1;
10. Ligji për Shendetësi Publike Nr. 02/L-78;
11. Ligji për Kujdesin Shendetësor Emergjent Nr.2006/02-L50;
12. Ligji për Kryqin e Kuq të Kosovës Nr.03/L-179
13. Ligji për Plotësim Ndryshimin e Kodit Penal të Kosovës Nr.2008/03-L-002;
14. Ligji për Plotësim ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës Nr.2008/03-L-002;
15. Ligji për Procedurën Kontestimore Nr.03/L-006;
16. Ligji për Procedurën Jokontestimore Nr.03/L-007;
17. Ligji për Ndërrmarjet Publike Nr.2008/03-L087;
18. Ligji për vetëqeverisje lokale Nr.2008/03-L040;
19. Udhëzim Administrativ për kriteret e themelimit dhe organizimit të shërbimit zjarrfikës dhe shpëtimit në Kosovë Nr.05/2007;
20. Udhëzim Administrativ për metodologjin e hartimit të vlersimit të rrezikut dhe planeve për mbrojtje dhe shpëtim Nr.19.2008;
21. Udhëzim Administrativ për themelimin e këshillit për sigurinë në komunikacionin rrugor Nr.18/2008;
22. Rregullorja e punës së Këshillit të Sigurisë së Kosovës
23. Rregullorja për punën e Qendrës së Situatave



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 12/126

Datë: 26.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë